



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

|   |               |                    |                    |
|---|---------------|--------------------|--------------------|
| Pratmend - Udhëzimi Nr. Data 23-10-2024 |               |                    |                    |
| Nr. i Komunitetit<br>Lokalit            | Adresa lokale | Shifri i<br>Postës | Shifri<br>Vendndar |
| 01-060/01-                              |               |                    | 1335               |



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor, 2008) dhe të nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës, në nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

## F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e X të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datën **31.10.2024 (e Enjte)**, duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit të Shtëpisë së Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti. Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

## R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e Kuvendit Komunal.
2. Pasqyrat Financiare të buxhetit komunal për periudhën Janar-Shtator 2024
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në interes të përgjithshëm publik
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në bujqësi në Komunën e Vitisë
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e draft Kodit të Etikës për zyrtarët e Komunës së Vitisë
6. Informatë mbi ndarjen e Subvencioneve në DKRS gjate vitit 2024
7. Informatë nga DKA-ja, mbi fillimin e vitit të ri shkollor

Viti, më 23.10.2024

Kryesuesi i Kuvendit  
Belim Azizi





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL

### IMBLEDHJES SË NËNTË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 27.09.2024 (e premte) në Shtëpinë e Kulturës "Gursel dhe Bajram Sylejmani", duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu si dhe këshilltarët e Kuvendit: z.Ali Bajrami, z.Ramadan Deliu, z.Basri Sylejmani, z.Sokol Shaqiri, znj.Valentina Mehmeti, znj.Zejnepe Osmani, z.Sokol Hyseni, z.Illir Zuka, z.Ekrem Ymeri, znj.Arbnora Hajredini, znj.Marigona Avdiu, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, z.Sejdi Emimi, z.Nexhat Halili, z.Remzi Salihu, z.Durim Sylejmani, znj.Majlinda Shabani, znj.Lindita Demelezi, z.Taulant Haxhiu, z.Musli Neziri, znj.Vilsona Maliqi-Salihu, z.Veton Ramadani, z.Reshat Azizi, znj.Zyrafete Rama, ndërsa mungoi: znj.Anisë Zejnullahu. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, zyrat e kryetarit, mediat elektronike, OSBE-ja dhe të tjerë.

Pasi u konstatua se prezent janë 26 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e nëntë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Të nderuar të pranishëm, media, qytetarë të Komunës së Vitisë, përfaqësues të OSBE-së, mirë se keni ardhur në mbledhjen e katër për këtë vit të Kuvendit. Gjatë kësaj periudhe kemi pasë të gjitha konfirmimet nga ministrat e linjes për vendimet dhe nuk kemi asnjë vendim kontestues, të gjitha deri më tani janë të kthyera pozitivisht dhe janë në fuqi. Para se të hymë në rend dite vazhdojmë me pyetje, përgjigje, duke ju kërkuar që të ju përmbahemi kohës.

**z.Jakup Demiri:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit. Kam një pyetje për drejtorin e inspektoriatit dhe komunën njëkohsisht. Te kjo pjesa këtu ku po rregullohet sheshi ndërmjet postes dhe objekteve të banimit që janë rregullu disa lokale afariste dhe janë dhanë në shfrytëzim. Disa jepen, disa kanë pas pronë. Kam një ankesë prej disave që është njëri që privatisht është duke e ndërto një. Deshta të di a ka ndërmarr diçka komuna apo a është në njohuri lidhur me këtë çështje.

**z.Taulant Haxhiu:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Unë dashta me u lidhë nënkryetar tek kjo rruga me kalldrëm. Unë nuk e di kush e ka bërë dhe pranimin teknik të saj. Tash nuk po e fajsoj vetëm komunën, por operatorin. Projekt më katastrofë, kalldrëm më i keq, projekt më dështues nuk ka pas në Komunën e Vitisë. Nuk është fajti te ju ose te komuna, po është fajti tek ai që i ka kry punët, operatori. Atë kalldrëm vetë po e shihni në po foim këtu për interes të qytetarëve. Nuk ta qon mallin e kalldrëmit. Aty veturat shumë pak po kalojnë dhe saher që kalojnë aty dëmtohen si me kalu me një rrugë me gropa. Besoj që projekt më dështues se kjo rruga me kalldrëm unë nuk kam parë në Komunën e Vitisë. Për këtë unë e fajsoj operatorin dhe ata që e kanë bërë pranimin teknik nëse e kanë bërë. Kam dhe një pyetje tjetër. Është e 10-ta herë që unë po e diskutoj në KK për tek rruga "Hasan Prishtina". Tek lagjja ku jetoj unë kemi nevojë për një polic të shtrirë apo ndalesa. Veturat po vozisin shumë shpejt, është lagjja më e banuara në Viti. Unë po kam presion prej banorëve të lagjes. Çdo ditë para seancës ata më therrasin në telefon. Ne kemi bërë disa nënshkrime, kemi dërgu si kërkesë për me pas banorët e lagjes për sigurinë e fëmijëve tanë. Ti z.nënkryetar më ke thanë që, do të merrem me këtë çështje. Edhe njëherë po të themë, në qoftë se një fëmijë shkelet nga vetura që hecin deri në 70-80 orë, dikush duhet me marrë këtë përgjegjësi. Është lagjja më e banueshme që ka frekuentim të fëmijëve dhe hecin shumë shpejt veturat, Dashta të

uoruanem dhe tek zyrat e reja të LDK-së. Unë nuk jam kundër zyrave, po aty ka qenë një lokal në qendër të Vitisë, i cili ka kogjo metra katror dhe ka qenë mirë që atë ta shfrytëzojmë, të ja japim dikujt me qëra që të kemi më shumë të ardhura. Si buxhet komunal ne kemi mujtë deri 1 mijë euro ti marrim qëra nga ai objekt që sot e shfrytëzojnë zyrat e LDK-së. Unë nuk jam kundër zyreve, po zyret është mirë ti mbajm me një vend, nuk ka rëndësi ku është zyrja, është me rëndësi partia. I keni marrë zyrat në qendër të Vitisë dhe aty keni mujtë me shfrytëzu me ja dhanë dikujt me qëra se është kogjo lokal i përshtatshëm për bizneset private që operojnë në Komunën e Vitisë. Ne si parti politike PDK e partitë tjera opozitare kemi dalë në katë të dytë, aty na mysin minjë dhe erat, kurse partia kryesore i ka marrë zyret në qendër si me i marrë tek hotel Grandi në Prishtinë.

**z.Nexhat Halili:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Pyetja ime e parë është ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimi publik në Komunën e Vitisë. Në datën 27-10-2021 Komuna e Vitisë ka lidhur kontratë për rregullimin e trotuarit dhe ndriçimit publik në vlerë në mbi 800 mijë euro. Kjo kontratë kishte afat 2-vjeçar deri me 27-10-2023. Në kuadër të këtij projekti janë të përfshirë disa projekte të shumë fshatrave, por në kuadër të këtij projekti është i përfshirë edhe trotuari i cili lidhë fshatin Trestenik me Sllatinën e Eperme, që është diku mbi 2 mijë e 700 metra, mirëpo ky trotuar edhe pse sheshë e kam ngritë gati në secilën seancë. Ky trotuar është ende në fazën fillestare. Kontrata ka përfunduar. Me cilën kontratë ose me çka parashini që këto punë të vazhdojnë dhe a keni ndonjë plan dinakim se kur do të përfudnoj ky trotuar sepse është bërë i tepert. Pyetja tjetër ka të bëjë me ujesjellsin për 5 fshata, ky ujesjelles ka filluar së funksionuari diku 2 vite më parë ky është një hapë i mirë mirpo ky ujesjelles shpesh nuk është funksional ujë nuk ka dhe uji cili është tu perdor nuk mundë të përdoret për pije, a ka ndonjë hapë që edhe këta banor të këtyra fshatrave të kenë ujë të pishem. Kam dhe një pyetje disa lagje sidomos të fshatit Trestenik kanë problem me energji elektrike e dimë që nuk është kompetence e komunes mirpo të paktën ju si struktura udhëheqse keni kontakte me KEDSIn banoret e këtyre lagjeve po pikerisht të fshatit timë kanë bërë kërkesa të shpeshta dhe në komunë jeni të vetëdishem mirpo deri tani nuk ka kurrfar hapi, a ka mundësi diçka të kontribojn në këtë drejtim në menyre që edhe këta banor të kenë rrymen dhe një jetë të dinjitetshme.

**z.Musli Neziri:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Në seancën e muajit qershor kam bërë pyetje rreth punimeve në shkollën e mesme "Kuvendi i Lezhës" në gjimnaz. Atëhere përgjigjja ishte nga nënkryetari, se mësimi do të filloj në atë objekt në muajin shtator dhe tani jemi në fund të muajit shtator, aty fare nuk zhvillohet mësim, dhe meqenëse jem afër aty duke punu, punimet nuk janë as për së afërmi për të përfunduar, andaj kisha dashtë përgjigje prej nënkryetarit se, kur do të zotohet për një datë tjetër, sepse aty ka qenë një zotim nga nënkryetari që në shtator ka me qenë e kryme. Një pyetje rreth DKA-së, rreth furnizimit me libra për klasat e shkollave fillore, nga klasa 1-9. A ka ndonjë raport, sepse ne e pamë që në mediat lokale ka ekzistuar që një shkollë as 70% janë femija pa libra, dhe a ka ndonjë raport rreth kesaj pjese ku jemi duke pas parasysh vështirësitë që kemi pas si prind rreth furnizimit me libra, për arsyse se jemi detyru ti frekuentojmë të gjitha komuat e tjera jashtë Vitisë, që të mundemi t'i sigurojmë libra fëmijëve tanë. A është shtjellu, a e keni ngritë këtë në Ministrinë e Arsimit që kjo mënyrë si ka shku vitin e kaluar dhe këtë vit është gabim për arsyse se librat më së miri është me u dhënë te shkolla. Më e keqja është që edhe kur të shkojsh në libraria të thonë ose komplet librat ose nuk mundesh me i marrë hiq fare me i nda. Kjo ka qenë një punë e mundimshe.

**z.Sokol Shaqiri:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Kam kërkesë për ndriçimin e rrugës "Terpezë-Pozheran, konkretisht rruga "Fazli Hajdari". Shtyllat janë, vetëm ndriçimi mungon. Çështja tjetër është me urgjencë, që kërkojmë pastrimin e urës te rruga për Pozheran, konkretisht tek qeshmja, për shkak të mbushjes me mbeturima. Kjo urë është me lartësi 3 metra. Për momentin ura ka mbetë dhe gjysmën metre pa u mbyllur, ku në rast reshjeve atmosferike ka mundësi të vershoj shumë shtëpi për rreth. Kam edhe një kërkesë të fshatit Tërpezë përscri, rrugën Fshati i Ri, Qifllak, Tërpezë, Zhitë, Devajë përafersisht është rrugë 1 mijë e 200 metra.

**z.Ali Bajrami:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Pyetjen e parë e kam për drejtoreshen e financave në takimin e kuvendit para fundit. Pyetjen që kam parashtruar rreth projektit të Bashkimit European Krosborderit në Komunën e Vitisë. Pyetjen që kam bërë, kush është fituesi, përgjigjen e kam marrë një kompani profesionale. Takimin e KPF-së që keni pas, aty nuk pashë kompani fituese, pash emrat e 3 llotove dhe 3 personave që janë përfytyes të atij projekti. Pyetja ime direkte është, kërkoj me më spjegju çfarë shërbime profesionale prej atyre 3 individeve keni ble, që vlera është mbi 50 mijë euro. Pyetjen tjetër për drejtoreshën e shëndetësisë. Gjithëherë

pyejtet që ti kam bërë ke qenë shumë transparent. Po më inetereson në QKMF, puntorët me marrëdhënie të përhershme të punës sa janë dhe punëtorë me kontratë sa janë.

**z.Remzi Salihu:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Pyetja parë ndahet në 2 persona: në drejtoreshën e financave dhe kryetarin e komunës. Drejtoreshë, dua ta di se a është bërë ekzekutimi i mjeteve prej 136 mijë e 234 euro sipas kërkesës së përmbartuesit, duke u mbështetur në Aktgjykimin Nr.129/19, qëllimisht për mos me dashtë me dal emra, e keni këtë me siguri dhe nëse po: kur është bërë?, dhe nëse jo: pse nuk është bërë?. Pyetja dytë është për kryetarin, nënkryetarit se kush do të jetë përgjegjës për këtë dëm që është bërë sipas këtij aktgjykimit. D.m.th është fjala për një dëm atje te asflatimi i rruges ka Binça dhe dëmtimi nga lumi "Morava". Tash mos me hi me përmend emra. Dhe pyetja tjetër për QKMF-në: si qëndron puna te roga e punëtorëve, a ka diçka aty apo se po përflitet se diçka nuk është në rregull me koeficient.

**znj.Liridona Bislimi:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Dua të diskutoj për një temë e cila është duke u përsëritur që nga mandati i kaluar. I nderuar nënkryetar, dua të pyes për komisionin për emërtimin e rrugëve dhe rrugicave në Komunën e Vitisë. Ky komision asnjëherë gjatë mandatit të kaluar nuk ka qenë funksional dhe pse është formu përmes instancave më të rëndësishme. D.m.th, këtu brenda kuvendit komunal nuk është thirrur asnjë mbledhje e vetme. Po hymë ne vitin e fundit të kësaj legjislature, e njëjta gjë është përsëritur dhe në këtë mandat ne kemi mbajtur mbledhje. E dimë që në mbledhjen e komitetit kemi bërë disa specifika se cilat rrugica si mu emërtu. Keni një mori të kërkesave, veç se të mandatit paraparak të qytetarëve ka dhe kërkesa të tjera të vazhdueshme. A mundemi me ditë pse pikë së pari nuk është duke u bërë ftesa e këtij komisionit, pse nuk jeni duke u angazhu, dhe tjetra kur keni me fillu me i shqyrtu këto kërkesa. Çështja tjetër që dua ta ngris me drejtoreshën e arsimit. Meqenëse kemi pas një informatë shumë të shkurt, duke pas parasysh që kemi vetem 2 çerdhe aktuale publike në Komunën e Vitisë kemi dhe çerdhen tjetër që është duke u ndertuar nga Ministria e Arsimit në fshatin Drobesh gjatë muajit shtator, kam pasur një numër të madh të nënave të grave të familjeve të cilët më kanë kontakti që më kanë pyet, sepse ata kanë mendu që në shtator veqse munden me i regjistru fëmijët e tyre në këtë shkollë dhe kanë fillu me disa përgatitje, mirëpo nuk është që kemi pas ndonjë lajm të detajizum ndonjë informatë. A mundemi me ditë për këta prind për banorët e Komunës së Vitisë se kur ka me u funksionalizu kjo çerdhe dhe me pas ifnormacine shtesë që ata me u pregaditë. Nënkryetar, kam dhe një çështje tjetër. Dua ta përsëris prapë që emailin që e keni pranë, d.m.th kryetari Sokol Haliti prej Ministrisë së Drejtësisë, respektivisht nga ministrja Albulena Haxhiu me datë 18.04.2024, ku ja u ka ofru rekomandimet si institucion për me i ndermarr sa i perket dhunes me bazë gjinore dhe ndaj dhunës së grave, keni pas disa pika ku janë përcjell disa rekomandime, janë kërku tema të specifikume të rëndësishme, ndër to lidhet me nivelin e sigurisë për pavarësimin financiar të dhunës në familje për pagesën e qiras për mbulimin e shpenzimeve mujore për viktimat dhe nuk e keni kthy fare këtë e-mail, nuk jeni përgjigj. A mundemi me ditë se pse ka ndodhë kjo dhe kur keni me fillu me pas mirëkuptim për këtë e-mail të dërguar zyrtarisht.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Liridonë, një përgjigje të shkurtë për pyetjen e parë që e bërë në lidhje me komisionin për emërtimin e rrugëve, është përgjegjësi e jona jo e ekzekutivit dhe parimisht ne kemi bërë një kërkesë. Këta na kanë tregu që në bazë të ligjit, 10 vite nuk mund të bëhet permirësimi dhe ndryshimi të rrugëve, ndërsa nuk kemi pas një kërkesë për emërtimin e rrugëve të reja dhe për atë ka qenë që nuk u ftu kjo. Nuk është problem, mund të ftojme të diskutojmë të analizojmë, mirëpo është përgjegjësi e jona.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Unë në pjesën e ekzekutives që më takon, kam bërë angazhimin, kam pas takim dhe me drejtorin dhe me personin përgjegjës dhe në konsultim me udhëzimet administrative dhe ligjin që ekziston për emërtimin e rrugëve dhe shesheve, kam marrë të njëjtën përgjigje, ashtu thotë ligji. Dhe tjetra e cila më ka interesu, për shkak që ka kërkesa, plotësisht pajtohem me emra të ri, rrugët të cilat kanë ndodh pas emërtimit të rrugëve që kemi bërë dhe ka rrugica që ka mbi 10 shtëpi mund të vendosen emrat, por jo të ri, por emra nga lista rezerv dhe të gjithë ata që kanë bërë kërkesë nuk pajtohen me ata emra rezervë dhe prandaj çështja është kjo që është, nuk është neglizhencë, por kur kanë shku te zyrtari, zyrtari është obligativ me i tregu në raport në përputhje me ligjin që i ka normativat në fuqi dhe personat në fjalë dëshirojnë ata emrat të vendosen nga kërkesa që ka buru e tyre dhe kjo është ajo problematikë që kjo problematikë

duhet të kaloj jo nga emërtimi që keni bërë ju, po nga hyrja në sistem të Agjencionit Kadastral të Kosovës, kur kjo periudhë kalon. Kështu është gjendja.

**z.Basri Syljemani:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Kërkoj nga Drejtoria e Kulturës për fushat e sportit në të gjithë Vitisë. A ka shkolla a fshati nuk e di dhe cilat janë të rregullime, cilat nuk janë. Dhe për drejtorin e inspeksionit kërkoj prej tij për mbeturinat të cilat po hudhen, si p.sh.: në Goshicë dhe Verban, Sodovina Muhagjerëve, rruga për Letnicë, kisha kërku prej juve me i vendos kamerat e fshehta nëse ka mundësi me i bërë dhe me identifikimi njerëzit 2-3 persona me i dënu. Besoj që ky problem zgjidhet.

**zaj.Majlinda Shabani:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Çështja e ujit të pijshëm po besoj që është njëra prej problemeve më të mëdha që i kemi në Komunën e Vitisë, ku fatkeqësisht akoma nuk po gjejmë zgjidhje, ku kemi me pas rast me diskutu dhe planin e buxhetit, mirëpo kam me adresu një shqetësim tek drejtoresha e arsimit. Mua më kanë njoftu që shkolla "Bafti Haxhiu" në Viti tash një muaj nuk ka ujë. Dasha ta pyes drejtoreshën: a është e infomume për këtë dhe cilat janë hapat që i ka ndërmarr apo që pret me i ndërmarr. Në pyetjen tjetër besoj që nënkryetari mund të përgjigjet. Administratorët e fshatrave tash e një kohë ju ka kalu mandati dhe këtu kam një pyetje se: a ka planifikimi komuna me fillu procesin e zgjedhjeve së administratorëve të fshatrave, ku e dimë sa të rëndësishëm janë ata me u përfshi në procese ku paraqesin nevojat që i kanë fshatrat. Dhe tjetra, para 1 jave kam bërë një vizitë te objekti i zjarrfikësve, ku i kam parë gjendjen e objektit dhe në bazë të bisedes që kam pas me zjarrfikësit, kam par që ai objekt ka nevojë që një pastruese. Mqenëse kemi drejtorin këtu, si është mundësia që me angazhu një pastrues, punëtor teknik në objekt të zjarrfikësve.

**z.Sejdi Emini:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Ka qenë një kërkesë e mëhershme, ku në Komunën e Vitisë është e domosdoshme të jetë një shkollë e muzikës, mirëpo kjo nuk ka ndodh ende. Kërkesat kanë me qenë të vazhdueshme deri sa të realizohet kjo e drejtë e fëmijëve tanë si qytetarë të komunës sonë. Kemi thanë që, nëse nuk është e mundur me u hap taman si shkollë e plotë, në të bëhet një paralele e ndarë e shkollës së Gjilanit të muzikës, sepse e kemi përmend dhe përsërisim që Kamenica e ka. Kur Kamenica e gëzon këtë të drejtë me më pak banor, pse Vitia, talentët tanë mos ta gëzojnë këtë. Nëse është punu në këtë drjetim, është mirë që drejtoresha të na njoftoj dhe çka e ka ndërmend me bërë me të. U përmenden edhe administratorët e fshatrave. Ka qenë një rregullore ku administratorët e fshatrave është dashtë të paguhet së paku 300 euro në vit. Nuk e di pse kjo asnjëherë nuk është realizu, mirëpo besoj që pasi i përfaqësojnë qytetarët ku veprojnë aty është e drejtë e tyre që ta gëzojnë këtë të drejtë t'i kompenzojnë, sepse përndryshe vetëm pse nuk po muajnë ata nuk po e e meritojnë ata. Basriu tha që, në Goshicë janë disa mbeaturina. Është fakt që kemi përsëritë më herët, është e vërtet, është mirë që Drejtoria e Inspeksionit të merret seriozisht, të del në teren, ti shof këto mbeturinat të cilat e kanë shumtu natyrën. Kam thanë dhe më herët që, ajo pjesë vizitohet dhe prej fshatrave tjera.

**z.Basri Aliu, drejtor:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Nexhati kishte problemin e rrymes në Trestenik. Të informoj Nexhat që, ne kërkesën e banorëve e kemi dërgu në KEDS, por si the dhe vetë KEDS-i është kompani private, d.m.th obligimin tonë si komunë dhe trysnin jemi tu e bërë. Tani edhe KEDS-i e ka bërë, çdo kërkesë që e dërgojmë duhet të paguajmë diçka. Për ndriçimin e rrugës në Terpezë, realisht është një kontratë e cila e ka ndërrimin e ndriçimit të më hershëm, me eficiencë që e parashef edhe ligji për ndriçime të reja. Ne do të mandohemi ti shtymë ato, por deri sa të plotësohet kjo normë tjetër, atëherë do të fillojmë me ndriçime të reja nëpër vende ku kanë mbetur pa u kompletu rrugët të cilat janë të qarkullushme. Për pastrimin e urës, aty do të shohim nëse është me projektin e kanaleve, sigurisht do të intervenojmë aty ta eliminojmë atë pengesë. Për pastruesin e ndërtesës së zjarrfikësve, realisht tash zjarrfikësit kanë një objekt mjaft të kompletum. Ka nevojë çdo herë për përmirësime. Ne do të shohim dhe për pastrues, po ata realisht janë tu e mbajt njëherë gjendjen vetë. Me kontratë të re do të shohim numër më të madh të pastruesve me kompani, në mënyrë që ta dërgojmë edhe atje një punëtorë për pastrimin e atij objekti.

**z.Valmir Sahiti, drejtori:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Në pyetjen e z.Basri, në lidhje me fushat sportive të rregulluara brenda Komunës së Vitisë, edhe pse me këtë proces menaxhon Zyra e Projekteve dhe drejtoritë komunale kanë pak qasje në investimet kapitale. Mund të themë lirisht se të gjitha fshatrat e Vitisë kanë fusha sportive, disa fusha të asfaltuara dhe disa është procesi i shtruarjes me gomë të fushave sportive, ku

Komuna e Vitisë dhe gjatë vitit 2024 ka pas një kontratë dhe e di që është në planifikim buxheti të vazhdoj me këtë proces që të vazhdoj gjatë vitit 2025.

**znj.Merrushe Ahmeti, drejtoreshë:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Sa i përket, z.Aliu për numrin e punëtorëve në QKMF, punëtorët që janë të përbërshëm është nr.142, ndërsa personat që ofrojnë shërbime dhe janë me kontrata të veçanta nuk mund me dhanë një numër specifik për arsye se ka lëvizje çdo muaj, mirëpo është mbi 100, ndërsa sa i përket në lidhje me koeficientet është një çështje jashtëzakonisht profesionale dhe si e tillë ato janë të rregulluar me vendim të kushtetutës dhe si e tillë ajo nuk është çështje që më perket mua dhe nuk është kompetencë e imja. Për këtë arsye edhe gjatë takimeve që kanë qenë të bëjnë me koeficient nuk kam marrë pjesë për arsye se nuk lidhet drejtpërdrejt me mua. Si dokument, koeficientet e kanë një autorizues dhe një aprovues, dhe si e tillë ato duhet të japin përgjigje në qoftë se ka parregullsi në këtë dokument.

**znj.Arta Ajeti, drejtoresha:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Këshilltari Musli për furnizimin me libra, siç dihet furnizimi me tekste shkollore është sfiduese edhe pse të dhënat që i posedojmë nga drejtorët e shkollave prej klasës 1-5 është mjaftueshëm e mirë për nivelin 6-9 me disa vështirësi, por janë furnizuar me këta nxënës, por këtë e ka vendos MASH-ti, nuk është prej komunës, edhe pse një pjesë e prindërve mund me thanë që kanë kërku ndihmë tek zyrat e DKA-së, ku zyrtarët tanë ju kanë ndihmu për të apliku në e-Kosova. Liridona, sa i përket çerdhes në fshatin Drobesh, siç e dimë nga viti i kalum, kam bërë kërkesë për rritje të stafit, për arsye se kemi në ngarkesë. Më është leju stafi, mirëpo ka hy në qarkoren e re buxhetore, kështu që. stafin e kemi për vitin 2025. Siç dihet dhe inventarin e kemi prej Ministrisë së Arsimit dhe pse ne dokumentacionin kemi kompletu. Këtu kam formu dhe komisionin, kemi përcjell në MASHT, atje ende nuk jemi furnizu me inventar, kështu që shpresojmë që 2025 ta kemi të hapur, kjo nuk varet prej komunës. Majlinda, sa po e konfirmim për shkollën fillore "Bafiti Haxhiu" uje ka, kjo nuk është e vertet. Sejdi, në pyetje për shkollën e muzikës, kemi mendu ta hapim në objektin e inkubatorit, po përdërisa e kemi objektin në ndërtim e sipër, nuk mund të themë asgjë, por është mendu.

**znj.Milihate Ajeti, drejtoreshë:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! z.Ali, projekti me Bashkimin European është 2-vjeçar. E menaxhojnë menaxherat, është një investim kapital, është një projekt kogjo i madhë për Komunën e Vitisë, ku është vlera mbi 1 milion euro. Ende nuk ka fillu, është 2 vjeçar dhe është me 3 loto. D.m.th është drejtpërsëdrejti prej menaxherave, jan 3 menaxhera: Mediona, Besimi dhe Ariani. Këta e rregullojnë, është në proces nuk ka vazhdu ende fillon vitin e ardhshëm.

**z.Ali Bajrami:** Drejtoreshë, është në fillim e kuart, projekt 2-vjeçar: çfarë shërbime keni ble? Se mjete të këtyre 3 perosnave ju kanë pagu. Për mua kjo është e pakuptim. A janë kompani që i kryen këto shërbime a janë individ?

**z.Fadil Abazi, shef i prokurimit:** Deshta të jap pak kotribut që ka të bëjë me Krosborderin. Krosborder është një iniciativë ndërkomunale e dy shteteve fqinje, me qëllim të avancimit, bashkëpunimit dhe ka disa vite që realizohet në Komunën e Vitisë. Komuna e Vitisë nuk është implementuse, por është përfituese. Si përfituese marrëveshje Komuna e Vitisë ju kanë nda që këta udhëheqës, d.m.th këta menaxhera me udhëheq projektin e me i pagu komuna, ndërsa projekti si projekt i cili do të zbatohet do ta bëjë initiative progresive europiane, i cili është formu nga Bashkimi European dhe ai projekt, këta menaxhera bashkëpunojnë me IEP dhe bëjnë projektin, fillojnë me zbatu, projektin, nuk ka ardh ende, mirëpo projekti në përgjithësi ka të bëjë me ambientin, me mbrojtje të ndryshimeve klimatike, d.m.th e ka misionin me i ulë ndryshimet klimatike. Mbrojtjen e ambientit, d.m.th e ka kuptimin pozitiv me qëllim që qytetarët e Komunës së Vitisë të përfitojnë, prandaj projekti si projekt nuk ka ardh. Këta janë konsulent profesioanl të cilët na kanë dhanë për herë të parë neve me i zgjedh. Herave tjera nuk i kemi zgjedh ne, mirëpo tash na kanë dhanë neve dhe kemi zgjedh 3 konsulent profesional me menaxherin, prandaj ata janë në zhvillim të punimeve dhe do ta bëjnë projektin. Projektin nuk e udhëheqim ne e udhëheq ky IEP me këta bashkëpunëtorët, ndërsa ne jemi vetëm përfitues. Nuk ka komuna projekt që do ta zbatoj, do ta zbatoj Bashkimi European këtu në bashkëpunim me Komunën e Gostivarit. Më heret kemi pas me Komunën e Krivopallankes, ndërsa tash kemi me Gostivarin këtu. Është bashkëpunim me komunat të cilat janë me regjione kufitare.

**z.Ali Bajrami:** Krejt i kam të njoftum, krejt i di, një është tu më interesu: a ka shku përmes tenderimit, përmes Zyrës së Prokurimit, çka ka qenë kriteri që i keni përzgjedh këta 3 individ? Këtë tregom.

**z.Fadil Abazi, shef i prokurimit:** Ka qenë thirrje publike e hapur dhe kanë konkuru njerëzit që kanë pas interesim. Ka qenë i shpallur 20 ditë, ka qenë i hapur gjithkush që ka pas interesim ka mund të aplikoj. Kushtet dhe kriteret kanë qenë profesionale për njerzit të cilet ju kanë përshtat të njetit projekt.

**z.Ali Bajrami:** A janë persona fizik apo juridik?

**z.Fadil Abazi, shef i prokurimit:** Jo këta janë persona fizik profesional, konsulent.

**z.Ali Bajrami:** Çfarë shërbime kanë ble për këtë vlerë monetare që keni pagu?

**z.Fadil Abazi, shef i prokurimit:** Ata janë tu punu në projekt dhe janë tu përgatit projektin me shpall projektin me gjithë përfituesin e implementimin e projektit me të cilin projekt fizik për me përfitu qytetarët që zakonisht janë projekte që kanë të bëjnë me ambientin. D.m.th me rritjen e cilësisë së qytetarëve të Komunës së Vitisë.

**z.Ali Bajrami:** Unë jam tu të pyet direkt. Çka është tu më interesu jam tu të bë pyetje shumë të kuart. Këtu Krosborderi, projekti i Bashkimit European po përfitues Komuna Vitisë, po në këtë 126 mijë euro ka participu dhe Komuna e Vitisë, lloja 1 dhe 3, diku është në janar lloja, 2 pse ka qenë me 5-6 mujë vones është caktu kush me marrë kush me fitu.

**z.Fadil Abazi, shef i prokurimit:** Jo më fal, por po e keqkupton po keq interpreton lloja 2 ka dehsut sepse kur e ekmi shpall nuk ka konkuru askush, një here ka konkuru një, ne kemi shpall unë i kam procedurat vjenë i kqyr është shpall tenderi nuk ka ardh asksuh u shpallë për së dyti ka konkuri njëri nuk i ka plotsu kushtet ka ardhë për së tret ka përfitu, këto janë procedura që ne nuk i shkelim jo kush të na vjen kush të naj qojn nuk bënë me qen subjektiv nëse nuk ke bazë të arsyshme për me arsyetu atë që pe thu, ti po fol me tendenc po donë me gjete diqka qka nuk është me thanë diqka që nuk qendorn.

**z.Ali Bajrami:** Gjithë here njeri atë që e mendon dhe e thotë unë kurrfar tendence kunder askujt nuk kam.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Këtu në kuvend mundë të bëhen pyetjet politike me tendec pa tendenc përgjigjet duhet të ipena to që janë të rregullta.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Unë veç një në këtë rast Ali do ta kisha thanë që, çështja e Krosborderit janë kriter që i cakton dikush tjetër. Kush i cakton, ata të cilet i japin mjetet ndersa për të gjitha të tjerat aty ku ndoshta mundë me dyshu ti ke të drejtë në qasje në dokumente publike shkon i merrë i shikon dhe gjithqka është ënë rregull. Jakup qështja tek sheshi tu ndertu një barak privatisht me siguri drejtori i shërbimeve publike nuk ke mundë me qenë më në rrjedha ka pas kerkesa apo nuk ka pasë është një realitet që kemi një munges maajve të fundit në drejtorin e inspeksionit nuk e kemi drejtorin këtu që me ditë më saktësisht unë besoj se të gjithë ata të cilët kanë ndertu aty duhet t'ë paisjen me leje ata që kanë pasë bazë ndersa ata të cilet nuk kanë pasë bazë janë penges duhet të menjahohen nga hapsira mos të pengohen se është ëbër ënjë qender e bukur dhe për një individ nuk mundë me ja prish atë bukuri se është një investim i madhë. Taulant për qështjen e rruges me kallderm nuk është bërë pranimi teknik dhederi sa të behet pranimi teknik unë nuk du me ndery se gjithërher në profesionalizem të dikujt nuk nderhy në shikimin timë mundë me i pasë ato vrejtitet e mia sikur ti por megjithatë duhet t'ajapin profesionalistat vendimin e vetë, një prej atyre idhtareve kam qenë un që me u ndertu kalldermen gjithëhre e mbroj ndesh në aspekt publik ndesh individual se kam dashtë që Vitia të jetë e Vitiasve në rastë se kupton qka themë kuptoje. Rruga Hasan Prishtina e dijam marrë se nuk ka kshilltar këtu që i bëni pyetjet që i anashkaloj momentin që shkoj në zyre ju drejtohem me telefon kemi mungesen e drejtroit dhe inspektorit të komunikacionit sipas rregullores inspektorit i komunikacionit është ai i icli në bazë të kriterëve edhe në bazë të situtes duhet me caktu a anevojitet apo jo dhe madhesia e asaj gjithqka jashtë asaj sikur këtu që na kanë bërë një dhe ti si kshilltar nuk je për ato por je për me pasë një polic të shtrir konfrom rregullave të komunikacionit, besoj që momentin e kompletimit të drejtoris ajo qështje duhet me dalë në vend të ngjarjes nuk po themë që kanë me qitë e konstatojnë ata me siguri duhet me të thirrë ty me bashkpunu is inicues i asaj dheunë jam për me i mbrojtë qyteatret së bashku mety. Te qështja e zyreve nuk e kemi bë nga qefi por nga presioni që kemi pasë nga niveli qendror jo partiak përshkak shumë here kemi pas presion dhe nga ana juaj te qështja e zyrës së personave të penzionereve kemi shtriu atë qështje me i qu dhe te komuna e re kati parë ishte i zantë për katë të

uete ata kan qene atje dhe gjithëhere në kordinim dhe me propozues që e kontrollojn nga niveli qendor ka ardh konstatimi afer policis me qene ata dhe ne e kemi lëshu atë objekt e kemi marrë këtë, hiq më pak nuk kemi lëshu po veq më shumë por nuk ka qene qeshtja e qendres se edhe në qender kemi qene, neve dhe na ka kushtu dhe në donacione për me rregullu por nuk është bër as nga ana e pushtetit as nga mendjemadhësia por është bër për me ju ofru një objekt pensionistav dhe dikund është dashtë me u stacionu. Nexhat unë e di që këtë qeshtje vazhdimisht e ke shtru është një qeshtje që me të vertet ke pasë edhe arsyesmerin që e ke shtru, punëkryesi sun i ka kry në afatin e parapam i ka lanë në atë formë dhe ne nuk e kemi bër pagesen për atë dhe besoj që është hy në këtë projektin tjetër, gjithëhere që po e shtron këtë a ka plan dinamik pikërisht nga plani dinamik që ka ai në momentin që e nuk e kryn dhe bënë kërkes për shkeputje të kontrates. Ujësajllsi për 5 fshatra ky projekt e dinë edhe ti ndoshta më mirë se unë përshkak se të ka prek në lokalitet ka qene i kahershem tani e kemi zhvillu ne në masë 1 vjetë e teper konsideroj kemi pasë vazhdimisht dhe gjithëhere hidromorava është shpreh se nuk mundem me marrë në menaxhim deri sa sasia e manganit është jashtë standardeve të parapame, pas përdorimit bukur të gjatë që keni përdor ju dhe 2 Sodovinat mangani ka ra ne kemi nënshkru një kontrat për me marrë ata në menaxhim por megjithatë në kontrat e kemi një aneks përshkak të dy sllatinave të cilët kishin qene disa defekte kalimi i kohes ka bër dhe defekte të tjera dhe kemi formu një komison të përbashket me hidromoraven dhe kan dalë na e kan caktu qka duhet me ndrrur për me u funksionalizu dhe për 2 lokalitetet tjera shumë është bukur e madhe prej eksperteve diku mbi 80 mijë euro dhe është e aspektit elektrik së shpejti do të jetë në procedur do të rregullohet dhe kjo qeshtje dhe konsideroj që do të jeni 5 lokalitetet më me fatë që do të keni ujë të kontrolluar dhe nga ana e hidromoraves dhe në sistem të rregullt dhe të pagesave.

**z.Basri Sylejmani:** Nuk e di se si merrë pagesa "Hidromorava", kur unë 13 euro kam pagu dhe pse jetoj vetem me bashkëshorten, kurse uji thujse është i papërdorshem. Unë propozoj me nderpre.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Këto shqetesime ish kryesuesi Naim Pira ja ka pas shfaq drejtoreshes së Entit Higjenik në Gjilan dhe me gotë e kish fotografu, dhe i tha dëgjo kryesues uji mundë të ketë dhe këtë ngjyr por një qeshtje njëri që smuhet nga pirja e këtij uji nuk ka me pasë kurr se është plotesisht i kontrollum dhe i dezinfektum. Të gjitha ato brengat të cilat i keni mundë të i drejtoheni hidromoraves se ajo ka për obligim edhe manxhimin ka dhe kontrat me entin që e kontrollon qdo 15 ditë vinë e marrin monstren nuk e di saktesisht e dergojn dhe i marrin masat unë nuk jam profesionalist i asaj qeshtje, në bordë prej Vitis si e di unë nuk e kemi askënd, nuk duhet me qene në atë laik duhet me ditë që bordi e shpallin një konkurs konkuroj njerzit e bojn selektimin e proceduren e rekrutimit dhe zgjedin që ne nuk pyetemi hiq kështu shkon bordi në hidromorav. Musli ndoshta kemi mujtë me u keqkuptu në fjalorin timë kurr nuk kam thanë e dini ju këtu shumica e kshilltareve janë gjenerat me mu qe 12 vite Hasan Aliun nuk mundësh me shti me u zotu pa u varë prej gjepit timë, kam mujtë me thanë në bazë të kontrates ajo lëshjohet në shator po që të kam thanë zotohem dhe po të zotohem 200 herë se nuk kam thanë se nuk është në fjalorin timë fjala zotohem. Në takimin e parë që kam qene që kan kërku ata me u shpernda se unë kam kontribu së bashku me drejtoreshen dhe me 2 drejtoren dhe për shperndarjen me të pengu atje me gjimnazin edhe atë drejtorin qemajlin se sun e kmei nderpre mesimin kam qene dhe unë që e falemdinerpoj për mirëkuptimin që kam pasë dhe atëhere është flië gjithëhere për shtaotrë që ka me u lëshu, tash sun e kan bër në far gjendje është tani nuk e di ti e dinë më mirë se je aty qdo ditë por vetem këtë qeshtjen e zotimit hjeke se ketë nuk e përdori kurr.

**z.Basri Sylejmani:** Konsideroj që përgjigjet i ke dhanë të sakta, ama ne prej sodit kryesusi ne ta thirrë një mbledhje, me thirrë Kemurin këtu dhe ta dimë se ku jemi, pse me pagu unë 13 euro për 1 muaj. Nuk është në pyetje vetëm Basria, por të gjithë qytetarët e Vitisë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Unë si shqetësim tandin e kam shënu. Në momentin që bisedoj me "Hidromoraven". Ne kmei takime dhe të nivelit regional, jo vetem nivelit komunal. Unë e ngriti shqetësimin tandë serisht të gjithëve, se uji shpeshhere shkon i trubullt.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Ne duhet ti kërkojmë drejtorit të shërbimeve publike, dhe ky ja kërkon një raport dhe e sjellë në kuvend.

**Z. Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Musli, e ngrite një çështje shumë të rëndësishme dhe çështjen që ta dha drejtoresha, që konsideroj këtu lejimi i provave në Kosovë gjithëherë po na deshton, jo që po mësohemi me një sistem të mëhershëm, që unë konsideroj ka qenë shumë më funksional, librat në shkollë me ja dhanë nxënësve se kjo, dhe unë familjen e kam bukur të përfshime në proces edukativ arsimit dhe ti e dinë që me të 1 kur të shkojsh veq duhet me psa orarin dhe me fillu zhvillim dhe tash është zhagit ndoshta 1 javë apo 10 ditë pska puntor të arsimit të mos kompletimit të marrë me kompletim se nuk mundë me zhvillu ajo në klasë të dytë nëse nuk i ka fletoret e punës, ndoshta edhe ky vitë që e kan parë që është i gabushem e gjejnë një sistem më të mirë s edhe të unë ka qenë brengosese se përvq që jan drejtu në DKA ju kan drejtu dhe zyres së kryetarit, si shqetsim ne takimet që kemi psat me asosacion e kemi ngritë ndoshta e ke vrej edhe atë drejtorin egzekutiv që i shfaq këto pengesat që i kan afri kryetaret nëpër takimev të bordeve dhe një prej saj ka qenë dhe qështja me kompletim të librave dhe tash jemi diku 25 vite pas qlirimit me 25 gusht duhet me u aprvu plani i pergjithshem i procesit vitit shkollor me të parin veq e jepë orarin dhe fillon mesim efektiv jo 10 ditë mos me pasë orar e gjera të tjera. Sokol më duket morre përgjigje unë besoj që disa pjesë jan kry dhe ajo po shkon tu kry kur do ta ketë perfundimin nuk jam lidhë me kontrat. Remzi egzkuetimi i mjeteve 136 mi euro ng apermbarusi nuk e di ka shumë do t ëinteresohe a u egzekutu apo jo nuk e di qdo detaj nuk më ka ra në sy nëse je në dijeni mundesh me ma kjartsu nëse jo në momentin e perfundimit të kuvendit do të interesohe me pasqyrat financiare delë kjo dhe do ta shikoj për qka është ëbër ky egzekutim, një e di që këto ditë më ka interesu përshkak kerkesave tona që do të jenë besoj edhe të juaja diku nga kontrata kolektive deri sot komuna e Vitisë kishte pagu nga informacionet që mi kan dhanë mbi 5.5 milion nga t ëgjitha kategorit parat që janë marrë tash nuk i kan marrë veq arsimatert por edhe avokatet por buxheti i komunes së Vitisë është demtu kaq gjithëherë po flas nga zyret e drejtrtis së financave konkretisht Islamit që i kam kërku para 1 jave me mi sjellë dmth këto jan krejt vitet në realizmin e kontrates kolektive. Qdo qeveri është trasheguse e vendimeve të më parshme ka qenë një qeveri e më parshme që e ka nënshkru tani ka ardh e dyta që e ka vazhdu ka ardhë e treta që nuk e ka ndalë. Remzi pyetja tjetër the që kush do të jetë përgjegjes, gjithmone përgjegjes duhet me qenë ai që nuk e ka kry punen e vetë ligji e percakton dhe përgjegjis. Dhe ke një rekomandimet nga ministresha Albulena Haxhiu unë e di se një kohë është marrë lbadeti me kryetarin Liridonë me këto a i ka kthy apo nuk i ka kthy veq një qështje duhet ta kemi të kjart paska këtu jurista, kompetenca e deleguar duhet të vie me buxhet gjithëherë kur niveli qendor i delegon një kompetenc Besimit me kry punen duhet me siguri dhe buxhetin kjo është rregull a këta na mbyten kështu na ka kushtu dhe kontrata kolektive nuk dua ti arsyetoj as këta të sodit as të ma hershmit kur ti delegojsh dikujt kompetenc ti automatikisht duhesh me ja siguru buxhetin ata më duket veq kur po kan me bë letra apo kur po ndodh diqka që i trondit edhe mua më ka trondit ato rastet qëi ke ngrit se ajo që ka ndodh atje mundet me i ndodh vajzes, fmies, meses sime gjithëherë ajo është shqetsuse se gjithëherë duhe të mesohemi dhe aty ku jemi duhet me i than të gjithë se unë e ngriti kë të qështje se ju mendoni se jam kritik veq ndaj të tjereve jo edhe nga familja politike e imja në rsatë se mendon me delegu diqka duhesh me qu buxhetin. Basri qështjen e mbeturinave më duket se është koha e fundit duhet të ulemi si shoqeri, unë gjithëherë mendoj që ndoshta forma më e mirë pa ngjyrimet politike është mendimi i imi me ulë me organizu një tryez të rumbullaket në kë të ofomrë dhe me gjetë një qështje unë e kam mendimin timë me i marrë fakturat e tatimit në pronë automatikisht me i regjistru krejt me kriter me vendos cilet po i hekim që falen nga pagesa me caktu zyrtarin ndoshta është edhe i kunderlishgjem po përderi sa vedisohe mi prë 4-5 vite kan me shku ne komun për dokument me marrë vertetim unë e di që është shkelje e lirive dhe të drejtave të njeriut por me të vertet kjo qështje është alarmante që ne duhet të nderamrrim diqka, kot e kemi me këot që po bëjmë përpjekje po harjgojm pare majftushme për me shku mi hekë mbeutirnat por ata serisht po hedhin nuk e di sa kishin bë punë kamerat por forma më e mirë ka qenë deri sa ta insteoljm një rregull në këtëformë ndoshta kur të hgynë në sistem në këtë formë dhe sikur pagesa e rrymes elektrike nuk ka nevoj me të ardh te shpia vetë pe pagun. Qështja e kshillit të fshtarave ju e dini që ka qenë një komision miks nga egzekutiva dhe kuvendi i kalum i cili kabërë përzgjedhjen besoj se duhet të ulemi një ditë dhe ta shikojm atë mundesi ta shikojm kohen kur është më e pershtatshme, qështjen e pageses ju e dini që ligji i pagave na ka ndalu dhe shumë mekanizma tjerë na e ka ndalu dhe KKSB është viti i 2 që nuk jan pagu, pa dashtë me i konstetu por një vendim që i ka zanë të themelum që jan kan tu pagu dhe i ja u ka ndalu, ndoshta nxjerrin ndonjë udhezim

administrativ që rregullojnë edhe qështjen e komitetit por edhe të kryetareve të fshatrave se me të vertet në rastë se me ligjë i ke parapa se duhet të formohen qështjen e pageses e ke lanë, tash a duhet me ja gjuajt komunes a e ndal nivelin qendor leshon mjete për ata a bënë ndonjë rregullim me udhezim administrativ se cili lokalitet mundë të ketë kryetar të fshatrave, se tani ne kemi kryetar të fshatrave dhe qytetit të Vitisë por kemi dhe kryetar të Binçes duhet të jemi parimor nuk është i njëjti rolë dhe e njëjta punë apo kryetari i Pozheranit, Smires me të Dobolldhut apo Mjakut, unë e di që ka kërkesa për zhvillimin e fshatit të vetë por tash shtrohet problematika dhe punët e këtyre lokaliteteve, beosj se këtu ka punë mjaft shumë. Para se të vazhdojm desha ta bëjë një njoftim ju jeni ata që e keni votu një shesh Hasan Aliu në Viti po pregaditet shtatorja me 10 tetor behet zbulimi i sajë si kuvend jeni të ftuar pa dallim të gjithë me 10 tetor ora 10:00.

**z.Basri Sylejamni:** Jeni të ftuar të gjithë në kuvend komunal nesër në ora 10:45 kemi kurora para shtëpisë së kulturës, ora 11 kemi në Sodovinë, ora 11:15 te fusha e sportit jeni të mirëseardhur të gjithë.

**z.Jakup Demiri:** Me gjithëse unë nuk e parashtrova pyetjen, te uji i pijshëm, në shkollën "Bafti Haxhiu" drejtoresha e dha një përgjigje që ujë ka. Tani më erdhi edhe informacioni nuk e është i sakt që nuk ka ujë. Informacioni është bash i sakt, që nuk ka ujë drejtoreshë në shkollë. Po të tregoj se kam një mbcesë dhe e dërgoj shpeshë në shkollë, dhe aty ujë i blej se ujë nuk ka. Ndoshta është rregullu tani, po për 1 muaj nuk ka pas. Do të ishte mirë, pasi që jemi në muajin shtator dhe ka fillu procesi mësimor gati qe 1 muaj, me pas një raport se a kanë fillu të gjitha shkollat, cilat janë problematikat, nuk kemi asnjë pikë të rendit ditës, nuk kemi raport në rregull, jemi. Po tash për informatë është e sakt se shkolla "Bafti Haxhiu" po thuat se shumë shkolla të tjera, e di që para 2 vite kanë pas problem 9-10 shkolla, nuk kanë pas problem gjithë vitin, kjo problematikë është ende.

**z.Taulant Haxhiu:** Nënkyetar, po lidhem prap te ky sheshi. Po thua unë kam dashtë me bë një shesh me kallderm, me ja u dhanë vitiasve. Është e vërtet pajtohem me të, është mirë, bukur, por unë jam tu folë për cilësi, kualitet nuk ka, edhe ti e din sakt. Tash folim në interes të përgjithshëm, ne mundemi me rregullu gjithëcka po në qfotëse nuk ka qëndrueshmëri dhe cilësi, nuk janë të knaqt qytetarët me atë projekt që kemi bë dhe ti me veturë deri më herët i ke ra në atë pjesë, tani nuk i bjen më, se kur po vozitë si me hecë nëpër gropa. Unë nuk jam kundër sheshit, kunder kalldermes, por jam kundër cilësisë, nuk ka cilësi, nuk ta qon mallin e kalldermes. Te kjo rruga "Hasan Prishtina", unë deri sa po diskutoj tani po më thotë një pronar i lokalit që para 2 jave ka ardh dikush shpejt prej Dardanisë i kish hi në lokal te kafja e lagjes së Eminit. Këtyre nuk ju intereson ku e kemi drejtorin e inspeksionit as ku e kemi inspektorin përkatës, kjo punë është urgjente aty. Te këto zyret, ti mirë the, e keni bë një zyre tjetër, atë e kemi lëshu për dikë tjetër, po 130 metra katror më heret ka qenë NLB dhe tani më mirë ta kishim pas një bank aty ti kishim marrë 2 mijë euro dhe zyret të kishin shku me një lokacion më të vogël, më modest dhe kishim fitu ne si komunë, por ju keni dashtë ashtu, tash po shihet që partia e pushtetit duhet me qenë më e veçume prej partive tjera, partit opozitare ka 12 metra katror, kurse partia e pushtetit 130 metra katror.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Pasi u përmenden zyret e partive, drejtor, kompania që është për mirëmbajtjen e objekteve, se është duke pikë, po na bënë telashe dhe me na rregullu gjithashtu edhe uji është ndalë.

**z.Basri Aliu, drejtori:** Realisht unë e kam ngritë shqetësimin për ujë, se kam pas një këkresë të tillë, por është problemi që lidhja është prej lokalit poshtë ish Drenices, tani Rio, dhe ata e kanë stopu. Unë kam kërku që prej "Hidromoraves" që ata me bë një lidhje të veçant tjetër. Ne rëndësi që duhet me pas ujë për këtë pjesën tjetër. Unë do të interesohem çka ka mundësi, a munden këta punëtorët e ambientit me kry diqka dhe pse heren fundit te Zyra e Penzionistëve kanë interevnu e kanë eliminu një problem, po në qoftë se jo, atëhere shohim me drejtoreshën e arsimit e cila është kompani për mirëmbajtjen e shkollave këtu që ta eliminojmë këtë problem.

**Znj.Liridona Bislimi:** Drejtoreshë, ju falenderoj për përgjigjen lidhur me punimet në çerdhen e fshatit Drobesh. Nënkyetar, sa i përket temës për komisionin për emërtimin e rrugëve dhe rugicave, pajtohem me pagesën për rrugët të cilat kanë qenë të emërtume më herët, mirëpo ne e dimë që si komunë, si institucion vazhdimisht jemi duke pas punime, shtrim të rrugëve të reja dhe qytetarët e shohin të rëndësishme që rrugët me u emërtu për shkak se shumica e tyre punojnë me posta, etj. Po hymë ne vitin e 8 që asnjëherë nuk kemi ftu asnjë mbledhje të vetme me këtë komision, as nuk kemi marrë parasysh landet e mëhereshme me i ditë ne si anëtarë se si qëndrojmë te kjo pjesë. Sa i përket çështja e emailit, po më vjen mirë që e paski kthy më në fund. Po du veç me citu një pjesë që është referu nga ministra, ka kërku raport për të gjitha veprimet e lartcekura, d.m.th janë 32

veprime të cilat janë cekë nga Ministria e Drejtësisë dhe ka kërku raport me u njoftu sa më parë se si qëndron Komuna e Vitisë, cilat veprime janë realizuar plotësisht, cilat janë në procedur të realizimit dhe ato që nuk janë realizuar, kur janë afatet kohore me të cilat do ti realizoni, d.m.th është kërku një raportim se si qëndron Komuna e Vitisë, jo vetëm e Vitisë, por gjitha komunat tjera. Po më duket që po don me ndryshu si një lloj presioni apo trysnie, realisht dhe nuk ka pas të bëjë diçka me fonde, thjesht raportim se si qëndrojmë si komunë, për shkak se kemi pas edhe seancën e kuvendit, dhe të gjithë ju dhe ne kemi shpreh shqetësim në mujin prill për rastin që ka ndodh, prandaj na duhen veprime konkrete, e si ministri është mendu që veprimet konkrete fillojnë me hapa të ndërmarrur, duke pas pikë së pari informacionin se ku qëndrojmë si shoqëri.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Më duket që nuk më ke kuptu në pergjigjen e parë. Lagjet që shtohen munden me shku sot me qitë emërtimin, por jo nga emërtimi i propozuar i tyre, por nga lista rezervë, por kërkesa e banorëve, ata shkojnë me kërkesë, p.sh. emrin ta ketë hipotetikisht Hasan Aliu dhe kur të shkon ai ja qetë listen rezerv dhe nuk është aty i thotë kjo nuk mundet po përzgjedh nga këto ai nuk donë. E dyta ka qenë një shkres e ministres më heret që e dinë ti kur ka kerku edhe qështjen e sigurimit dhe psikolog dhe krejt ato në këtë kontest unë ta thashë që për realizmin të kejt asaj permbushje kur i propozon dikujt met kry diçka duhet me i siguru fondet jo nga raporti se unë e kuptoj çka është raporti.

**z.Majlinda Shabani:** Meqenëse në prill kur kemi parë seancën kam qenë ajo që kemi ngritë si temë diskutimi, po ma realisht po më vjen shumë keq kjo mendësia që po mundohet me u kriju në kuvend komunal, përderisa kemi një nismë qoftë prej nivelit qendror dhe në këtë rast adresohet te komunat dhe në këtë rast kolegja asambleiste shumë mirë që e ngriti këtë çështje, sepse neve na intereson a e keni kthy atë e-mail. Në atë e-mail kanë qenë të përfshime 40 obligime të cilat komuna ish dashtë me i plotësu. Hajde qe po thojm në aspektin e infrastruktures ose subvencionimit e dimë që duhet një punë më e gjatë, për shkak planifikimit në aspekt buxhetor, po njëra prej kërkesave thuhet të shtohen kapacitetet njerëzore dhe profesionale në qendër për punë sociale, bazuar në analizen që e ka bërë ministria e drejtësisë. Unë po besoj që në momentin që ka kalu qendrat për punë sociale në kompetenca të Ministrisë së Drejtësisë, ka qenë njëra prej lajmeve më të mira që kemi marrë, dhe e dimë që komuna duhet me u angazhu në aspekt kur po flasim në aspektin gjinor dhe nuk e di ka qenë çështje që kam ngritë, sepse në qendrën për punë sociale në Komunën e Vitisë e ki të mbushur me jurist, nuk e ki asnjë psikolog që punon në qender për punë sociale, po thojmë që hajde në aspektin e buxhetit nuk kemi mujtë me bë diçka po të paktën në qendrën për punë sociale nevojitet me pas persona adekuat për shkak d.m.th të natyrës së punës që bëhet në Qendër për Punë Sociale, andaj unë këtu kom pritë një përgjigje dhe një qasje pak më ndryshe. Mos të mundohemi që secilën çështje që e ngrisim, që ka të bëjë me nivelin qendror me u mundu që fajin me hedhë diku tjetër, tu mos i përmbush të paktën obligimit që mundemi me i përmbush si komunë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** E nderuara Majlindë, nuk jam prej atyre që kam qef me i ik këtyre çështjeve. Në plotni pajtoj që e udhës me pas një psikolog. Unë nuk tham as se duhet psikolog as se pedagog, po duhet në bazë të organogramit çka kërkon Qendra për Punë Sociale me pas. Tash a duhet me qenë 2 psikolog, 1 apo 3, është çështje e tyre. Në plotni pajtoj këtu. Unë gjithëhere thashë në fund nuk e thashë rastesisht me i blloku sistemin qendror, nuk jam prej kesaj logjike që qajo qeveri që je ti në atë familje ajo qeveri është edhe e imja, unë nuk e kam atë hipotekë. Çdo e arritur e nivelit qendror më gezon edhe mu, por e thash dhe po e përseris kur ke mundësi se tash dasht e pa dasht ti takohesh më shpesh, duhesh me ngrit si çështje në rast se i jepen detyra komunës, i delegohet një kompetencë, krye këtë punë, duhesh me ja dergu dhe buxhetin.

**z.Musli Neziri:** Nënkyetar, në përgjigjen e juaj që e morra rreth punimeve në shkollën e Gjimnazit, mos të keqkuptohemi, nuk e pata që ti je zotu me paret e tua, por je zotu për shkak përgjegjësisë që ke, se je nënkryetar. Dhe më ke thanë kështu profesor, unë takimin që kemi mbajtë punet kanë me u kry në shtator dhe ke thanë prapë do të kemi takime dhe do të fillon mësimi aty. D.m.th kështu ke thanë, se kështu ju kanë thanë ata juve dhe unë nuk të bana pyetje ty që je zotu me paret tua, mos u bë kaq cinik në këtë aspekt që, të thashë që me paret tua me paret të mia, sepse tek e fundit unë nuk të thash z.Hasan, ti je zotu me paret tua. Nëse kështu kam thanë, atëhere mundesh me më thanë. Unë krejt çka kam është shqetësimet që janë ngritë rreth hapësirës në atë shkollë. Ata nxënës, sepse shko pyete drejtorin e "Dëshmorëve të Vitisë", se çka të thotë për ndërrimin që e kanë nxënësit e

pasaites aty. Prandaj nuk të thashë ashtu as nuk të thash që je zotu ti me çdo kusht me u kry, po të thashë je zotu, ke thanë në takimet që kemi pas me punëkryesit, fjalët janë ose zotimet e tyre janë që, mësimi me fillu në shtator në atë objekt. Në fjalimin temë nuk kam qefë me i ndërhy asnjërit, ne ta kryen mendimin e vet, për atë është debati, por jo ta qojmë dorën me nderpre, sepse nuk të nderpreta. Unë thjesht kurr nuk i bëjë pyetjet në prapavi, nuk më intereso pjesa e subjektit politik, edhe drejtorit tim ja bëjë pyetjen atë që mendoj që është në interes të qytetarëve kushdo që është drejtori ose pushteti.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Musli edhe një here. Ti tash e the atë që e kam thanë, që plotësisht pajtohem që kam thanë ashtu. Zotimi është një lloj betimi. Këtë fjalë që e the tash kësaj radhe unë decidivisht kësthu kam thanë në takim kam qenë ti the je zotu unë të thashë nuk zotohem kur nuk është në doren time ti po do mem qitë ne kanal tjetër thash unë mundem me u zotu veq kur i kam në gjepë të miat është karakter është parim i një individi unë nuk e ndroj për ty as për askend tjetër se unë i kam bërë 62 vite me këto, tash kur the që un kam qenë në takim dhe ata kan than se në shtator fillojn nxensit plotësisht kam than ashtu zotimi është diçka tjetër një lloj betimi.

**z.Nexhat Halili:** Kam një sqarim nënkryetar. Te trotuari Trestenik – Sllatinë. Ky trotuar dihet kur ka fillu. A është i përfshirë në kontraten e re trotuari Trestenik-Sllatinë?

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Ashtu nuk jam marrë po të tregoj të drejten, por 99% është se një të cilen nuk është kry dhe ka qenë me heret nuk i pshton kryetarit pa e shtru.

**z.Nexhat Halili:** Unë e kam kontraten këtu para, dhe e kam vetëm pjesën e vazhdimit, nuk e kam dhe pjesën që është fillu puna, kam vetëm pjesën e vazhdimit e cila kapë distancën 725 metra e lidhur me datë 08.08.2024.

**z.Remzi Salihu:** Drejtoreshë e shëndetësisë, nuk e di a unë nuk dita me bë pyetjen mirë apo ti nuk e laburove ashtu siç duhet, dhe i dhavë kahje tjetër. Unë nuk pyeta se kush i krijon politikat e financimit nëpër organet e ndryshme, por pyeta si qëndron puna me rrogat e punëtorëve në QKMF. Dhe ti më dhe një përgjigje krejt tjetër. Po për mos me debatë më teper, unë vetëm po du me thanë kështu. Janë marrë mjete më shumë nga hyrja në fuqi e Ligjit të Pagave prej 01.02.2023 deri më 31.05.2024, çka i bjen kjo p.sh.: nga Ligji i Pagave parashihet kofeicienti 5.1, ndërsa paga është bërë me 5.4.

**znj.Merrushe Ahmeti, drejtoresha:** Atëhere sa i përket përgjigjes sime ke shumë e qartë, ku tregova që nuk është kompetencë e imja. Kofeicientat janë shumë profesionale dhe nuk i harton drejtori dhe nuk i përcakton me fontan dëshirash, ti 5 ti 10. Janë ekipe profesionale që punojnë me atë dokument dhe si e tillë unë plotësisht ashtu siç e parashf dhe ligji nuk kam qenë pjesë e këtij procesi. Meqenëse nuk jam pjesë e procesit nuk e kam kompetencen as ligjore as njerëzore për një çështje që nuk jam e përfshime. Unë flas vetëm brenda kompetencave të mia.

**z.Remzi Salihu:** Unë nuk po pyes për kompetenca, por ti si drejtoreshë ka qenë dashë të jeshë në dijeni për këto gjëra.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Çështja e pagave është çështje e Drejtorisë së Financave.

**znj.Merrushe Ahmeti, drejtoresha:** Dhe diçka dua të shtoj në këtë çështje. Faktikisht siç treguan edhe këta, përderisa nuk është në kompetencë time nuk mundem me folë për diçka. Aq sa ki informacion ti kam dhe unë, për arsye se nuk është zhvillu drejtpërdrejt përmes drejtorisë. Ashtu e parashf dhe ligji. Nuk parashkohet me u zhvillu kundrejt drejtoratit dhe si e tillë nuk e shofë veten kompetente me të dhënë informacione përderisa nuk i posodeoj për një çështje që është kaq e ndjeshme dhe delikate, dhe ku preket individi në fjalë. Për atë arsye ne të kursehem në këtë çështje dhe ne të japin përgjigje personat kompetent. Në qoftëse në një dokument të tillë figuron emri im, atëhere unë jam e gatshme, jo para teje, mirëpo, ku dush me dhanë llogari. Mirëpo askund nuk figuron. Përderisa nuk figuron një çështje e tillë unë nuk e shof veten kompetente.

**z.Remzi Salihu:** Drejtoreshë, unë nuk të akuzova. Nëse e ke përceptu në atë mënyrë, janë të gjithë dëshmitar si e bëra pyetjen, si u qasa, nuk të akuzova, shumë thjeshtë të pyeta, shumë thjeshtë ke mujtë me u përgjigji. Nuk është në kompetencën time, nuk jam në dijeni dhe ish këput kjo çështje, ama jo me më tregu mua se kush i krijon politikat financiare, me më mbajt ligjerata këtu, se i di unë këto.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Besoj që debati i kry, vazhdojm me rend të ditës:

Për këtë seancë kemi parapa këtë:

## Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e Kuvendit Komunal.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për projekt buxhetin e Komunës së Vitisë 2025-2027.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për planin e punës të Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2025.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e buxhetit të participuar nga fermerët përfitues.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për transferin, rialokimin e mjeteve buxhetore në mes programeve-nënprogrameve buxhetore në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale.
7. Informatë lidhur me raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare të Komunës së Vitisë për vitin e përfunduar me 31.12.2023.
8. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditorit për vitin 2023.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Hapi debat për rend të ditës. Pasi që nuk ka për debat, ne patëm dhe një debat në KPF, bisedova dhe me shefa të grupeve, një propozim vendim për një vizitë prapë në Shqipëri. Nëse jeni të koordinuar grupet, e shpallim në rend të ditës. Nëse vendosim me shku, vendimin me pas të kuvendit. Kryesuesi i Kuvendit të Vitisë i propozon Kuvendit Komunal të Vitisë që të miratojë vendimin për vizitë studimore në Shqipëri, shkëmbim të përvojave dhe thellim të mëtejshëm të bashkëpunimit në nivel lokal. Vizita do të jetë 3 ditore, vizita përfshinë anëtarët e KK-së, ekzekutivin, anëtarët e komiteteve, stafin mbështetës të kuvendit. Nëse jeni të pëlqimit e shpallim në rend të ditës. Fjala është për juve shefat e grupeve të japin mendimin. A jeni që kjo pikë të hy në rend të ditës me pika tjera. Pra, nga të gjithë të pranishmit pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim hynë kjo pikë në rend të ditës. Tani a jeni që të miratohet komplet rendi i ditës. Me të gjithë të pranishmit pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet rendi i ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

### 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e Kuvendit Komunal

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Hapi debat për këtë pikë. Pasi që nuk ka për debat e qesë në votim. Pra, me të gjithë të pranishmit pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

### 2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për projekt buxhetin e Komunës së Vitisë 2025-2027

**znj.Milhatë Ajeti, drejtoreshë:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Përgatitja e buxhetit 2025-2027 ka filluar nga muaji maj i vitit 2024 konform Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë dhe Ligjit të Financave të Pushtetit Lokal. Buxheti i Komunës së Vitisë përbehet nga dy burime kryesore: grandit qeveritar dhe të hyrat vetanake. Kufinjet nëpër kategorit ekonomike janë përcaktuar me qarkoren buxhetore 2025. Grandi i përgjithshëm është 7 milion e 705 mijë e 66 euro, grandit specifik i arsimit është 6 milion e 887 mijë e 645 euro, grandit specifik i shëndetësisë është 1 milion e 927 mijë e 784 euro, grandit për shërbime rezidenciale është 155 mijë dhe të hyrat vetanake janë 1 milion e 270 mijë e 127. Në total janë 17 milion e 945 mijë e 622 euro. Buxheti komunal për vitin fiskal 2025-2027 do të paraqitet sipas 5 kategorive ekonomike për shpenzimet e buxhetuara në pajtim me rregullat e thesarit, paga dhe medijtje 9 milion e 887 mijë e 124 euro, shërbime mallra 3 milion e 172 mijë e 119 euro, shpenzimet komunale 300 mijë, subvencionet dhe transferet 720 mijë, shpenzimet kapitale 3 milion e 826 mijë e 579 euro, ndërsa mallra dhe shërbime kemi një rritje prej 540 mijë euro, zyra e kryetarit është 14 mijë e 500, financat 70 mijë, drejtorja e arsimit 493 mijë, shëndetësia dhe mirqenja sociale 847 mijë e 235 euro, zyra e kuvendit komunal është 17 mijë, shërbimet kulturore janë 60 mijë, drejtorja për buqësi 14 mijë, drejtorja e kadastrit 10 mijë euro, administrata 95 mijë euro, inspeksioni 70

mijë euro, shërbimet sociale janë 65 mijë, urbanizmi 110 mijë, subvencionet 720 mijë dhe shërbimet publike 1 milion e 175 mijë e 684 euro. U mundova në pika të shkurtera për qdo pyetje shtesë jam në dispozicionin tuaj.

**z.Ali Bajrami:** Me Ligjin e Menaxhimit të Financave Publike dhe me Ligjin e Vetqeverisjes Lokale që janë të aplikueshme në Republikën e Kosovës para neve kemi propozim buxhetin për vitin 2025. Është një buxhet jo i mjaftueshëm, duke marrë punët dhe volumit që janë duke u punuar dhe duke u kryer në Komunën e Vitisë. Nëse marrim në mënyrë komulative rritjen e buxhetit 2024-2025 kemi një rritje prej 7.7% ajo që ka qenë që është ndarë ky buxhet janë numri i nxënësve, vizitat mjekësore dhe numri i banorëve. Është një fatë i mirë që me rrigjistrimin që kemi pas këtë vit në bazë të banorëve, numri rezident që ka dalë, që nuk ka ndiku për hartimin dhe planifikimin e buxhetit. Krejt këtë çka e thashë i ceku dhe drejtoresha rritjet në mënyrë nominale të kryetari, të zyrja dhe të gjitha drejtoritë ka rritje. Është mirë që e vërejtja që ka rritje edhe në shëndetësi, se janë dirket ato mjete që investohen prej grandit qeveritar, por edhe të hyrat venake të komunës që hynë në shërbim të qytetarëve të Komunës së Vitisë. Ajo që ke shumë me rëndësi patëm rritje tek të hyrat vetanake janë të hyra që në mënyrë direkte ju kthehen qytetarit për rregullimin e infrastruktures në teritorin e komunës së Vitisë, të investimet kapitale krejt këtu është ajo vlera 3 milion e 800 mijë është një vlerë që edhe në bazë të specifikimit që keni bërë me partnerin e koalicionit janë të përfshirë në mënyrë përgjithshme të gjitha lokalitetet tu e erfshi dhe komunën e Vitisë janë punët të specifikime që kanë me u krye një fatë i mirë është që pjesa dermuse e punëve janë krye më heret me këtë buxhet që kemi besoj që edhe vitin 2025 Viti do ta bëjë një infrastrukturë të kompletuar në shëndetësi, infrastrukturë rrugore ajo që është fokus dhe përqendrim i qeverisjes aktuale është angazhimi në qashtjen e rregullimit të ujësjellsave në nivel të fshatrave të komunës së Vitisë.

**z.Jakup Demiri:** Ndonëse pika më e rëndësishme apo votimi më i rëndësishëm që bëhet në një kuvend komunal është buxheti, por unë i kam disa vërejtje, mendoj që janë me vend dhe të jemi të kujdesshëm çka po bajmë. Ne si grup i asamblistëve i LVV kemi gjetur disa parregullsi në këtë projekt buxhet, dhe tash si u bë, a u bë në mënyrë paushalle vetëm duke u orientuar në buxhete të tjera, unë nuk e kuptoj, po me gjasë që ka shtu ashtu, ngase po nisem prej një liste të investimeve. E kemi listën e investimeve, projektet e njëta prej 2013 të bartura 2015, dhe në parashikime për 2023 të bartura 2025, dhe të parashikimeve edhe 2027 projekte të njëta që bëhen me 5-6 vite, ngase 2022 ka qenë tabela vetëm të ndame dhe nuk kanë qenë të emrume. Nuk e dimë prej këtyre projekteve a kanë qenë edhe në 2022. Në këtë listë që kemi marrë për neve është tepër e pakuptueshme se ku kanë me shku parat. Nëse dikush në të del në ta skjaron, në të fol se në çka kemi me fol, kemi me fol për investimet kapitale, se të tjerët janë të rregullime, dhe ashtu që nuk është në dorën tonë. P.sh.: i kemi diku 26 projekte që na përseriten nga 2023, që janë dhe në projeksione edhe të vitet 2026-2027, sepse projekti me të njëjtën figurë diku një asfaltim i rruges rurale-lagjore të zgjatë me ka 5-6 vite, në të na japin skjarim. Disa prej rrugëve unë e di që janë krye, po këtu figuron investime që prapë kanë me u bërë, edhe këtu të kemi një skjarim. Prej disa gjërave që ka me u pyetje janë që i bëri dhe aliu. Shembull keni mbi 26 projekte që keni pas në projeksione të kaluara dhe prapë i keni në këtë të njëjtën tabelë si vitin e kaluar si në këtë. Rruga Viti-Sllatinë e Epërme figuron në buxhetin 2025 dhe në projeksione kur ka qenë 2023. Rruga "Lagjia Llulleci" Ramjan, figuron njëjten sen. Rruga Remnik i Ri, Sodovinë e Qerkezve, Sllatinë e Poshtme figuron në tabelë. Përgjigjen e dimë, sepse ky kuvend ka gabu kur e ka votu atëherë, se nuk ka pas parë të mjaftueshme për ata, por vetëm janë nis projektet dhe kemi ngritë si shqetësim edhe atëherë. Tash kam dhe një pyetje: si ka mundësi një projekt në vlerë 230 mijë euro të jetë në planin buxhetor 3 vite e më shumë. Dhe një pyetje. Kryetar, është një kompani: a ka kontratë komuna dhe si është kjo kontratë me një kompani slovene për 3 milion e 100 mijë euro? Kjo kontratë përfundon 2025, e kani kontratë me ndonjë kompani këtu. Unë e kam kompani slovene që thotë dhe kontrata përfundon 2025. Kisha pas qef me pas dhe shpjegime të kompania projektuse. Florent Emini vitin e kaluar përmes përmbaruesit ju ka marrë 145 mijë euro. Ai njeri i shtëpisë suaj është. Njeri i shtëpisë së juve me ju qitë në gjyq është kjo telashe. I ka marrë sepse keni bërë planifikimin gabim, se nuk ka planifikim definitivisht Komuna e Vitisë nuk ka planifikim. Këtë ju u argumentoj dhe me një dokument tjetër. Tani kemi dhe një marrëveshje fondi kosoovar për energji, keni bërë izolimin e jashtëm të 3 shkollave me koston që do ta paguaj komuna deri në vitin 2037. Nuk e di komuna me bërë një marrëveshje dhe me pas në obligime të kamatave për 13 apo 15 vite, nuk e di dhe a keni të drejtë. Vetëm shkolla e Tërpezës ka kushtu mbi 80 mijë euro dhe është vlera e sakt apo nuk është, vetëm këtë shumë do ta paguaj komuna deri në vitin 2037 dhe kjo është në projektion. A është ashtu apo nuk është? Ky buxhet, po bëjë thirrje publikisht, të kthehet të harmonizohet shtesë lista e investimeve, se as vetë ju nuk e dini, nuk mundeni me mi arsye këto projekte si i keni qysh i keni, ku janë punët jam shumë i bindur. Ky buxhet ose të kthehet të korigjohet, përndryshe edhe korigjimet t'i bëjnë njohësit e fushës së caktuar, pa ndërhyrje prej njerëzve që janë me ndikim politik dhe të drejtojmë, se ne rrezikojmë me këto kontrata. Nëse janë të vërteta, ne besoj që vitin tjetër kemi me hy në obligime deficitare me ka 5-6 milion euro. Unë edhe në KPF kam shpalos një dokument kur është votu KAB-i, Komuna e Vitisë do të thotë ka dorëzuar një listë pa asnjë projekt. Këtu është pasqyra kur

e dimë ne sa projekte kemi, cilat janë kry, cilat si kemi kry, sa përqind janë kthyer, sa na kanë mbetur, sa na vënë pare shtesë. Unë nuk di çka me bë tash, nuk mujë me votu diçka që nuk e di. Shkurt e thjeshtë, përgjigje për këto, mandej e diskutojmë. Neve na ka ardh një listë e njëjtë, lista është vazhdimisht me të njëjtat projekte.

**z.Taulant Haxhiu:** Unë po shofë që kemi buxhetin 17 milion e 945 mijë e 622, një rritje prej 1 milion e 292 mijë krahasim me vitin e kaluar. Pak a shumë po hy në detaje dhe gjëra esenciale që i interesojnë më së shumti qytetarëve të Komunës së Vitisë. Unë disa here kam diskutu për ujin. Ne e dimë që qeverisja komunale shumë pak ka bërë për shtimin e kapacitetit të ujit, të cilin qytetari e ka bazike, themelore. Intresi më i madh është që investohet në shtimin e kapacitetit të ujit. Si ka mundësi me i nda 217 mijë euro në investim në ujë, kurse 500 mijë euro për zhavorr, për kanalizimin vetëm 135 mijë euro. Janë parapa 13 projekte për asfalt. Nuk jemi kundër asfaltit, po jemi për ujë. Nuk mundemi me jetu pa ujë askush. Unë propozoj që së paku ti kemi 1 milion euro investime në rritje të kapacitetit të ujit. 2 milion euro për asfaltin 2025. Projekti plani i buxhetit totalisht nuk po më duket shumë me analizë. Më shumë po më duket elektoral shtrimi i asfaltimit në hapësirë të panevojshme në vende ku qytetarët lëvizin 20 apo 30 qytetarë në muaj. Nuk më duket e nevojshme kemi shumë vende tjera që na kanë mbetur të zbrazta ti plotësojmë ato nevoja, pastaj të shtrojmë asfalt, jo të jemi vetëm qeverisje e asfaltit, renovimi i ambullantës në Viti. Ato janë renovu para disa viteve, prapë po hynë në buxhet renovimi i ambullantës në Viti. Buxheti po më duket si ad hok. Paska rivitalizim të rrugëve me asfalt që i ke shtrur 2-3 here dhe prap po përsëriten. Në vitin e kaluar kanë qenë në buxhet për rivitalizim, krejt kjo si shkak i punëve të keqmenaxhuar. D.m.th ata operatorë të cilët ja kemi dhanë punën e punu ata nuk i kanë kry mirë. Ne po duhet 2-3 here qëto punë të njëjta po duhet me i bë. Ne kemi nevojë dhe për sport. Është qyteti i Vitisë i cili sportin e ka shumë keq. Kryetari i komunës e ka mandatin e tretë dhe ky ka qenë sportist. Unë për herë të parë kur e njoh kryetarin e kam njohur si sportist. Ne nuk kemi stadium të qytetit kryetar, unë e di që ajo është shumë e rëndësishme, nuk kemi ne adresë më të madhe se sa të adresohemi ty. Qyteti i Vitisë nuk ka ndonjë klub të fortë. Kemi "Vllaznien", e cila ka qenë klub më stabil në Komunën e Vitisë, ne asgjë nuk kemi bërë për ta. Tash kanë dalë në ligë të tretë. Më mirë të investojmë në disa gjëra bazike se sa në asfalt. Unë jam kundër asfaltit, jam për shtimin e kapacitetit të ujit dhe ta rrisim sportin. Nuk kemi klub në super ligë. Krejt qytetet kanë. Kemi sportdashës të jashtëzakonshëm që kanë dhanë shumë për sportin. Në qeverisjen e tashme do mu shu sporti tu e mbajt me zor. Kërkoj prej këtij buxheti të rriten investimet në shtimin e kapacitetit të ujit.

**znj.Majlinda Shabani:** Për mua nuk është hera e parë që plani i buxhetit vë në mënyrë kaq skandaloze, ku keni me pa që përpos kësaj, lista më e rëndësishme e cila natyrisht është ajo e investimeve kapitale. Mungojnë informacionet më konkrete që duhet me i pas. Ne sot kemi me vendos a me legjitimu apo jo këtë plan të buxhetit, e parimisht i bie që kemi me votu për diçka për të cilën nuk kemi informacione të qarta, mirëpo për me ju përmbajt pikës për të cilat jami tu folë diskutimin po e vazhdoj me disa citime ku janë në faqen 7 të planit të buxhetit, ku thuhet kështu si objekt i qeverisjes komunale në bazë të plan buxhetit të vitit 2025-2027, cekën disa objektiva ku thuhet përpilimi i një buxheti të qëndrueshëm komunal. Pyetja ime e parë për ty kryetar është se, çka nënkupton me buxhet të qëndrueshëm komunal? Sepse realisht për mu nuk është i qëndrueshëm komunal, është skandaloz dhe qesharak. Objektivi tjetër po e citoj prapë, synimi i një planifikimi sa më real i shpenzimeve dhe i të hyrave buxhetore. Ku është ai planifikim kryetar? Në zyren tënde apo në zyren tënde i bënë planifikimet e investimeve kapitale. Një kohë nuk i bënë publike hiç, mandej qytetarët nuk kanë as informacione të qarta se ku janë ato investime konkrete. Ne e dimë që buxheti i Komunës së Vitisë është buxheti i qytetarëve, nuk është buxheti i joti, andaj këtu duhet me pas shumë konsideratë ku po flasim për investimet kapitale. Objektivi tjetër thuhet transparencë gjatë hartimit në buxhet. Ku është ajo transparencë? Sepse e kam parë buxhetin, dhe ajo çka muj me kuptu prej buxhetit është që, ju mundoheni fakt me i çek centat e me i mshf milionat. Milionat në investimet kapitale që bëhen tashë sa kohë në Komunën e Vitisë dhe kurr nuk kemi informacione të qarta se ku realisht shkojnë ato. Edhe objektivi tjetër është zgjedhja e prioriteteve të projekteve kapitale për vitin buxhetor 2025 dhe vlerësimet e hershme për 2 vitet e ardhshme. Këtu natyrisht që kemi shumë me diskutu, se pyetja ime parë është: në shërbim të kujtë është ky buxhet? E unë e di përgjigjen e kryetarit, që thotë që është në shërbim të qytetarëve të Komunës së Vitisë. Andaj pyetja ime është se, cilat janë ato projekte që i ka përfshi, që prekin direkt mirëqenien e qytetarëve? E dimë që në mbledhjen e fundit që kemi pas në KPF, ku planin e buxhetit pikërisht tek lista e investimeve kapitale nënkryetar, e din që neve lista na ka ardhë aty për aty, diskutimi ynë ka zgjatë diku 1.5 orë, për shkak që ne nuk kemi pas kohë të mjaftueshme se çka realisht përfshinë ajo listë e investimeve kapitale. Qartazi unë po besoj që ne këtu mundemi me pa aspektin e transparencës, llogaridhënies. Shpenzimet e paras publike. Përpos kësaj e shohim dhe aspektin profesional që ju e keni dhe posedoni. Mandej planifikimin adekuat që do të duhej ta paraqiste para nesh, para qytetarëve. Po e ripotencoj që, konkretizimi i projekteve, sepse qytetarët e Komunës së Vitisë as edhe një herë nuk kanë marrë informacione, nuk kanë kuptu se realisht a janë përfshi apo nuk janë përfshi kërkesat e tyre. Unë e di kryetar që, për ty këto veprime nuk janë krejt të

rastesishme dhe nuk është që i bënë të pavetdijshëm dhe po besoj që gjithsecili prej neve jemi mësu me praktikën e qeverisjes tande, mirëpo në listën e investimeve kapitale që e keni sjellë në kuvendin komunal, dhe që sot kemi me votu, kryetar, ti asfaltin e shtrum njëhere po donë me pru në kuvend dhe me faturu për së dyti herë, edhe para neshë me paraqit si investim kapital. I ke prapë të njejtat emërtime që i ke pas prej fillimit të mandait, kur unë jam asamblist. Ki të përfshime asfaltime në 7-8 lokalitete, asfaltime të cilat kanë përfundu tash e sa kohë dhe ajo që ti po donë që qato investime kapitale me i faturu për së dyti here e mos të flasim për prioritete. Edhe çështjen e ujit të pijshëm, sepse tash e më shumë se një dekadë qytetarët e Komunës së Vitisë i ke lanë pa ujë të pijshëm kryetar, ama u e dinë pse i ke lanë, për shkak që ne e dimë që në rast me shtrimin e asfaltit, në rast kur të hapen tenderat, e dimë që fitimi më i madhë është pikërisht te asfalti, dhe kjo i shërben më shumë aspektit tjetër dhe jo qytetarëve. Ndërsa me ngritjen e kapacitetit të ujit të pijshëm do të ishte e kundërta. D.m.th ngritja e kapacitetit të ujit pjesë natyrisht që nuk do të kishte fitim shumë të madh për komunarët, mirëpo për qytetarët e Komunës së Vitisë do të ishte thelbësore dhe mëse e nevojshme që ky problem të zgjidhet, dhe është shumë e dhimbshme që tash e një dekadë qeverisje, ne nuk e shohim prioritet në listen e investimeve kapitale që ju e keni pru, dhe unë po besoj që prej komplet mandateve tua që i ke pas si kryetar, ka me qenë njëra prej dështimeve dhe mashtrimeve më të mëdhaja që ja ke bërë qytetarëve të Komunës së Vitisë. Përpos kësaj, unë pajtohem dhe me çështjen që i ngriti kolegu asamblist, shefi i grupit, përsa i përket sektorëve tjerë, sepse unë po besoj që qytetit të Komunës së Vitisë ja ke bërë damin më të madhë, të pariparushëm në aspektin e zhvillimit të mirëfillt ekonomik, dhe natyrisht unë i bëjë thirrje të gjithëve asamblastëve të KK-së, që të jemi shumë real, ta dimë se çfarë po votojmë dhe realisht që unë një buxhet të tillë ta kam thanë dhe më heret po ta them prapë, që nuk e votoj as edhe një here.

**z.Sokol Haliti, kryetari i komunës:** Kur ngriten çështje të tilla jo adekuate, kur të ngriten akuza kështu si nga një këshilltar e cila punon në nivel qendror, dhe 2/3 e buxhetit janë atje dhe atje jepen tendera një burimor dhe në Viti ende nuk ka tendera një burimor dhe sulmi është mborjtja më e mirë. Unë kam ardhë bashkë me bashkëpunëtorë profesional këtu, bashkëpunëtorë pa dallime partiake, bashkëpunëtorë profesional, dhe Berati ke këtu dhe të tjerët, Drejtoria e Financave, që është njëra prej drejtorive më të mira e organizime ndoshta në nivel vendi, mos e harroni këtë punë. Ka pas drejtori të mira, dhe Drejtoria e Bujqësisë janë drejtori të jashtëzakonshme, që kanë vërtet kurriz institucional profesional, që është keq me i fy me këtë fjalor. P.sh.: sektorët dhe nënsektorët profesional nuk janë politik, meqenëse edhe unë kam punu në sektor profesional dhe unë jam menaxher i vjetër dhe e di si konceptohet buxheti jashtëzakonisht mirë, dhe unë e di që je në këtë përmbamje, por dikush ka qenë shumë më herët në përmbamje dhe kur janë themelur institucionet pas luftës edhe këshilltar dhe drejtor përgjegjës dhe sektorë edhe departamente në ministri dhe aspektin profesional të konceptimit të buxhetit, me gjithë zërat buxhetor dhe strukturën buxhetore. Ne edhe pse kemi qenë jashtë procesit ekonomik e kemi ditë fortë mirë kështu që, buxheti kur të konceptohet konceptohet brenda suazave të mundshme dhe të lejume të kufijve buxhetor që t'i lejon edhe grandit qeveritar, por edhe ti lejojnë obligimet, detyrimet që i ke të vitet që pasojnë. Disa here u ngritë një çështje e projekteve që barten. Këtu ka ekonomisa dhe nga partia jote që e dinë që projektet të cilat nuk janë pranë teknikisht dhe kanë buxhet dhe në 2025 duhesh me i kodu. Është obligim ligjor dhe për atë barten, përndryshe mu nuk më konvenon. Ajo e kundërta unë kisha dashtë në vend të tyre që janë që pi përmend 10 - 7 apo 6 me i futë projekte tjera. D.m.th është imponim legal, legjitim financiar i cili duhet me i konceptu. Te çështje e juve unë mendova që shefat e grupeve parlamentare për shkak se e keni shterrë në KPF, që është organi më i lartë që ja jep orientimin gjeostrategjik financiar dhe politik kuvendit është organi i themelur, ku përfaqsoheni të gjithë që e kryeson kryesuesi, ku nënkryetari dhe drejtorat marrin pjesë vazhdimisht, ju ushqejnë me propozim vendime për kuvend. Vazhdimisht ky kuvend ka pas gjithmonë propozim vendime në interes të qytetarëve edhe me KAB që ju e keni para vetit se është 3 vjeçar, se ke obligim dhe KAB në momentin që ke obligim KAB-in. D.m.th je tu bisedu për 2025, 2026, 2027 duhet me pas parasysh 2027 nëse jemi ne. Kjo përmbamje ose ndonjë tjetër kemi me folë për projekte që janë në KAB, d.m.th se 3-vjeçar sot e bajm planifikimin. D.m.th, me një mas të madhe je i orientuar edhe veteve të ardhshme me shku në ato korniza. Tash aspekti tjetër i ripërseritjes, përsëritjes, mandati, strategjia katër-vjeçare, vitet nuk vesin për kalendar. Gruri ju kam tregu mbjellët në vjeshtë e korret në korrik. Buxheti planifikohet në shtator, fillon me u implement në vitin e ardhshëm. Unë ty veç të kisha thanë se tjetër sen është planifikim, tjetër sen janë procedurat. Mandje janë implementimet, fjalori yt është akuzë dhe tendecë politike e kuart. Unë këtu do të jemë bashk me Jeta Xharren në debat pa problem folim lirish dhe shohim bisedojmë më detajisht, më ndryshe se aty jam i lirë me fol pak më shumë. Këtu po e ruaj kodeksin për shkak se ju heren e kalume më thatë se kryetari. Ama, arrogancën dhe sjellejen jeni tu e bë ju dhe unë se, tash nuk është ferë në këtë formë kur ti ke pasqyrat e realizimit edhe një here po ta spjegoj një here bëhet planifikimi mandej jan procedurat më vonë është implementimi dhe mbikqyrja dhe pasqyrat e realizimit vinë më vonë, pasqyrat e realizimit vazhdimisht i keni pas me afat dhe atje pasqyrat e realizimit të kallzojnë ku shkojnë parat tu e përfshi dhe këtë propozimin për kuvend që po e bëni për me shku në

pushim. Shkoni në vizitë studimore bëni vendim dhe pasqyrat e realizmit tregojnë sa pare i ke hargju, pasqyrat e realizmit tregojnë kryetari sa pare i ka hargju në vizitë Strong city Network, New York, pasqyrat e realizmit tregojnë sa pare është dashtë me i dhanë për Sllatinë dhe sa kanë mbetë tash është tjetër sen obligimi që duhet me bartë se është obligim shtetor. Obligimet e nënshkrimit të marrveshjes kontraktuale janë marrëveshje që nënshkruhen për interes të komunës, shkollat normalisht që gjejnë fonde me izolu, eficiency në energji është formë e pandalshme në Viti sikur që është qyteti intelegjent që ka me vazhdu sikur që kanë me qenë edhe projektet të tjera ambientale, sikur që kanë me qenë infrastrukturale, strukturën buxhetore nëse e shikoni nuk është asfalt. Shikoni sa kategori i keni të përfshime, duke dashtë me ju përgjigj me respekt Taulantit te uji. Unë themë kështu se, edhe bashkëpunëtorët e mi mund të më ndihmojnë për shkak se ne punojmë punë ekipore jo në zyre por në sallë këshilltare. Tash e ki kodin 17, ndërtimi i ujësjellësve të 2 fshtrave Ramjan, Novosellë që është në vazhdimsi e ke kodin 18, ndërtimi i ujësjellësve Devajë - Radivoje janë 4 fshatra. E ke lagjen më herët që është quajt zonë ekonomike, rrugës për Kllokot që ujësjellësin jemi vetëm tu e implementu. Vetëm dua me argumentu për ata që dojnë me bisedu konstruktivisht gjithmonë dera është e hapur, edhe në sallë, për shkak se në sallë punojmë dhe jo vetëm dhe me njerëz profesional. Ne nuk i kemi ata profesional që 23% të buxhetit, veç Ministria e Financave e ka hargju, po i kemi me këta që 98.7 kanë ditë me implementu dhe me hargju. D.m.th ne po i nënqmojmë njerëzit e tonë, funksionalizmi i ujësjellësit në Zhiti, në Sllatinë, e ke kodin 38, Sllatina, Tresteniku, Sodovinë e Jerlive, Qerkezëve, Debellë. Ne ta dinë krejt qytetarët që, kryetari i komunës sakt është argumentues për këtë që e flotë dhe bashkë me bashkëpunëtorët, se këtu jemi një qeveri e tanë, një kuvend i tanë, nuk mendojnë krejt njësoj. Unë e kam parasysh që unë jam tu folë me dikënd që as buxhetin nuk e voton asnjëherë dhe një mori akuzash, kurse kërkon projekte në vendbanimin e vetë ka ja kan dhanë voton dhe kam parasysh që përfaqëson dhe i merrë 2 rroga, përfaqëson një qeveri e cila asnjë cent nuk e investon, por e keni një sen parasysh, du vetëm vendimin temë 5 milion e 500 mijë euro na e ka marrë kontrata kolektive, e cila Komuna e Vitisë fare faj s'ka, nëse doni në menyrr njerëzore argumentuse me pa verifikone këtë çështje. Unë a e kam thanë asnjëherë nuk e kam thanë, sot po e themë se po më detyrojnë. Unë nuk jam nënshkruar i kontrates kolektive, për këtë zyra juridike është këtu, ajo e vlerëson a kam unë të drejtë me planifiku një kontrat të cilën nuk e kam nënshkru Komuna e Vitisë nuk është nënshkruse e kontratës kolektive, është qeveria qendrore, ata e rimburojnë o e abrogojnë. Ky është edhe qëndrimi i asosacionit të komunave. Shumë komuna janë tu i bankretu. Neni 43 e ke përpara për rivitalizimin e ujësjellësve në Remnik, Beguncë, Budrikë, Skifteraj, Verban, Smirë, Tërpezë, Goshicë. Më ndërhyri këshilltarja se kesh tu tregu se cilat janë pasojat 3.5 milion investime kapitale, 5.5 milion ti ka marrë dhe grandin e performancës ta ka humb, d.m.th që i ke atje 10 milion i ke të ndame nga kjo qeveri. Tash e ke ndërtimin e fabrikës së ujit të pijes dhe kolektorin e ujrave të zeza. Kjo është tepër me rëndësi me diskutu në kuvend për të ardhmen e komunës sonë. Sa i përket ujit të pijshëm dhe trajtimin ejrave të zeza, ne i kemi bërë shpronësimin e rritjes së kapacitetit të ujit në Letnicë, kemi bërë dhe pagesën dhe projektin e Florës i Bankës Botërore, investon 3.5 milion dhe në janar hapet tenderi për rritje të kapacitetit të ujit, d.m.th nuk është fjala për 1 milion, por është fjala për shumë miliona që në ujë ne i kemi përgatit me i investu. Unë e kam mandatin brenda mandatit tim funksionoj dhe pse kam pas qefë në vitin e parë ta përfundoj. Ky fond shkon edhe hapet tenderi përmes "Hidromoraves", kompanisë e cila është e themelume me Ligj për Sigurimin e Ujit të Pijes dhe Kualitetin e tij. Parlamenti i Kosovës e ka themelu dhe nëse duhet me bërë ndonjë ndryshim tjetër e bënë parlamenti dhe shumica në parlamantet kemi deputet, kemi qeverinë. Unë nuk muj e ndryshoj atë pikë. Unë e kam bërë atë me bashkëpunëtorët e mi që kanë punu, nënkryetari, drejtori i shërbimeve publike, sekretorët e tjerë, zhvillimi ekonomik. Kemi punu gjithë qeveria bashkarisht dhe kryesuesi ka marrë pjesë në këto debate, dhe në Gilan dhe me bordin jo vetem me pjesën ekzekutive të "Hidromoravës" edhe me projektin Floës me Bankën Botërore dhe ne do të kemi miliona investime në rritjen e kapacitetit të ujit. Në Stubell jan duke u bërë kyqjet është i pregaditur krejt uji për Stubell, nëpër Goshic jan të pregaditura të gjitha kyqjan kan me u bërë jan vendimet, vetem kthehuni ju këqymni këto vite sa vednime kemi marrë ne për 5 fshatra sa vendime kemi marrë për Germov për Goshic cilin vendim e kemi marrë financiar për Stubell e kemi kyq letnicen ne faktikisht nuk kemi përgjegjisi për ujin që është shti 2008 dhe rritet atje psh po kemi përgjegjisi për funksionalizmin e tijë pasi është prish pëmdryshe fondi ka qenë para meje vendimet dhe kontratat kan qenë para se me ardh Sokol Haliti kryetar merrni këqymni dokumentacionet jan krejt. Për pyetjet përgjigjet i ke krejt në kode, për Viti ti tregoj lagjet unë e kam ndrru gypin e azbezit 13km mandej rrugen që e kam bërë 2 kahshe natan rekes e kemi futë ujësjellësin për ato lagje tash jemi tu shku këkufi administrativ me kllokotin ujin, ka tregu e kemi shti prej qardakut deri te tregu i gjelbert jemi tu punu lagje lagje ndryshe nuk kemi mundeis me punu as nuk ke fonde as nuk mundes me punu infrastrukturalisht dmth ne jemi tu punu në qytet të rritjes së kapacitetit të ujit dhe në periferi e kemi shti lagjen e Godenvë, lagjen lidhja e Prizerenit ne vazhdimisht kemi punu, tash a ka ujë të bollshem me futjen e Drobeshit, Germoves, Goshices, Smiren, Verbanit nuk ka prandaj ka lindë nevoja për rritjen e kapacitetit të ujit projekti ka

arune per tatë të mirë tenderi hapet e kemi bë shpronsimet është bë vendimi në kuvend vetem shikoni kronologjikisht. Kjo qështje është sa me bë fjal se ju e dini që kjo qështje është shumë me rendesi dhe jemi marrë shumë me këtë punë, unë jam marrë Jakup me këtë qështje dhe jam tu e zgjidh se ti nuk je marrë hiq dhe nuk e ke ditë qka është ajo punë, unë i kam zhvillu kontaktet me banken botrore unë i kam zhvillu me floëin unë e kam nxejrr donacionin aj eprsoni nuk është aty se është në Kroaci jan marrë njerzit e Letnices atje dhe flamurtaret na kan ndimu atje të gjithë për me bë. Unë deshta me dalë te ajo që është kruciale sa i përket zgjidhjes së problemit për qështjen e ujit dhe trajtimit e ujrave të zeza, ky kuvend e ka miratu një projekt t'ëcilen eunë e kam propozu me austriakt kur kemi punu kur eka financu projektimin vendimin e kemi marrë ne kuvend kur e ka nënshkru kryeministrat dhe ministrat 2 kryeministra radhas pa dallim partie dhe 2 ministra të financave dh ei icli është miratu që ka pasë vleren 12 milion e 900 mi euro që ka pas për qëllim ka pasë për obligim me ndertu fabriken e ujit të pishem në gryk të moraves dhe trajtimin e ujrave të zeza në fund të Budrikes kufirin me Nasal aj projekt është rikthy në bashkimin european këtu e kam hapë kodin e keni është pika 46 i cili normalisht ka kosto më të madhe se 13 milion tash përshkak të ngritjes pas pandesmis diku ka vlerë 20 milion po ku perfshihen dhe rruges bujqsores dhe lidhen me zonen ekonomike trajtimin e ujrave të zeza, kolektorët kufi me Nasalen dhe fabrika e ujit të pijes kjo është kodi është hapë me bashkipimin european jemi në negociata vetem dua për këtë të ju informoj është projekt serioz i cili ne mundemi me debatu me folë pse jo në negociata me qenë bashkë dhe kur të zhvillojm takimet pr kuvendendi ka me qenë të njoftum mbi ecorit e këtij projekti.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi i kuvendit:** Kryetar, ne 46 e kemi, ne qyteti i menqur.

**zaj.Milihate Ajeti, drejtoresha:** E njëjta listë është veç ndryshimi i vlerave nga projektet që zbatohen, participimi i projekteve me donatorë është 30 mijë, zbritet ndriçimi i trotuareve dhe ndriçimi publik në Pozheran, Fshati i Ri, Trestenik, Devajë etj, 30 mijë euro, ndërtimi i parkut në Viti 10 mijë euro. Të gjitha këto barten te riparimi i shkollave në Viti, Radivoje, Pozheran, Ramjan në vlerë prej 70 mijë euro. Mjetet që barten, renovimi i ambullantave në vlerë prej 10 mijë euro të barten në projektin e fabrikes së ujit të pijes dhe kolektorin e ujrave të zeza, d.m.th këto dyja nuk i keni, atëhere kur kemi pas, por tash ja kam dhanë Fatlumit për me shpernda, por nuk e di a e ka shpërndarë listen.

**z.Jakup Demiri:** Mbi 5 milion euro tha na ka marrë përmbaruesi për kontraten kolektive. Në rregull është, edhe unë nuk kisha dsikutu se nuk ju fajsos juve, por sa pare ja u ka marrë përmbaruesi për kompanitë që kanë punu në Viti me përmbarues kjo është punë e juve.

**z.Sokol Haliti, kryetari i komunës:** Bëje kërkesen dhe na ta dërgojmë listen e përmbaruesve për cilën qështje secilen.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi i kuvendit:** Për listen që kem tu diskutu, qajo listë që votohet qajo nënshkruhet, qajo shkon, unë nuk nënshkruaj listë çka nuk e votojmë. Është obligim ligjor ajo çka diskutuohet, çka votohet kemi pas atë. Tash erdh edhe një kod.

**z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës:** Pasi që kam qenë më në rrjedh lidhur me shpronësimin e parceles në Letnicë, mu ka dashtë një pritje bukur e madhe. Ka pas këshilltar që ka thanë me ma pas dhanë edhe unë e kisha gjetë. Nuk kemi mujtë me gjetë, se kanë kërku standardet europiane kanë kërku shumë më lehtë dhe më e përfillshme është sikur ta kishim gjetë personin dhe të kishim arritë marrëveshje.

**z.Jakup Demiri:** Nënkryetar, tjetër sen është me thanë mem pas thanë ja u kisha gjetë dhe tjetër sen është me thanë veç, ama emrin se ta gjajë kështu të ka thanë këshilltari para 1 viti e gjysmë ose 2, unë kam qenë prezent. Ai ka thanë veç lenma mu, unë ta gjejë për 24 orë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës:** A më mirë sipas mendimit tan mund me gjetë cilido prej këshilltarëve a e gjenë personi që u kanë adekuat prift në Letnicë, e që ka shku në vendin atje e që ka huluntu 1 vitë. Prandaj nuk është sabotazh, dhe kur e ka kthy përgjigjen ka thanë se, parcela në ljalë e të cilës është pronari ka vdekë, nuk mund me i gjetë ata trashigimtarët se i ka 5 apo 6. Mjerisht është shumë keq që është shef i grupit, që nuk e din çka është sabotazha dhe me pyet. Nuk e din dhe nuk mesohet kurr, prandaj dhe ka qefë me ofendu. Gjendja momentalisht është që e kemi shpronsu 10 mijë euro ja kemi qitë 6 mijë e diçka kemi me ja qitë tash me 2 tetor dhe ka me bë bartjen pronë e komunës dhe ka me qu në hindromorava e la për obligim me qu programin se janë duke e bë dhe projektin ata.

**z.Jakup Demiri:** Nëse unë nuk kam bë kurgja, të pakten nuk e kam pengu 2 vjet shpronësimin, Ramadan Deliu, Bekimi ka qenë prezent dhe shumë të tjerë kur të lutke, >> o veç ama mue për 24 orë ta gjejë njerin << Unë kam qenë prezent, unë këtë jam tu e thanë, tash kryetari tha që është shpronsu në mbledhjen e fundit. Ti the hala, nuk janë kry dhe i thash kryetarit kadal se ne kemi një informatë tjetër që nuk keve këtu. Mirë që është shpronësu nuk kam çka me kërku falje ju nuk keni komunikue mes veti hiq ky. Një informatë tjetër na ka dhanë në KPF. Tash unë nuk e di, po mirë që koka bë koka kry. Ni njeri që e ka votu e ka një pozicion aty, unë nuk e di që është hajgaregji ai.

**z.Sokol Haliti, kryetari i komunës:** Për hirë të opinionit, këshilltarëve dhe qeverisë dhe ata që janë konstruktiv, ata që dojnë interesin qytetarë dhe interesin e progresit të Vitisë dhe zgjidhjes së problemit jetik të ujit të pijes. Ne a jemi tu fol për projektin që kemi nxjerrë dhe duhet me u komplimentu ata që e kanë nxjerrë. Vendimin për fondin mundeni me marrë dhe e shifni tenderin që hapet. Nuk e hapim ne, e hap Banka Botërore bashkë me "Hidromoravën". Përkujdesi shkon te kompania e themelume me ligj, jo komuna. Ne ja kemi bërë punën nuk po ja atriboj punën vetit as nënkryetari veti e përbashkët është, të gjithë jemi tu e bë, jemi tu e qu përpara, prandaj kjo puna tjetër nuk kërkova vendim, se kuvendi ka vendim për të. Drejtoresha nuk ka qenë në atë kohë, unë shumë mirë e sqarova vendimin si ka rrjedhë, d.m.th është bërë projekti, na kanë financu, atëhere kemi bërë fesibilitetin, e kemi bërë vlerësimin, projektin ideor, projektin detaj, mandej është marrë vendimi, është qitë në kuvend, debati është mbajtur dhe i ka shku qeverisë, gjegjësisht sipas ligjit kryeministrit, ministrit të financave, janë nënshkru, i kam krejt dokumentet dhe vendimet e kuvendit që është në arkiv, që kemi patjetër dhe kam dënimet e kryeministrit dhe ministrit të financave. Nuk është me rëndësi cili është dhe si quhet kryeministrit, ministrit, kryetarët, këshilltarët, përmbajtjet janë krejt institucionale, e mbrojnë interesin e qytetarëve dhe kuvendi, parlamenti i tanishmën me këtë përmbajtje e ka ndal, nuk e ka financu. Këtë tjalë të fundit nuk dashta me thanë në fillim, por d.m.th na e ka ndal. Dhe ju çka keni ndikim atje dhe që punoni atje dhe keni përfaqësues, shkoni thunju lëshonja Vitisë projektin si ja ke lëshu komunave tjera, i cili e ka pas atëhere vlerën 13 milion, i cili përmban projektin e fabrikës së ujit 100 litra në sekond dhe trajtimin e ujrave të zeza me kolektor. Unë e thashë këtë tjalë për shkak se dëgjova deputeten një ditë që u murrë me këtë temë, prandaj ju që keni qenë në përmbajtje të kuvendit, ju e dini se si ka rrjedhë kjo.

**z.Nexhat Halili:** Pyetje për kryetarin dhe drejtorin e financave. Ndërtimi i palestrave sportive "Kuvendi i Lezhës", Viti dhe shkolla fillore Sllatinë e Epërme: sa është vlera e kontratave të nënshkruara për këto 2 projekte dhe sa është vlera e planifikume prej 2024 deri 2027? A janë të planifikume mjetet të nevojshme për këto 2 projekte? Pyetja tjetër është për trotuarin në fshatin Trestenik – Sllatinë. Ka mbetur në fazën fillestare, kontrata ka përfunduar, është lidhë kontrata e re. A përfshihet në kontratën e re trotuari Trestenik – Viti, për shkak se unë këtu e kam parë kontratën, nuk është i përfshimë, është i përfshimë pjesa tjetër që ndërlihet me këtë trotuar dhe është e përfshirë diferenca mes asfaltit dhe trotuarit. Pyetja tjetër është ndërtimi i stadiumit në fshatin Skifteraj. Cili stadium apo fushë sportive? Stadiumi i Pozheranit dihet që është. Te blerja e veturave. Për kënd parashihen këto vlera të veturave? Neve na erdhë diku një projekcion në vlerë prej 70 mijë euro, tash paska zbritë në 50 mijë euro.

**z.Sokol Haliti, kryetari i komunës:** Ti je ekonomist, me të drejtë, por me sa e di unë punon dhe ti në prokurim. Ke më heret zyrtari i prokurimit, ti mujte me ja bërë pyetjen ose dërgo letër dhe ta japë listen e seciles kosto, secilit projekt. Ju njohësit e lëmisë i gjeni zgjidhjet lehtë. Ti për 1 minut hinë dhe e gjenë koston e projektit, dhe e gjenë, sepse gjithçka është transparente. Normalisht që palestrat shkollore sportive. Ne kemi bisedu edhe tash me partnerin e kualiconit, për shkak se ti je njohës i lamisë, e dinë që buxheti nuk mjafton, por ne nuk kemi dashtë me hupë hapin, por kemi dashtë me i bërë projekte 2 dhe 3-vjeçare për me i ndërtu. Tash e ke planifikimin e ri. Tash i kemi futë dhe palestrat tjera shkollore në Sllatinë dhe te "Kuvendi i Lezhës", te "Bafti Haxhiu". Te trotuari Trestenik - Viti nuk është futë këtu për shkak se buxheti i ri ka dalë, është procedu, jan kry procedurat, argumentet e mia jan faktike, se ti dokumentoj për 1 minut tani. Projekti, faza e parë e trotuarit Sllatinë e Epërme, te qostë, Trestenik, te kioska është kanë e vitit 2023-2024. Thirrë mbikëqyrësin Shabiu, thuj merre projektin e trotuarit. I riu që ka dalë edhe bjere paramasen, parallogariën, e ke pjesën e dytë të procedume, ka kalu, është nënshkru kontrata dhe fillon. Buxhetin kryetari Haliti e shperndan në 40 vendbanime, nuk e qes fasulen me një vend, se bëhet kaqub dhe nuk ka fryt. Kjo është e procedume, mos manipulo me opinionin. Trotuari është procedu, fillon, Tresteniku ka me pas trotuarin deri te shkolla, kryetari Haliti e rregullon jo ti, dhe as qeveria jote e cila ti je ti sherby.

**z.Nexhat Halili:** Ti principier, se distanca e trotuarit Sllatinë - Trestenik mbi 2700 metra nuk ka përfunduar, kryetar, ka përfunduar kontrata, nuk ke kontratën.

**z.Sokol Haliti, kryetari i komunës:** Kemi kontratë. Ti donë replikë, por edhe unë kam replikë për juve që jeni tu punu në nivel qendror. Unë vetem vijë me argumente, jo si ju pa argumente. Unë ka me rregullu trotuarin 4 km të Trestenikut dhe ti po donë me thanë jo nuk është në rregull. Ajo çka po donë me thanë ti, unë i kam 40 vendbanime, ti nuk e ke votu buxhetin hiq, ti nuk ke votu për trotuarin e Trestenikut. Për stadium të Skifterajt, ki plotësisht të drejtë në emërtimin e stadiumin e Skifterajt, qysh e kemi premtu me drejtorin bashkë atje rritja me kapacitetin e rritjes së stadiumin dhe rregullimin në brava. Këtu vetem në emërtim, jo nderqja e stadiumit, por rritja e kapacitetit të stadiumit këtu ke të drejtë ti, a në pjesën tjetër unë kam të drejtë, d.m.th procedurat janë kry dhe ajo ka me vazhdu.

**z.Nexhat Halili:** Unë po të kuptoj ty, e di që është lidhë kontrata me 08.08.2024, po u lidhë për vazhdim 724 metra, jo për këtë pjesën tjetër që ende nuk ka përfunduar, dhe pjesa tjetër ku është lidhë është lidhë për këtë diferencën në mes që nuk ka pas nevojë, se nuk ka inxhiera siq duhet.

**zaj.Liridona Bislimi:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! I nderuar kryetar, shpresoj që fjalimin që kam përgatit ki me ndëgjua deri në fund, pa ndërhyrje, për shkak që është bërë një praktikë jo e hijshme, çdo herë kur jeni prezent këtu në diskutim kemi ndërhyrja, ballafaqime. Siç po e shohim, edhe tash të paktën para qytetarëve ta tregojmë një dicitlinë, se jemi të zgjedhurit e tyre. Meqenëse jemi në vitin e 3 të këtij mandati, dhe është hera e fundit që po flasim për këtë buxhet, unë kam dashtë me u ndërlidh te pjesa e premtimve që i keni bërë kryetar, d.m.th të projekteve që tashmë nuk janë në këtë planifikim buxhetor dhe nuk kanë mundësi me u implementu. Quditërisht diskutimi më i madhë lidhet me problematikat e qytetarëve të Vitisë që janë duke u përballur qe 11 vite me radhë nga i njëjti person dhe i njëjti subjekt, për çka është më e veçanta e kësaj pike që sot po e diskutojmë, është fakti që sot vërtetohet publikisht edhe vulozet se, pjesa dërmuese e atyre premtimeve elektorale që i ke bërë kanë mbetë vetem mashtrim ose në letër ose veq i ke thanë në debate. Këtë nuk po e themi ne, këtë tash po e shohim dhe po na dëshmonë secili qytetar i Komunes së Vitisë. Po filloj me i përmend disa projekte te cilat janë përserit vit pas viti, janë premtu dhe asnjëherë nuk ja keni kushtu rëndësinë në aspektin e implementimit. Sigurisht që mundemi me qujt skandal me plotë kuptimin e fjalës, skandal politik, fakti që publikisht e ki premtu që brenda këtij viti 100% ka me qenë e mbulume me ujë Komuna e Vitisë, d.m.th gjatë këtij mandati qeverisës ne jo që jemi larg gjithëpërfshirjes kryetar, por edhe ato pak fshatra që kanë qenë të kyqura në ujësjellës në shumë pak raste kjo është funksionale. Këtë e themë në takime që i mbajmë me qytetarët në teren. Ke premtu që asnjë fshat nuk ka me mbetë pa kanalizim, gjithçka ka me qenë e rregullume. Sinqerisht e dimë që në realitet jemi larg këtij premtimi: edhe si qëndron Komuna e Vitisë në këtë temë? I ke premtu 27 parqe të reja për këtë mandat me u përfunduar. Ndoshta ke mendu këtë premtim me rumullaksu me miniparqe, e kjo kish mujtë ndoshta me tu arsyetu me faktin që e menon parkun me i mbjell diku 2-3 pemë dhe qëkaq, përndryshe kjo nuk e rrokë në logjikën, në aspektin faktik. A kishe mujtë me tregu kryetar, 570 parkingje të reja ku i keni? Se qytetarët i kanë përcjell debatet dhe po na pyesin. Ku janë shtigjet e bicikletave me kilometra të tëra që i keni përmend për teritorin e Vitisë? Shembulli kryesor është ajo rruga Pozheran – Viti, është një rrugë që i lidhë 2 lokalitetet më të banushme edhe nuk është ende as në fillimet e saja, e ne e dimë sa afat kohor ke për me i realizu, e shumë rrugeve tjerë. Ke dhanë premtime kryetar që do ti' kemi të gjitha fushat sportive shkollore edhe në qytet edhe nëpër fshatra. Ne kemi qenë në teren me pa se çfarë pune është bërë në ato fusha sportive shkollore edhe në qytete dhe nëpër fshatra. Kemi pas ankesa prej prindërve që ato fusha janë shumë të rrezikshme për fëmijët dhe të papërshtatshme për lojë, për shkak të cilësisë së dobët. E kemi rastin e fundit te shkolla "Bafti Haxhiu", të cilën e kam bërë edhe publike para pak ditësh. Është vërtet turp si institucion çka ju ofrojmë fëmijeve, çfarë investime jocilesore, premtim publik ka qenë përfundimi i 3 stadiumeve sportive, në këtë rast patjetër duhet me rikujtu gjendjen e stadiumit në Viti, ku për shkak të investimeve të dobëta, pacilësore, ai lokacion aktualisht ka përfunduar në vend germadhash, d.m.th gjithçka aty tjetër mundet me u bërë, ama futboll në atë vend nuk mundet me u luajt. Ke premtu që ke me funksionalizu gjatë këtij mandati, bile në vitin e parë ke premtu që ke me funksionalizu zonën ekonomike, tash d.m.th po hymë në vitin e fundit, kemi formu një komision në kuvend, as që i keni thirrë bizneset, janë shumë të interesume për këtë pjesë, mirëpo ende deri tash nuk kemi asgjë, zona ekonomike nuk është funksionalizu. Gjatë fushatës elektorale vazhdimisht keni përmend që si komunë kemi fitu grande të përfomancës, edhe je thirrë në këtë pjesë, ama duhet me ta rikujtu që, Komuna e Vitisë qe 2 vite është tu humb grand të përfomancës me qasje të tillë të vazhdushme. Me shumë gjasë dhe ai i radhes ka me humb. 3 çerdhe nuk i ke vendos, njëra është formu prej nivelit qendror, dhe përderisa nuk i realizon premtimet, ne jemi këtu dhe nuk mundesh me na e ndalë fjalën.

**z.Sokol Haliti, kryetari i komunës:** Jeni tu e hupë kohën kotë, nuk jeni tu marrë me temat të cilat janë tu na vye për interes të qytetarëve. Unë sot para opinionit po ju themë, kuvendi duhet me kry funksionin për çka është i themelum, dhe për çka marrin rrogë. Për parqe kurr Vitia më shumë dhe drunjë nuk ka mbjellë. Mos ka mbjellë qeveria juaj atje a?! Për parkingje, i ke dhe të vizatume, i ke dhe shtigjet e biciklistëve. Për stadiume, edhe të 5 ka me nënshkru në Drobesh mes shteg të atletikes, jam i harmonizum, shumë frik dhe stadiumin e 5-të. Shko në Sodovinë te muhaxherët, shko në Pozheran tepien, zhveshtoren. Te zona ekonomike. Atë ditë sitauten e ka ruajt pjekuria e kryetarit Haliti që nuk kam dashtë me qitë qeverin komunale poshtë dhe qeverin qendore si dy institucione të themelume me kushtetut të Kosoves, përndryshe nuk kish mujtë ministresha me mbajt në teritor të Komunës së Vitisë fjalim para meje kurr hiq, se as nuk ka ligjë as topë që e luan që mundë para kryetarit të komunës me folë ministria, zonë ekonomike që unë e kam fillu, kam zhvillu debate këtu me kuvend, me qeveri me vite dhe të cilën e ka çertifiku Qeveria Mustafa dhe ministresha Bajrami, dhe të cilën më vonë ministri Bajrami e ka financu dhe ministra të tjerë dhe të cilën jam marrë me 6 ministri për me çertifiku dhe e kam

qertiliku përpara Gjilanit dhe Ferizajt dhe të gjitha komunave të sektorit lindjes, 11. dhe të cilën me përpjekje maksimale, me 100 vështirësi e kemi prurë në atë gjendje, dhe unë e kam qenë aty nikoqir dhe unë i kam përfaqësuar qytetarët e Vitisë, jo Rozeta Hajdari. Atë ditë kemi pas thyerje të protokollit, kryeministri vendit nuk ka ardhur kryetari me kryetarin, ministrja nuk ka ardhur, dhe ajo ka filluar takimin dhe unë e kam ruajtur korrektësinë, modestinë, rendin, ligjin, dhe unë nuk i kam nxitur qytetarët, se nuk mundet në teritor të Vitisë sa të jamë unë kryetar, nuk mundet dikush me fol përpara. Për zonën ekonomike po ju themë kështu, ju që nuk e keni votuar zonën ekonomike atëherë. E rrejshi kryeministrin ju që keni vjellë e çkas keni thanë që, nuk kryehet zona ekonomike, dhe tash po thua që ka të interesum për zonë ekonomike. Po ka shumë të interesum. A e din pse? Se ja kemi qëlluar.

**z.Basri Sylejmani:** Për z.Jakupin. Ju lusë të mos na fyeri, se ju jeni tu e fy kryetarin po edhe neve grupin e LDK-së, dhe plus kualicionin, pa marrë parasysh a është kundërshtar a nuk është ai është kualicion me neve dhe ju lutem të mos na fyeri.

**z.Jakup Demiri:** Tregom veç ku të kam fy dhe të kerkoj falje, se nuk jam marrë me ty as me askënd këtu.

**z.Taulant Haxhiu:** Mua nuk po më pëlqen, është bërë si pazar këtu, ndoshta kam ndryshuar unë si njeri a ju jeni bërë Taulanta e unë jam bërë ndryshe, veç këtu është bërë pazar. Kryetar, unë edhe njëherë të thashë, kod për rritje të kapacitetit të ujit nuk kemi. Unë si e pashë këtu, 217 mijë euro jan pak. Vitia, stadium të qytetit nuk ka. A ka ndonjë qytet në Kosovë që nuk ka stadium të qytetit përpos Vitisë?

**z.Illir Zuka:** Kryesues, ne kmei pas një rregullore, por po më duket këtë mirësinë tënde ndaj asamblistave jemi tu e keqperdor, jemi dal komplet jashtë nivelit. Isha në Gjilan tash, dhe deri kam shku e kam kqyr në telefon, aq keq jeni tu dalë, se dikush është ti dhanë zor kishe po dalë mirë me marrë vota me 9 shkurt, po aq keq jeni tu dalë që, kur ta kqyrmi në mbramje keni me i ra pishman që keni folë.

**z.Remzi Salihu:** Unë i dëgjova të gjitha me vemendje dhe nuk i ndërhyra askujt, përpos që kryetari shpeshherë kur i has sharra në gozhdë, apo kur nuk mund me argumentu një çështje e cila ngritet nga këshilltarët, del menjëherë te kontrata kolektive, duke u arsyetuar që qeveria i ka fajet këtu. Kryetar, nëse të kujtohet, jo i vetmi, po ndër të tjerët kam qenë unë se qysh në fillim lidhur me kontratën kolektive kam propozu që ne si kuvend të marrim një vendim, dhe nuk na kishin grumbullu këto të holla. Shtrohet pyetja, me çfarë të drejte i ka marrë qeveria tash prej buxhetit të komunës. Nëse i ka marrë në mënyrë të padrejtë, paditne qeverinë e mos na tregoni këtu pallavra. Qeveria dakort se te qenka fajtor, po kush është fajtor kryetar për 136 mijë e 234 euro që i kërkon përmbaruesi për punën që është bërë. Është shtruar asilati në pronë private pa shpronso, edhe devijimi i lumit atje që e ka demtu xx personin në fjalë: kush është fajtor?

**z.Sokol Haliti, kryetari i komunës:** Pazare nuk mundet me bërë kryetari i komunës me arsimtarë. Kontrata është e nënshkrume, ka të drejtë secili me të paditë në gjyq.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Faleminderit për diskutimet dhe mendimet për këtë pikë të rendit të ditës. Propozim patëm tek Veçoni, po ky e dha me shkrim. Te Taulanti patëm propozim konkret. Kodi për rritje të kapacitetit të ujit, propozime konkrete, një kod. Një diçka nuk kemi pas tjetër që mund ta diskutojmë. Unë e hedhi në votim. Pra, me 16 pro, 8 kundër, 0 abstenim miratohet kjo pikë.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Vazhdojmë me pjesën e dytë pas një pauze.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

### 3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoha

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** E dini që krahas miratimit të buxhetit bëhet edhe rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoha, që deri tani e kemi bërë për çdo vit. Kësaj radhe me rekomandimin e ministrisë nuk e kemi shenu për vitin 2025 po e kemi bërë si rregullore. Derisa nuk ka ndonjë plotësim ndryshim në ligj, kjo rregullore mos me u ndryshu, që mund me vazhdu dhe 2-3 vite deri nuk ka ndryshime. Ka qenë në diskutim publik me pikë të rendit të ditës në kuvend dhe gjatë diskutimit publik dhe gjatë punimit të rregullores pothuajse 99% e më shumë është e njëjta që është përcjellë me vite, se kjo një pjesë e madhe dhe nuk mund të lëvizë për shkak se i përshtatet aspektit ligjor. Po te pjesa e komplet ndryshimeve çka janë, është te neni 9, kërkesë e Drejtorisë së Arsimit, që pagesa në çerdhe prej 30 euro të bëhet 50 prej 1 janari. Neni 10 është te Drejtoria e Kadastrit. Vlera me ligje që jan ndryshu. Neni 11, ndryshimet janë te Drejtoria e Bujqësisë, që janë pjesë të ndryshimit të ligjit që ja kemi përshtat ligjit. Pjesa që është ndryshu, që mund të përcaktohetmi ne për 30 apo 50, është pjesa për çerdhe që është propozu prej Drejtorisë së Arsimit, që 30 euro ka qenë vlera shumë e ulët në krahasim me çdo vend që janë çerdhet.

**z.Taulant Haxhiu:** Unë po e shofë që shumë 30 me 50, unë diku 40-45% ngritje është e madhe, sepse çerdhja e Vitisë ka shumë nxënës, është e stermbushur, të gjithë prindërit janë të paknaqur, për shkak se çerdhja është

e vogël. Kanë nevojë për një çerdhje tjetër fëmija, nënstop po kanë nevojë me i qu mbajt çerdhes private me shumë se ato private, për shkak besueshmërisë, dhe tash janë disa familje që, në qoftë se ja rrisim për 20 euro, 12 muaj pi bjen 240 euro. Po më duket shumë. Pasi ta bajmë dhe një çerdhe tjetër, dhe të kemi hapësira më të mëdha, të gjithë prindrit të cilët janë të pakënaqur për shkak se ka shumë numër të kërkesave të nxënësve që është enormë. Çerdhja është e vogël dhe nuk i përmbush kapacitetet, dhe unë e kundërshtoj këtë. Në të mbetet 30 euro.

**z.Sejdi Emini:** Kur jemi në këtë pikë të rendit të ditës, atëhere me shumë vëmendje duhet të shikojmë dhe sa mundet ti përmballojnë qytetarët këto taksa dhe gjoha që janë para neshë. Edhe unë te kjo pika tek çerdhja prej 30 në 50 euro, mendoj që maksimumi është dashë me u bë 35, kjo rritje prej 66% me u rritë është shumë. Ndoshta për disa është e përballueshme, por për disa nuk e di sa munden me ja dalë. Nëse mendohet me u rritë është me u rritë veç për 5 euro. Dhe te vertetimet, qertifikata e pronës deri në 10 faqe, shënime të shtypura 2 euro, mbi 10 faqe 10 euro. Tash, nëse deri në 10 faqe të 11 me bë 10 euro. Mendoj që është një dallim i madhë për një faqe 10 euro. Mendoj që duhet t'i ndihmojmë dhe disa familjar që punojnë taksi individual, kosto e kësaj në vit është 50 euro, tu i pas parasysh vështirësit që i kanë me punën e tyre me mbajt familjen e tyre. Mendoj që edhe këtyre duhet me ja u zbrit prej 50 në 25 euro, së paku të solidarizohemi me këta. Ashtu kështu kushtet i kanë të rënda dhe punë kan pak. Mendoj që kishim me i bë mirë me pas parasysh edhe me ndje gjendjen të cilën ata janë. Aty ku mendoj që duhet mos me pas mëshirë, tek kompanitë e mobiljeve, siç është ipko e vala, tu e ditë se sa po na respektojnë, fare hiq, e kqyrin punën e tyre, por pse jo dhe tek KEDS-i trafon të cilën po e vendosin, po e lypin pronën e komunës me vendos trafo. E pse edhe ne mos mi qitë tarifa atyre, kur e dimë që asnjë ditë të vetme ata nuk ja falin qytetarit rrymën dhe janë në gjendje në çfardo kushte me ja nderpre rrymën.

**z.Basri Sylejmani:** Unë kisha than te çerdhja e fëmijeve, pa marrë parasysh, ata që i dërgojnë fëmijët në çerdhe, ata pa i pas 2 paga nuk shkojnë, se mos me qenë 2 paga e man fëmijën te shtëpia. Nuk jam tu shku në ekstrem, 5 euro është pak, 20 euro me e rritë është shumë, 10 euro është noramle me bë 40 euro.

**z.Ali Bajrami:** Te këto pjesët tjera nuk do të ndërlihdna, vetem te rritja e çmimit të çerdhes publike. Drejtoreshë, a keni ndonjë parallogari, për 1 vit sa kushton qëkjo diferenca prej 30 në 50 euro? Tu bazu në numrin e fëmijëve që janë aty, dhe propozimi im që ne nëse shkojmë 30 në 50, këtë 20 euroshin që e rriti qeveria qatyne fëmijëve po ja u marrim me ja u qu në çerdhe. Diferencën prej 30 në 50 prej të hymave vetanake me subvencionu komuna. Nuk jam për me rritë, por jam këtë propozimin tem me qitë në votim.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Drejtoresha shumë u konsultu edhe me mu kur e ka bë propozimin. Arsyet pse është propozu, se ne do ta marrim atë vendim, si do ta marrim së bashku, kjo është një pikë nisje e cila na shtin me diskutu. Nuk ka çerdhe publike në nivel të Republikës së Kosovës 30 euro përveç në Viti. Diferenca mes çerdhes publike dhe çerdhes private, kopshtit ta quaj, është diku 150% më e shtrejt. Konkurrueshmëria këtu është aq e lartë sa që edhe stafi janë nxor. Ky propozim ka qenë me ju parafaru, që qytetarët me pas mundësi me i qu edhe aty privat dhe këtu. Ka edhe beneficion tjetër. Për fëmijën e dytë paguan 70%, për fëmijën e tretë lirohet krejt. Megjithatë ju jeni këtu, ka shumë vite që nuk është rritë. Prej të hyrave vetanake Ali, na nuk jemi asi komuna me të hyra të mëdha. Neve nuk jan tu na dalë prej buxhetit të komunës. Nuk ka fëmijë as me 100 euro që i mbulon shpenzimet në çerdhe. Ne jemi tu e stimulu. Ai nipi jem dhe tut që shkojnë aty, shkojnë mbi 100 euro. Ka edhe edukim, ushqim, prandaj ne jemi tu participu aty, na i sigurojmë krejt aty, por megjithatë unë po i vërej këshilltarët që, Taulanti është me mbet ashtu qysh është, Sejda me bë një rritje prej 35, Basria 40. Ne e gjejmë së bashku cili është më i mirë, nuk na prish punë dhe 30, por binduni që telashe kanë ata prej prindërve, prej konkurrueshmëris së madhe. Unë e di që ndoshta prej vitit të ri do të zbrazet pak, për shkak të hapjes së çerdhes në Drobesh, por prapë nuk ka me i plotësu kushtet. Tash shkollat kanë me na tepru çerdhet nuk kan me na dalë dhe si kusht është nuk kemi çka bisedojmë, badihava bëje politiken e punësimi, në rastë se nuk e siguron për me qu fëmijën, se nuk mundesh me shku në punë, dhe ju jeni ata të cilët e vendosni. Ne kemi bë këtë propozim me u nis prej ni pikës. Nëse e shihni që nuk bënë me ndryshu e lajm 30 ja umerrë mendja se e ndryshojhm pak në simbolik është mirë me qenë unanim në këtë votim se biseodet për feijet tanë apo nipat tanë megjithatë duhet me qenë një unanimitet mos me u perdor në aspekt politik por në mirqenje të qytetareve.

**z.Musli Neziri:** Duke i dëgjuar parafolësit, edhe nënkryetari si e elaburoj, mendoj që nëse është parapa me u rritë, kjo rritje këtu më shumë po më duket që ndoshta mos është me ik numrin, mos me mbi ngarku. D.m.th ta rrisim çmimin e ta zvoglojmë numrin tek konkurenca, megjithatë tash ju e keni vlerësu, drejtoresha ose ekzekutivi, por 20 euro edhe mu po më tingëllon pak shumë. Fëmijët që shkojnë, ato kushte që i kanë tash si është parapa kjo shumë se si do të kthehet aty, sepse ne e dimë që ashtu kshtu ka qenë e ngarkuar. Çerdhja është parapa kjo shumë se si do të kthehet aty, sepse ne e dimë që ashtu kshtu ka qenë e ngarkuar. Çerdhja "Gëzimi Ynë" në Viti punon me një numër shumë të madhë të fëmijeve. Te kjo pjesa private nuk e di si i kanë rregullat, a shkojnë me DKA apo i qesin vetë kushtet, pagesat i caktojn vetë. Edhe unë jam që të rishikohet dhe

ta marrim një vendim bashkarisht këtu. Unë nuk po foli shifër, por po mendoj që mos është më mirë me pas një zbritje nga kjo që është propozu me gjetë një mesatare.

**z.Taulant Haxhiu:** Ne nuk e kemi bisedu këtë temë as me grupin parlamentar. Për mua që kur thatë prej 30 euro me bë 50 më tingilloj pak emocional. Tash nuk po hy prej pozites time e të tjerave, disa që i dërgojnë në çerdhe private dhe publike. Dikush i qonë në private për shkak të mundësisë, po zakonisht ata që shkojnë në çerdhe publike, ata shkojnë për shkak të kushteve të cilat i kanë, dhe ne nëse e risim për 20 euro, i bie 240 në vit, kurse ne kemi një inflacion të shportës së qytetarit. Ne përpara kemi ble artikuj ushqimor me 100, kemi marrë artikuj që na vyen për shpi. Të njëjtat artikuj me i blej në këtë kohë bëjnë 140 euro, që 12 muaj kushtojnë 480 euro edhe 240 euro po e risim, këtu po i bie 720. 2 paga të prindërve të tyre po ju merren veç me çerdhe dhe inflacion që e kemi sot. Dhe ti risim 20 euro, është shumë, se ata të cilët i kanë kushtet më stabile, ata kanë mundësi me i dërgu në çerdhe private. Unë e kam djalin tem në çerdhe private, e kam pyet drejreshën dhe thash të bëhem si gjithë të tjerët, më tha që është vendi i mbushur, por ne prej 30 në 50, 66% është jashtëzakonisht e madhe me këtë shumë të rritjes prej 240. Ai mund të blej veshmbathje për një stinor, kurse ne po ja marrim atë, është kogjo kosto e madhe. Unë kisha propozu për shkak inflacionit, për shkak krizes së madhe që ka kap popullin tonë. Është mirë ta lajm me këtë çmim, se kogjo është e rendume për prindit. Nuk jam tu bë politikë, por kaq shumë kërkesa për shkak çmimit që është solid.

**z.Sejdi Emini:** Edhe te këto çertifikatat shëndetësore për punësim 15 euro. Vetë fakti që është për punësim njeri është pa punë, d.m.th vjenë me kërku punë 15 euro me ja marrë disi shumë po më duket. Dhe këtë a ka mundësi 5 euro të paktën me kthy.

**z.Taulant Haxhiu:** Dhe një konsultim tek çerdhet private. Ata punojnë 12 muaj, kan pushime 2 javore, kurse tek çerdhet publike më duket që pushimi është më i madh. Nuk e di sa kanë pushim brenda vitit. Unë edhe një here po themë, e di që është kosto e madhe me mbajtë një fëmij, aty ka ushqim e trajtimet tjera që i ka, por unë maksimum që kisha mujtë me propozu prej 30 në 35 euro për 12%, më shumë goja ime nuk e thotë.

**z.Ali Bajrami:** Unë propozimin kur e dhashë, mos me hi me i përserit të njëjtat fjalë. Një që unë nuk dua të jem pjesë e këtij votimi dhe rritjes së çmimit, të jeni të bindur se si të dalim prej këtuhit, këshilltarët e kuvendit komunal jau rriten fëmijëve çerdhen prej 30 në 50 euro. Unë nuk dua me u përfol në këtë kontest me qenë për me ulë çmim po, por për me rritë çmim unë jam kundër. Propozimi imë është 30.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi i kuvendit:** Propozimi është 50, më heret ka qenë 30. Propozimi është bërë 50 tu i pa nevojat, shpenzimet që janë shumë më të mëdha, tu e pa kërkesën. Nuk jemi tu folë për raste sociale. Pjesa tjetër çka kërkoj tjetër mbi 10 faqe që delë, d.m.th janë të parapame me ligj. Ti nuk ke çertifikatë mbi 10 faqe, po me rregullore janë të përcaktume nivel vendi. Kisha kërku prej shefave të grupit, për çerdhe që ta bëjnë një konsultim dhe një propozim, ne të mbetë cili do ne të jetë. Me këto ndryshimet që i keni pru këtu, tjera janë ligjore, pjesa tjetër mbesin nga e kaluara. Te çerdhja mbetë 30 sikur që ka qenë, d.m.th nuk kalon propozimi në 50 euro. A jeni që të miratohet kjo rregullore? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet dhe kjo pikë.

Si pikë e katërt e rendit të ditës:

**4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për planin e punës të Kuvendit Komunal të Vitit për vitin 2025**

**z.Bekim Azizi, kryesuesi i kuvendit:** Planin e punës e kemi qitë në diskutim publik. Pas diskutimit publik prapë komisioni ka mbajtë një takim, janë rregullu pjeset që kanë qenë me pak ndryshim janë rregullu. Pjesa e raportimit që ka qenë në dhjetor ka dalë në janar dhe ka hy një pikë te çashtja e informates vjetore në kuvend për menaxhimin e mbeturinave. Kanë qenë dhe disa kërkesa tjera që në debat publik që të organizohet kuvendi pritje për mërgimtarët, mirëpo ajo nuk është me plan të punës, ajo vjenë me vendim, se plani i punës paraqet senacat që do të bëhen. E kemi shti, d.m.th në plan edhe çështjen e diskutimeve publike që i takojnë KPF-së, është i njëjtë që i paraqet anën ligjore. Ju kemi përmbajt pjesës së takimeve, ligjeve, n'bazë muajve raportimeve që janë, informata, mirëpo kemi lanë gati çdo muaj pika që mundë të vijn nga egzekutivi ju e dini që në kuvend mund të vijnë pika pa qenë në plan, pika që mund të propozohen me inicativa, me forma të ndryshme, është parapa pjesa e seancave solemne. Ato që janë të parapame me statutin e komunës ju kemi përmbajt përgjegjësisë është çka na përcjellë me vite, mirëpo është aspekt ligjor që duhet të ju përmbahemi planit. Hapi debat për këtë pikë. Pasi që nuk ka për debat e qes në votim. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e pestë e rendit të ditës:

## 5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e buxhetit të participuar nga fermerët përfitues

**z.Naim Pira, drejtor:** Pershendetje për të gjithë të pranishmit! Para jush e kemi propozim vendimin për aprovimin e buxhetit të participuar nga fermerët e Komunës së Vitisë, d.m.th kemi të bëjmë me projeksionet apo subvencionet e fituara nga ana e fermerëve të komunës sonë. Në atë pjesën që kemi participuar në bazë të një udhëzimi që na ka dërgu Ministria e Financave, përkatësisht Zyra e Thesarit lypet që të kalon përmes kuvendit, d.m.th keni pas si duket dhe vitin e kaluar, se nuk kam qenë këtu dhe prapë kërkohet në mënyrë që këta të gjithë e kanë bërë pagesen po në mënyrë që ti paguhet operatorit. Duhet të kalohet edhe përmes kuvendit. Kërkoj në mirëkuptimin e juaj ta kaloni dhe këtë pikë, në mënyrë që të na lironi duart, ta bëjmë pagesen atyre.

**z.Jakup Demiri:** Vitin e kaluar kjo më duket na është kthyer 2 here.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi i kuvendit:** Kanë qenë se i kemi shti dy vendime me një kod, tani na janë kthy rishikim. Pasi që nuk ka më për debat, a jeni që të kaloj kjo pikë. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet dhe kjo pikë.

Si pikë e gjashtë e rendit të ditës:

## 6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për transferin, rialokimin e mjeteve buxhetore në mes programeve, nënprogrameve buxhetore në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale

**z.Milijate Ajeti, drejtoresha:** Po i ceku vetem fondet. Kategoria ekonomike e investimeve kapitale të ridestinohen mjetet në mes projekteve, shuma 10 mijë euro, programi i buxhetit të financave është 175, nënprogramin e buxhetit 17533. Nga projekti "ndërtimi i urave jazava", Podgorc, Lubishtë, Budrikë, Skiferaj, kodi i projektit 55027, në shumë prej 10 mijë euro, ndërsa projekti tjetër, "participimi i projekteve me donatorë", kodi i projektit 90552, në shumë prej 10 mijë euro. Fondi burimor prej 21, kategoria ekonomike kapitale, mjetet mes projekte shuma 53 mijë e 73.76 euro, programi i buxhetit, financat 175, nënprogrami 17533. Nga projekti "ndërtimi i urave jazava", Gelbushi, Lubishtë, Budrikë, Skifteraj, Podgorc, kodi i projektit 55027, në shumë prej 53 mijë e 73.76 euro, në projektin participimi i projekteve me donatorë, kodi 90552. Arsyeja është bartja e mjeteve për projektin "ndërtimi i urave" është kërkuar për arsye se ky projekt, edhe pse ka qenë në proces tenderimi, por vazhdimisht nuk ka pasur operator serioz gjatë ofertimit për të bërë të mundur lidhjen e kontratës për kryerjen e punëve.

**z.Jakup Demiri:** Te pjesa e buxhetit që i diskutuam, megjithëse shumë gjera nuk arritëm me i thanë, për shkak të devijimit të temave. Problemi ky është te planifikimi, te ndarjet buxhetore, se ti këtë projekt që të kushon 200 mijë euro i ndanë 10 mijë euro dhe normal që nuk është i interesum askush në atë projekt, dhe tani hajde ti bartim, t'i qesim tjetërkund, ndërsa ndoshta edhe atje presin njerëzit me i ndertu ato ura, me i kry ato punime dhe ato pare. Një kohë kanë pritur se nuk është i interesum, nuk po merrë pjesë askush që me i marrë punimet. Në buxhet ishte dhe palestra sportive e fshatit Smirë, 20 mijë euro me grand qeveritar dhe 10 mijë euro pare komuna shumbull, 30 mijë euro krejt, dhe tani neser duhet me i barë ato pare me i qitë dikund, se nuk konkuron askush me të ndertu sallë 30 mijë euro. Kjo është puna e planifikimit që po themë, dhe tani na birni neve, hajde t'i rialokojmë ose t'i bartim tjetërkund. Pse me marrë ne atë përgjegjësi, u kanë dashtë me i gjetë mundësitë dhe tani te buxheti me shti dhe këto. Këto veç me i bartë në vitin tjetër, masi kanë tepu, edhe me i kry ato punët, jo tash ato leje krejt ti gjujmë qekha te participimi. Kjo është një vërejtje shumë serioze sahere që bëni projekte pa pare, normal që nuk është i interesum me i marrë dhe këto që po kanë probleme, telashe vazhdimisht, që nuk po kryhen kurrë, që 26 projekte kanë hy në vitin e 6-të pa u kry dhe nuk të jep as përgjigje këtu. Ky është një problem që neve po na përseritet shpeshë.

**z.Nexhat Halili:** Drejtoreshë, në këtë vlerën 63 mijë e 73 euro e 76 centë i kemi nda në 2 pozicione prej këtij projekti te ndertimi urave te ky fondi i participimi i projekteve. Unë e kam listen e projekteve investive të vitit 2024, këtu vlera të projekteve është 30 mijë euro, tash ju po bartni mbi 63 mijë euro prej cilit projekt po e merrni pjesën tjetër.

**z.Milijate Ajeti, drejtoreshë:** Prej KPF-së që ka qenë lista, tani ka ndryshu e sotit.

**z.Berat Zuka, zyrtar i financave:** Ne jemi tu folë për listën e projekteve kapitale që gjinden në SMFK vitin e kalum. Unë garantoj që të dhënave e shpenzimeve operative hynë në sistemin e BDMS dhe të dhënave e projekteve në sistemin e PIPIT. Vitin e kalum çka është miratu në këtë kuvend janë shënimet e sakta, është bërë ndryshimi ditën e fundit, po këtu në kuvend ju nuk e kemi atë listen e sakt që kemi bërë ndryshimin e projekteve,

sukur sot qe kemi bë ndryshime në momentin e fundit këtu. Unë ka me i përmirësu dhe ai draft buxhet ka me u publiku si plan buxhet dha ai ka me hy në sistem. Ai buxhet që e miraton kuvendi komunal prej 2008, unë të garantoj që asnjë presje kurr nuk e kemi ndryshu, edhe i himë prej tashit i kontrollojmë gjitha buxhetet, se edhe Zyra Kombëtare e Audimit kur të vjen, së pari çka u miratu të kuvendit dhe na e kontrollon pjesë për pjesë na e kontrollon. Kjo listë ka qenë e ndryshime në momentin e fundit vitin e kalume në kuvend. Këtë listë nuk e keni sot listën çka ja u kemi dhanë të votimit sot. Kryesues, më duket që patem ndryshime me shtu dhe një projekt, kjo hynë në buxhet dhe unë nuk besoj që, zyrtari i PIP-it i ka pas interes me i ndryshu këto shuma se, projekt për projekt ka me i futë të dhënat në PIP, se ky material i kuvendit tonë në Ministri të Financave nuk shkon asnjë, përveç vendimit dhe kërkesës veqant të kryetarit, tjerat shkojnë krejt dokumentet të ddms që ne i kemi përgatit dhe PIP-in jemi në përgatitje e sipër.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Berat, mjetet që barten mjetet janë veç të zotume. Ato mjete a janë 58 mijë a 20 mijë, si po thu ti? Nëse janë 20 mijë ti sun i bartë 58, po nëse janë 58 mijë, atëhere i bartë 58 mijë.

**z.Berat Zuka, zyrtar i financave:** Këto mjete gjenden të lira, për momentin të pa zotuar, vetëm të alokuara, bile të hyrat vetanake ende nuk janë alokuar 53 mishi nga të hyrat vetanake, vetem grandit qeveritar është i alokum, nuk jan as të zotume as të shpenzume.

**z.Nexhat Halili:** Berat ose i keni marrë prej ndonjë projekti i keni bë bashkë. Në bazë të kësaj liste që kam kështu është 30 mijë euro.

**z.Jakup Demiri:** Është e gjetur e auditorit që, me vendim të kryetarit, pa vendim të kuvendit janë bë pagesa prej kodit në kodë. Nëse ti ke bë një pagesë këtu që mua nuk po më perputhet me tabelen që kam 2023, që është votu për 2024, që këto projekte nuk e kanë këtë shumë, veç këtu sqaroma se në rregull jemi.

**z.Berat Zuka, zyrtar i financave:** Këto mjete të lira i kemi për momentin, janë prezent në kuvend, se ky projekt ka dështu për me i bartë në partitëm të projektit me donatorë për kryerjen e obligimeve të grandit të përformances, që grandit i përformances për 2023 ka mungu.

**z.Nexhat Halili:** Berat, po të kuptojm që procedurat e prokurimit kanë dështu për shkak planifikimit jo adekuat, por unë listen e kam me 30 mijë, tash këtu është mbi 63 mijë po barten prej këtij pozicioni në pozicionin tjetër, kur unë listen e kam 30 mijë. Si me votu?

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Forma që ka dalë prej pjesës së planifikume në kodin që na ka ardh neve sot është çështje tjetër e procedurave tjera. Parimisht neve na ka ardh një kod që i ka këto mjete. Parimisht në kodin që po diskutojmë parat janë që ato parat mund të barten në kode tjera në aspektin ligjor. Ky është propozimi që na ka ardh, e forma se po të kuptoj ty prej asaj që e ke listen që e kena kalu në buxhet e që u bë prej 20 mijë në 63, nuk është çështje që diskutojmë ne.

**z.Nexhat Halili:** Unë po i kuptoj kodet. P.sh.: nëse këta i kanë marrë prej një projekti tjetër, këta u dashtë me cek se po i marrim dhe këtij projekti tjetër, po këta e kanë cek prej urave, plus në 2024 urat e Skifetrajt dhe Remnimku nuk figuron hiq në këtë listë, vetëm këto Podgorci dhe këto tjerat.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Pjesa tjetër i mbetë institucioneve që janë përgjegjëse me kqyr si janë bartë ata. Parat prej një kodit në kodin tjetër mund të barten në aspektin ligjor.

**z.Berat Zuka, zyrtar i financave:** Nëse kjo nuk kryhet në këtë seancë, është problem, se deri me 25 dhjetor kemi të drejta e zotimeve ose eventualisht 30 tetor të drejten e zotimeve kapitale prej asaj dite sa lihen mjete të lira me 100 kërkesa. Ministria e Financave nuk ka asnjë rregullore që e mbulon asnjë udhezim administrativ, as ligji.

**z.Ali Bajrami:** Ne propozimin e kemi, po e votojmë. Ti mirë e the, janë organet që i mbikqyrin këto gjera, kurse ne kurrfarë përgjegjësie nuk kemi dhe nuk besoj që edhe këta i kanë pru për me bë shkelje.

**z.Berat Zuka, zyrtar i financave:** 10 mishi humbet, kurse 53 mishi bartet automatik sikur vitin e kalum që janë bartë në vitin 2024, shpenzimet me centi barten.

**z.Nexhat Halili:** Nëse bartet automatikisht Berat, atëhere pse po e bjen në kuvend me votu.

**z.Berat Zuka, zyrtar i financave:** Auditori kur të vjen, së pari e shef realizmin e shpenzimeve në përqindje. Këto mjete janë të lira me i bartë në një projekt që mundet me u shpernda. Kemi përqindje dhe nuk kemi obligime me bartë në vitin e kalum. Kjo edhe nëse hynë si pikë para dates 27, 28, nuk i bartin Departamenti i Buxhetit, Ekziston mundësia mos me i bartë fare nëse kan probleem me VDMES dhe me PIP-in.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** A jeni që kjo pikë të kaloj? Pra, me të 14 vota pro, 0 kunder, 7 abstenim miratohet dhe kjo pikë.

Si pikë e shtatë e rendit të ditës:

**7. Informatë lidhur me raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare të Komunës së Vitisë për vitin e përfunduar me 31.12.2023, dhe pika e tetë, se këto janë plane dhe nuk i votojmë është:**

**8. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditorit për vitin 2023**

**z.Berat Zuka:** Zyra Kombëtare e Auditimit e ka obligim organizatat buxhetore që të auditohen, auditohet rregullsia e anës rregullative financiare. Në komunën tonë në fillim të muajit dhjetor kemi pas auditimin prej 3 ditë nga tre zyrtarë të Zyres Kombëtare të Auditimit, koordinator me ta jam caktuar unë nga kryetari dhe pjesa e dytë e auditimit është bërë afër 3 javë ditësh prej 3 zyrtarëve të Zyres Kombëtare të Auditimit në Komunën e Vitisë. Ju garantoj se në kohë të gjitha materialet janë ofruar dhe ata kanë ardhur në përfundim se raporti financiar i Komunës së Vitisë kualifikohet për vetëm të gjetur për keqklasifikimin e bërë nga Departamenti i Thesarit për pagesën e pagave jubilarë të marra nga kategoria ekonomike shpenzime kapitale, mallra, shërbime dhe subvencione. Të gjetura të tjera janë dhe 8, mirëpo raporti ynë kualifikohet sikur një vit më parë. Vite më parë kanë gjetë dhe 2 të gjetura tjera që e kanë ndihmuar që e gjetura e 3-të nuk ka qenë e rregullsisë, për shkak që konkluzionet nuk ndikojnë në raportin financiar në tabelat kryesore, mirëpo në tabela kryesore e kanë gjetë dhe e kanë pa si kriter që keqklasifikimi i shpenzimeve nëse e kalon 1% të buxhetit, gjithë ato komuna të kualifikohen. Unë ju kam afruar edhe të gjitha e-mailat e mi që kemi pasë me departamentin e thesarit, kryesisht me pagesat zyrtarët që merren me pagesat e kontratës kolektive, mandej i kam pas dhe 3 kërkesa të korigjimit të shpenzimeve që nuk janë marrë parasysh po i kanë parë, mirëpo komuna jonë prapë se prapë është kualifikuar opinioni i kualifikuar për shkak të keqklasifikimit të gjitha veprimve të cilat janë bërë nga thesari, që me përgjegjësi të plotë themë se, asnjë zyrtar i komunës së Vitisë nuk ka pas qasje në këto shpenzime. U fol edhe para drejtorit kontrata kolektive, neve që 2 vite që na shkakton telashe, për shkak të kualifikimit të raportit që, një e padrejtë shumë e madhe ju bëhet komunave dhe këtë vitë deri më tani afër 3 milion euro janë marrë nga thesari për pagesë të kontratës kolektive, që para 3 ditëve ka ardhur dhe faktura e fundit 1 milion e 364 mijë, që nuk dinë kush prej komunës me ju dhanë përgjigje se ku të mirren këto mjete. Këto mjete ne nuk mund të them të merren as në paga, as në mallra, shërbime, as në komunal, as në kapitale, subvencione, sepse është keqklasifikim, mirëpo edhe buxheti i planifikuar dhe i miratuar mos gabofsha edhe kryesuesi ka qenë në forumin e liderëve në Gjilan, kur jemi pyetur, Komuna e Vitisë 350 mijë euro paga, kornizen buxhetore pse e kemi në planifikim. Më tepër unë jam mundu me ju arsyetu, sepse 350 mijë euro kemi planifikuar më tepër dhe mbetja e punëtorëve nëpër programe afër 200 mijë me rumbullaksu me 500 mijë të kemi kategori të pageve të pagurara, mos të bëhet keqklasifikimi. Zyrtari dhe drejtori i departamentit të buxhetit komunal në prani e gjithë komunave kanë thanë dhe janë zotuar, sepse nuk mund të bëni planifikim për disa shpenzime që ju nuk jeni nënshkruar të tyre kontratave. Nuk na kanë lejuar për kontratë kolektive asnjë cent të planifikojmë dhe nuk e kemi të planifikime. Ky buxhet çka është, është për të gjitha shpenzimet operative të cilat rrjedhin nga 1 janari ose obligimet eventuale që mbesin për faktura nëpër programe të ndryshme për të paguar në fillim muajit shkurt obligimet dhe të tjera për të gjitha shpenzimet dhe operacionet të cilët kryhen brenda vitit 2024, andej dhe këto të gjetura kemi dorëzuar dhe planin e veprimit në Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe të gjitha gjeturat tjera që nuk janë të gjetura që e rendojnë ose kanë efekt negativ aq shumë, sepse ne e dimë pagesën e fakturave mbi 30 ditë është e pa mundur, kur janë 20 programe buxhetore, kemi operator të ndryshëm ekonomik që e binë mallin, por në kohë nuk e binë fakturën ose nëse e binë fakturën nuk jemi në gjendje me i procesu brenda afatit 3-ditorë mbesin obligime. Por, sidosoqoftë obligime borgji nuk vjetrohët kurrë, prap e paguajmë. Kemi edhe të gjetura tjera, mos të përmendim tjerat, i kemi dhe në material, besoj që shumica e të gjeturave janë zotuar se të gjithë akteret të cilët atakohen që të punojnë më tepër se vitet tjera dhe këto të gjetura vitin e ardhshëm mos të na përsëriten.

**z.Jakup Demiri:** Zyrtari u mundu dhe na sqaroi deri diku diçka, por neve këtu po na thonë po jeni të vrazhdë dhe të pakulturur kanihere për kritikën që ja u japin, dhe shikojë këtu ku e ke gjendjen. Vitin e kaluar e ke humb dhe prap sivjet te ka humb komuna jonë grandin e performancës. I ka dalë Zyra e Auditorit Kombëtar. Në raport thotë se, është i kualifikuar te b1, nuk i kam të kështj unë, se kjo puna e kontratës kolektive është e komplikime, e aty edhe nuk isha ndalë shumë, por i kam fushat e tjera, shembull b2 thotë: në 26 raste për pagesa, mallra dhe shërbime, zotimi i mjeteve me urdhër blerje ishin procesuar pas pranimit të mallit, fakturës. Ti po thu që e paguaj mallin, ne nuk jemi pa e pagu, por kur e pagu më vonë pagu mallë jociësor, çka të ka lanë paguan, nashta dhe penallti të tjera, dhe fundi i fundit, zyrtari është për atë punë, kur ti vjen faktura me të ka mu marrë jo me tjetër sen. Kjo është e gjetur e auditorit. Tek b3, komuna kishte të angazhuar 33 zyrtar me kontratë për shërbime të veçanta dhe për ta nuk ishte zhvilluar procedurë të prokurimit siç kërkohet me Ligj për Zyrtarë Publik. Po unë po ju pyes dhe për këta përmbaues që po ua marrin njerëzit e shpiav po nuk po më jepin përgjigje.

Njerëzit e shpisë tjuve po jua marrin, që fatkeqësisht ti nuk e qeverisë komunën, po e thamë publikisht, e qeverisë Zyra e Prokurimit, kryetari edhe firma e Florent Eminit. Florent Emiri i ka marrë 145 mijë euro me përmbarues. A është e vërtetë?

**z.Berat Zuka, zyrtar i financave:** Nuk jam tu e mbrojtë asnjë të keqe. Këtu të gjitha çka janë të gjetura të auditorit janë fakte, i keni.

**z.Jakup Demiri:** Ky është dokument valid, jo muhabetete, e juve ta ka gjetë. Unë ti gjaj edhe disa tjerë që nuk ti ka gjetë ai, veç ti e dinë mirë. Thotë 33 zyrtarë, këta janë 33 militanta që se dinë me emër, mbiemër ju sun i gjani hiq, po veç ja u jepni ka një pagë qaty përpara i keni pas ka 100, tash 33, po edhe tani i keni 45. Mirë e dinë, 83 i ke pas ti, i ka gjetë dhe 11 s'ti ka gjetë. 94 i ke pas. Nëse 5 raste fakturave në vlerë prej 84 mijë euro nuk ishin paguar brenda afatit kohor ligjor prej 30 ditësh, sa është shuma mandej e penalltive, pse nuk e qitni dhe atë çdo pagesë që nuk paguhet me kohë e ka koston. Unë po ta marrë si të mirëqenë prezantimin tand me i ndihmu drejtoreshës. B5, komuna ka përdorur fonde të projekteve për qëllime tjera nga ajo që për çka ishin planifikuar, pa i zotuar procedurat dhe kriteret për transferimin dhe rialokimin e mjeteve buxhetore. Rasti në që nuk e votojshim parzit.

**z.Berat Zuka, zyrtar i financave:** Komuna ka përdorur, po zyrtarja ligjore është bazu në Ligjin e Menaxhimit të Financave dhe Përgjegjësi të 5% kryetari ka të drejtë barjen, mirëpo me Ligjin e Buxhetit nuk është paraqitë për vitin 2023 kjo 5%, edhe atëherë zyrtarja e ka lexu Ligjin për Menaxhimin e Financave dhe nuk është ajo si me thanë superior për me i ditë krejt ligjet përmendsh. Zyrtarja ligjore i ka bërë vendimet, janë pagu, vetëm është ndërru destimi i projektit me vendim të kryetarit.

**z.Jakup Demiri:** Krejt në rreugll, nuk kanë durim, qohet nënkryetari dhe hecë prej ktuhit. Veç a je i bindur që e fiton grandin e performancës në qëta a e dinë që janë mbi 1 milion euro investime kapitale.

**z.Berat Zuka, zyrtar i financave:** Sun e fiton grandin e performancës. Unë më heret të tregova deri me datën 16 gusht mbi 3 milion euro janë marrë për kontratën kolektive, projektet naj kanë marrë.

**z.Jakup Demiri:** Mos e mbulo veten te kontrata kolektive, se të thashë ki punë 400 mijë euro, ki kompani që të ka kry punë nuk e ke pagu sivjet, nuk e kam bërë një pyetje rastësisht në dhjetor të vitit 2023. 27 dhjetor në seancë a keni obligime të kryera të vitit që po e lamë, keni thanë 00, kur na kanë ardh pasqyrat financiare kanë dalë. Tash po na dalin dhe me përmbarues dhe tash po na dalin që edhe në teren njerëzit që kanë kry punë rreth 400 mijë euro nuk janë pagu. Veç 1 muaj mos mu pagu, ti e dinë që përqindja shkon afër 20% ose duhet me pagu përmbaruesi ose gjykata, dhe kjo është njëfar ujdje tani mes komunës dhe operatorëve, se ndryshe sun nxjerrin disa operator, se kanë punu më shumë se që fitojnë. Edhe këtë variant e bajnë dhe e dinë. Te Njësia e Auditimit të Brendshëm, zyrtari ka shku në pension. Është e vërtetë, 1 vit ka kalu që ka shku në pension, 1 vit e kanë lanë vendin bosh tu ja ruajt dikujt. Me siguri nuk ka tjetër spjegim kjo. I ke pas të parapame me i kry 4 auditime me planifikim, i ka kry, veç 2 edhe atë dytin e dimë si e ka kry, se kur kemi shku në KPF i ka thënë biri do letra dhe i ka pru, se as i dyti nuk u kanë i krym nëse nuk është kështu, këta anëtarët e KPF-së i dinë muhabetet që janë bërë aty dhe si e kanë pru zyrtarin me i pru do letra, e veç një e ka kry, e kur nuk i kryen punët normal që të dalin telashet, se jemi tu folë për miliona të humbura investime kapitale për qytetarët tanë, për shkak prej shkeljes së ligjit pagum prej një kodit tjerë merr kryetari. P.sh.: sotë në Viti i ke 4-5 rrugë që janë bërë 2 kahje pa vendim të kuvendit komunal. Edhe ajo është shkelje, dhe a e dinë pse nuk bëhet ajo, se nuk funksionon tani komplet plani i menaxhimit të rrugëve, se jo që nuk e binë për diçka këta, se e bajnë, ama duhet me pas planin e menaxhimit të rrugëve dhe funksionimit të infrastrukturës së qytetit brenda. Leje që nuk kompletohet inxhinierikisht krejtë këto sene që po bëhen, që po flasin për 400 mijë euroshin kan me ju dalë. Unë e kam dhe një listë këtu. Kjo ka me qenë e gjetur e auditorit dhe 26 projekteve për 7 vjetë me tu bërë pa u kry 145 mijë euro i ke. Kontraten që i thashë kryetari nuk mu përgjigj, është 3 milion e 100 mijë euro, përfundon në 2025. Tash a ka me u pagu krejt në 2025 a qysh e ke bërë me u ditë se, ne po himi në obligime plus afër 1 milion euro i ke borgji sivjet punime që nuk ke pare me i kry, e ky borgji nëse nuk i ke të planifikume dhe të llogaritura me mundësitë buxhetore që të ndan, që nuk po mund me ti siguru sa po hymë borgji.

**z.Nexhat Halili:** Te çështja b1, klasifikimi adekuat i shpenzimeve te kategorit ekonomike, këtu te çështja e vendimeve gjyqësore. Berat, një pyetje e kam, në kuadër të kësaj janë marrë 253 mijë e 717 euro prej investimeve kapitale, se ka edhe prej subvencioneve dhe këtë të subvencioneve nuk po muj me kuptu pse me i marrë parat, unë. Du me të pyet te investimet kapitale. Këto mjete që tu kanë marrë 253 mijë euro në free balanc, si i regjistron? A i regjistron si shpenzim apo si investim kapital? Se në këtë rast nuk është investim kapital, se tu ka marrë parja.

**z.Berat Zuka, zyrtar i financave:** Në free balanc e regjistron deperatamenti i thesarit. Këto veç i shohim që i kanë marr. Thesari e ka të drejten e vetëvetes me ti marrë. E ke pas fakturen në prag të shpenzimit tu e bërë, ai ti ka marrë mjetet ti ka qitë, ai ta lenë pagesën dhe të cilit përmbarues e ka edhe emrin ja shkruan. E dinë ti Nexhat

one nese benë marrëveshje me thesarin s'vjet për herë të parë drejtoreshën e kanë ndëgju, na e kanë kthyer disa kapitale, ne i regjistrujmë te kapitale, mirëpo i regjistrujmë. Me vendime gjyqësore i ke.

**z.Nexhat Halli:** Te fakturat thave, te fakturat nuk ti binë operatorët ekonomik. Së pari nxjerrret urdhër blerja, pastaj bëhet porosia e mallit. Atëhere operatori ekonomik e bjenë mallin dhe fakturen. Ju me siguri nuk keni nxjerrë urdhër blerjen, se nuk keni pas mjete dhe për atë arsye jo 30 po shkojnë më shumë ditë.

| 11 | Asfaltimi i rrugës lagja Ilulleci-Ramjan Lagja Rexhepi               | COMPANY ZLKA COMMERC SH.P.K | 40,000.00           |                     |                     |            | 40,000.00  |
| 12 | Rivitalizimi i rrugës Hoxhe Januzi dhe Muhamet Muharremi në Viti     | COMPANYA ESKAVATORI         | 11,550.50           |                     |                     | 37,374.50  | 48,925.00  |
| 13 | Rregullimi i rrënojave të shkollave "Dafni Haxhar" dhe "Hail Aldema" | DAUTI CO SHPK               |                     |                     | 5,000.00            |            | 5,000.00   |
| 14 | Renovimi i ambulancës në Viti  | ELEKTROSTUBLA SHPK          | 4,312.65            |                     |                     |            | 4,312.65   |
| 15 | Renovimi i ambulancës në Viti  | ENGINEERING RK SH.P.K.      | 62,298.00           |                     |                     |            | 62,298.00  |
| 16 | Participimi për rregullimin e objektit të zjarrefiksive në Viti      | ENGINEERING RK SH.P.K.      | 29,786.57           |                     |                     |            | 29,786.57  |
| 17 | Ndërtimi i sheshit në Vitise   | ENGINEERING RK SH.P.K.      | 18,547.80           | 15,000.00           |                     | 116,667.50 | 150,215.30 |
| 18 | Rregullimi i fushave sportive  | EURO COMMERC OP             | 189,999.70          | 70,000.00           |                     |            | 259,999.70 |

|    |   |                            |              |            |            |            |  |                |
|----|---|----------------------------|--------------|------------|------------|------------|--|----------------|
| 19 | Riparime neper shkolla  | EURO<br>COMMERC OP         | 99,999.66    | 10,000.00  |            |            |  | 109,999.65     |
| 20 | Ndertimi i palestrave sportive shkollore (kuvendit i Lezhes -Viti dhe shkolles fillore Sllatin E Eperme | EURO<br>COMMERC OP         | 40,000.00    | 20,000.00  |            |            |  | 60,000.00      |
| 21 | Hartimi i Projekteve  | FLORENT EMINI<br>BI        | 215,384.61   |            |            |            |  | 215,384.61     |
| 22 | Ndertimi i palestrave sportive shkollore (kuvendit i Lezhes -Viti dhe shkolles fillore Sllatin E Eperme | NIKA PRO ING<br>SHPK       | 40,000.00    |            |            |            |  | 40,000.00      |
| 23 | Asfaltimi nuges Terpez - Novoselle- Lagja AIdema  | PRO CO GROUP<br>SHPK       | 79,999.60    |            |            |            |  | 79,999.60      |
| 24 | Asfaltimi i nuges Goshice-Sedovin e Jertive   | PRO CO GROUP<br>SHPK       | 40,000.00    |            |            |            |  | 40,000.00      |
| 25 | Asfaltimi i nuges Sllatin e Eperme - Prozheran lagja Korant   | PRO CO GROUP<br>SHPK       | 38,023.32    |            |            |            |  | 38,023.32      |
| 26 | Asfaltimi nuges Gjepekjar toplan -Remnik  | PRO CO GROUP<br>SHPK       | 80,000.00    |            |            |            |  | 80,000.00      |
| 27 | Asfaltimi i nuges Kolshle-Buzovk-Begunce  | PRO CO GROUP<br>SHPK       | 79,999.99    |            |            |            |  | 79,999.99      |
| 28 | Ndertimi i Rruges Me zhavor Ramjan -Sllakovc  | PRO CO GROUP<br>SHPK       | 116,681.07   | 20,000.00  |            |            |  | 136,681.07     |
| 29 | Asfaltimi i nugeve Rumble   | PRO CO GROUP<br>SHPK       | 267,161.79   | 38,180.80  |            |            |  | 295,342.59     |
| 30 | Ndertimi i nugeve me zhavor   | PRO CO GROUP<br>SHPK       | 343,376.16   | 30,000.00  |            |            |  | 373,376.16     |
| 31 | Ndertimi i trullaret dhe ndriqimi publik  | PRO CO GROUP<br>SHPK       | 30,897.82    |            |            |            |  | 30,897.82      |
| 32 | Ndertimi i aneksit te shkolles fillore ne fshatin Ramnishte   | REI COMPANY<br>SHPK        | 30,000.00    |            |            |            |  | 30,000.00      |
| 33 | Ndertimi i rruges me zhavor remniku i ri (pompa)-Sedovin e Cerkezve Sllatine Poshtme                    | VIZIONI BD<br>SHPK         | 50,000.00    |            |            |            |  | 50,000.00      |
| 34 | ndertimi i kanaleve dhe proclave  | VIZIONI BD<br>SHPK         | 20,000.00    | 20,000.00  |            |            |  | 40,000.00      |
| 35 | Vendime Gjyqesore (Kontrata Kolektive)  | P.P.SHEREMET<br>H.LIVOREKA | 1,651.84     |            |            |            |  | 1,651.84       |
| 36 | Vendime Gjyqesore (Kontrata Kolektive)  | ZYRA Z.PERMB.<br>PARTNERS  | 46,564.58    |            |            |            |  | 46,564.58      |
| 37 | Vendime Gjyqesore (Kontrata Kolektive)  | MISINI LAW<br>S.H.P.K.     | 140,000.00   | 34,170.42  |            |            |  | 174,170.42     |
| 38 | Vendime Gjyqesore   | MISINI LAW<br>S.H.P.K.     | 17,024.95    | 102,000.00 |            |            |  | 119,024.95     |
|    | <b>Gjithesej</b>  |                            | 2,475,260.93 | 380,598.40 | 109,313.96 | 184,042.00 |  | 3,149,216.29 € |

**Prezentimi i investimeve sipas burimeve të financimit per periudhen janar - Shtator 2024**

|                                |                       |                |
|--------------------------------|-----------------------|----------------|
| 1 Grandi qeveritar             | 2,475,260.93          | 78.60%         |
| 2 Të hyrat vetanake            | 380,598.40            | 12.09%         |
| 3 Të hyrat vetanake te bartura | 109,313.96            | 3.47%          |
| 4 Participim dhe donacionet    | 184,042.00            | 5.84%          |
| <b>Gjithesejt</b>              | <b>3,149,215.29 €</b> | <b>100.00%</b> |

**Paraqitja grafike e investimeve sipas burimeve të financimit per periudhen janar - Shtator 2024**




- Grandi qeveritar
- Të hyrat vetanake
- Të hyrat vetanake te bartura
- Participim dhe donacionet

## Shpenzimi i buxhetit sipas kategorive ekonomike per periudhen janar - shtator 2024

|   | Kategorit Ekonomike | Alokimet e buxhetit    | Shpenzimet             | % Shpenzimit  |
|---|---------------------|------------------------|------------------------|---------------|
| 1 | Pagat dhe meditje   | 8,867,249.09           | 9,257,624.13           | 104.52%       |
| 2 | Mallra dhe Sherbime | 2,617,995.56           | 2,374,817.74           | 90.71%        |
| 3 | Komunali            | 238,000.00             | 207,566.76             | 87.21%        |
| 4 | Subvencione         | 583,798.83             | 416,182.33             | 71.29%        |
| 5 | Kapitale            | 3,706,806.09           | 3,149,215.29           | 84.96%        |
|   | <b>Gjithesejt</b>   | <b>16,013,849.57 €</b> | <b>15,415,406.25 €</b> | <b>96.26%</b> |

## Paraqitja grafike e shpenzimeve sipas kategorive Ekonomike për periudhën janar - Shtator 2024



### Krahasimi i Shpenzimeve në vitin 2024 me të njëjtën periudh të vitit 2023

| Kodi Ekonomik | Përshkrimi  | Shpenzimet e vitit 2023 | Shpenzimet e vitit 2024 | Diferenca           |
|---------------|---|-------------------------|-------------------------|---------------------|
| 11111         | Paga neto   | 5,493,704.07            | 5,106,974.19            | -386,729.88         |
| 11121         | Talimi ne te ardhura personale                            | 359,505.74              | 360,769.64              | 1,263.90            |
| 11131         | Kontributi pensional-punelort                             | 308,337.22              | 305,114.50              | -3,222.72           |
| 11151         | Pagesa per sindikat                                       | 13,641.13               | 16,590.89               | 2,949.76            |
| 11152         | Odat Profesionale   | 3,840.61                | 4,949.55                | 1,100.94            |
| 11211         | Pervoja e punes   | 0.00                    | 254,951.55              | 254,951.55          |
| 11311         | Kontributi pensional-punedhensesit                        | 308,337.22              | 305,309.50              | -3,027.72           |
| 11411         | Shesat e veçanta per te zgjedhurit                        | 0.00                    | 20,838.58               | 20,838.58           |
| 11418         | Shesat par rrupunesit e sistemit shëndetësor              | 0.00                    | 5,540.26                | 5,540.26            |
| 11431         | Kujdesiaa.puna gjate nates dhe puna jashte orant te punes | 0.00                    | 42,624.45               | 42,624.45           |
| 11611         | Shesat tranzitore   | 0.00                    | 4,033.18                | 4,033.18            |
| 11900         | Pagesa per vendime gjycesore                              | 326,098.94              | 2,839,927.84            | 2,513,828.90        |
|               | <b>Totali i pagave</b>                                    | <b>6,813,472.93</b>     | <b>9,267,624.13</b>     | <b>2,454,151.20</b> |
| 13130         | Transporti per udhetime zyrtare brenda vendit             | 13,371.73               | 16,851.30               | 3,479.57            |
| 13132         | Akomodimi per udhetime zyrtare brenda vendit              | 2,512.00                | 1,962.00                | -550.00             |
| 13140         | Transporti per udhetime zyrtare jashte vendit             | 10,421.52               | 6,056.28                | -4,365.24           |
| 13141         | Para xhapi medfje per udhetime zyrtare jashte vendit      | 546.00                  | 1,511.40                | 965.40              |
| 13142         | Akomodimi per udhetime zyrtare jashte vendit              | 0.00                    | 778.50                  | 778.50              |
| 13143         | Shpenzime e tjera per udhetime zyrtare jashte vendit      | 330.00                  | 454.83                  | 104.83              |
| 13210         | Energjia Elektrike  | 132,895.28              | 162,694.52              | 29,799.24           |
| 13220         | Sherbimet e ujeshjellit dhe kanalizimit                   | 13,808.65               | 9,220.80                | -4,587.85           |
| 13230         | Mbeturinat  | 26,932.01               | 26,934.55               | 2,002.54            |
| 13250         | Telefonia Fikse   | 7,735.48                | 6,746.89                | -988.59             |
| 13310         | Interneti   | 3,630.67                | 3,744.00                | 213.33              |
| 13320         | Telefonia Mobile  | 13,916.73               | 15,981.42               | 2,064.69            |
| 13340         | Shpenzimet per perdorimit te kabllit optik                | 400.00                  | 0.00                    | -400.00             |
| 13410         | Sherbimet e aresimit dhe trajnimit                        | 6,320.00                | 0.00                    | -6,320.00           |
| 13420         | Sherbimet e perfaqesimit avokature                        | 12,352.66               | 0.00                    | -12,352.66          |
| 13430         | Sherbime te ndryshme shëndetësore                         | 350,865.40              | 369,632.69              | 18,747.29           |
| 13440         | Sherbimet keshilledhëse dhe profesionale                  | 23,438.75               | 118,927.50              | 95,488.75           |
| 13445         | Sherbimet e veçanta-konsulente dhe kontraktor individual  | 0.00                    | 37,862.67               | 37,862.67           |
| 13450         | sherbimet shtypje / printimit                             | 36,180.67               | 24,292.56               | -11,888.11          |
| 13460         | Sherbime kontraktuese tjera                               | 144,325.75              | 67,264.56               | -77,061.19          |
| 13470         | Sherbime teknike  | 13,968.60               | 11,420.24               | -2,548.36           |
| 13480         | Shpenzimet e anelaresimit                                 | 6,500.00                | 8,548.05                | 2,048.05            |
| 13501         | Mobije  | 0.00                    | 92,389.00               | 92,389.00           |
| 13503         | Kompjuterel   | 64,278.40               | 10,024.00               | -54,254.40          |
| 13504         | Pasje tjera te teknologjis informative dhe te komunikimit | 0.00                    | 9,411.80                | 9,411.80            |
| 13508         | Pasje trafiku   | 9,085.10                | 0.00                    | -9,085.10           |
| 13509         | Pasje tjera   | 219,498.25              | 337,381.04              | 117,882.79          |

|       |   |                      |                      |                      |                     |
|-------|---|----------------------|----------------------|----------------------|---------------------|
| 13510 | Blerja e librave dhe veprave artistike                    | 0.00                 | 20,660.50            | 20,660.50            | 20,660.50           |
| 13511 | Pajisjet sportive   | 0.00                 | 2,721.00             | 2,721.00             | 2,721.00            |
| 13610 | Furnizime per zyre  | 41,716.80            | 49,330.65            | 49,330.65            | 7,613.85            |
| 13611 | Furnizimi me dokumenta bilanko                            | 4,081.80             | 4,097.49             | 4,097.49             | 15.69               |
| 13620 | Furnizim me ushqim dhe pije                               | 27,736.12            | 23,444.01            | 23,444.01            | -4,292.11           |
| 13630 | Furnizimi mjekesore                                       | 73,443.74            | 115,648.70           | 115,648.70           | 42,204.96           |
| 13640 | Furnizime pastirimi                                       | 16,158.30            | 24,472.18            | 24,472.18            | 8,313.88            |
| 13650 | Furnizimi me veshembathje                                 | 1,575.00             | 1,997.00             | 1,997.00             | 422.00              |
| 13720 | Nafte per ngrohje qendrore                                | 6,723.69             | 15,925.44            | 15,925.44            | 9,201.75            |
| 13760 | Drute dhe prodhimet e drurit per ngrohje                  | 166,115.00           | 175,447.50           | 175,447.50           | 9,332.50            |
| 13770 | Derivate per xhenerator                                   | 2,807.83             | 0.00                 | 0.00                 | -2,807.83           |
| 13780 | Derivatet per automjete, gjenerator dhe makineri          | 43,823.00            | 41,296.33            | 41,296.33            | -2,526.67           |
| 13850 | Regjistrimi i automjeteve                                 | 4,025.00             | 2,220.00             | 2,220.00             | -1,805.00           |
| 13951 | Sigurimi i automjeteve                                    | 7,962.34             | 6,286.17             | 6,286.17             | -1,674.17           |
| 13953 | Sigurimi i ndertesave dhe te tjera                        | 0.00                 | 2,772.00             | 2,772.00             | 2,772.00            |
| 13954 | Kontrollimi teknik i automjeteve                          | 0.00                 | 650.00               | 650.00               | 650.00              |
| 14010 | Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve                    | 29,978.00            | 31,571.00            | 31,571.00            | 1,593.00            |
| 14022 | Mirembajtja e ndertesave administrative dhe afariste      | 161,151.32           | 246,382.74           | 246,382.74           | 85,231.42           |
| 14023 | Mirembajtja e ndertesave arsimore                         | 0.00                 | 180.96               | 180.96               | 180.96              |
| 14032 | Mirembajtja e rrugeve lokale                              | 153,949.19           | 258,205.48           | 258,205.48           | 104,256.29          |
| 14040 | Mirembajtja e teknologjise informatike dhe te komunikimit | 3,451.00             | 6,547.70             | 6,547.70             | 3,096.70            |
| 14050 | Mirembajtja e mobiljeve dhe paisjeve                      | 37,899.02            | 24,298.10            | 24,298.10            | -13,600.92          |
| 14080 | Mirembajtja rutinore                                      | 13,070.00            | 30,170.00            | 30,170.00            | 17,100.00           |
| 14220 | Botimet e publikimit                                      | 6,450.00             | 3,760.00             | 3,760.00             | -2,690.00           |
| 14230 | Shpenzimet per informim publik                            | 22,494.22            | 22,303.55            | 22,303.55            | -190.67             |
| 14310 | Kompensimi i perfaqesimit brenda vendit                   | 36,750.80            | 35,617.60            | 35,617.60            | -1,133.20           |
| 14410 | Vendimet gjyqesore  | 28,145.39            | 94,115.80            | 94,115.80            | 64,970.41           |
|       | <b>Totali per sherbime malira dhe komunali</b>            | <b>2,003,759.21</b>  | <b>2,582,384.50</b>  | <b>2,582,384.50</b>  | <b>578,625.29</b>   |
| 22200 | Subvencione dhe transfera                                 | 424,837.80           | 412,969.81           | 412,969.81           | -11,867.99          |
| 22300 | Vendime gjyqesore   | 0.00                 | 3,212.52             | 3,212.52             | 3,212.52            |
|       | <b>Totali i subvencioneve</b>                             | <b>424,837.80</b>    | <b>416,182.33</b>    | <b>416,182.33</b>    | <b>-8,655.47</b>    |
| 31000 | Investime Kapitale  | 1,774,524.67         | 2,807,803.50         | 2,807,803.50         | 1,033,278.83        |
| 34000 | Pagesa spas vendimeve gjyqesore                           |                      | 341,411.79           | 341,411.79           | 341,411.79          |
|       | <b>Totali i investimeve kapitale</b>                      | <b>1,774,524.67</b>  | <b>3,149,215.29</b>  | <b>3,149,215.29</b>  | <b>1,374,690.62</b> |
|       | <b>Gjithesej shpenzimet</b>                               | <b>11,016,594.61</b> | <b>15,415,406.25</b> | <b>15,415,406.25</b> | <b>4,398,811.64</b> |

Komentet:

Shpenzimet ne vitin 2024 ne total jane 15,415,406.25€, Ndërsa Shpenzimet ne vitin 2023 kane qene 11,016,594.61€  
Shpenzimet ne vitin 2024 jane me te larta ne total per 4,398,811.64€ ne krahasim me te njeften periudh te vitit 2023  
Ne shpenzime jane perfishi pagat dhe medfjet, sherbime malira dhe shpenzimet komunale, subvencione dhe investime kapitale  
Shpenzimet per Paga dhe medfjet te vitit 2024 jane me te larta per 2,454,151,20€ ne krahasim me vitin 2023  
Shpenzimet per sherbime malira dhe komunali te vitit 2024 jane me te larta per 578,625,29€ ne krahasim me shpenzimet e vitit 2023  
Shpenzimet per subvencione dhe transfera te vitit 2024 jane me te vogla per 8,655,47€ ne krahasim me shpenzimet e vitit 2023  
Shpenzimet per Investime kapitale te vitit 2024 jane me te larta per 1,374,690,62€ ne krahasim me shpenzimet e vitit 2023,



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA  
DREJTORIA PËR KADASTËR, PRONË DHE GJEODEZI



Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale me nr. 03/L-40 dhe neni 24 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënjen në shfrytëzim dhe kembim të pronës së palujtshme Komunale, neni 29 paragrafi 5 i Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për caktimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzim dhe kembim të pronës së palujtshme të Komunës dhe neni 50 pika I, e Statutit të komunës-së Vitisë, Kryetari i Komunës së Vitisë përmes Drejtorisë për Kadaster Pronë dhe Gjeodezi e komunes së Vitisë, me datën 11.10.2024, propozon këtë :

**PROPOZIM – VENDIM**  
PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHMË PUBLIK



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

|   |                        |                        |                     |
|---|------------------------|------------------------|---------------------|
| Planimar: Pronësi i M. Liana 11-10-2024 |                        |                        |                     |
| Nr. i Kartës së Gjeodezisë              | Nr. i Kartës së Pronës | Nr. i Kartës së Pjesës | Mënyra e Vlerësimit |
| 02-                                     | 035/                   | 02-                    | 1185                |

I.

Me këtë propozim vendim, propozohet të bëhet shpallja zonë me interes të përgjithshëm publik për palujtshmerinë e pronave private në emër të Xhavit Bajrami (Januz) për pjesen prej 47m<sup>2</sup> në ngastrën kadastrale me nr.2635-7, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 400m<sup>2</sup>, pjesa prej 43m<sup>2</sup> në ngastrën kadastrale me nr.2635-34, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 434m<sup>2</sup> dhe pjesen prej 38m<sup>2</sup> në ngastrën kadastrale me nr.2635-35, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 435m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur " Selo Stanben Blok III " në zonën kadastrale në Viti, m<sup>2</sup>, për arritjen e qëllimit të ligjshme publik për nevojat e banorëve të qytetit të Vitisë.

II.

Pas marrjes së këtij Propozim-Vendimit për shpalljen e pronës private si Interes i Ligjshëm Publik, Kryetari i Komunës do të iniciojë procedurat e metutjeshme për kembimin e pronës private me atë publike për arritjen e qëllimit të lartcekur duke zbatuar Ligjit për dhënjen në shfrytëzim dhe kembim të pronës së palujtshme Komunale dhe Rregulloren për caktimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzim dhe kembim të pronës së palujtshme të Komunës.

III.

Për zbatimin e këtij propozim - vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizem, Planifikim dhe Mbrojtjen të Mjedisit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente dhe Drejtoria për Kadaster, Pronë dhe Gjeodezi.

IV.

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Kryetari i Komunës:  
Sokol Halilaj





Republika e Kosovës  
Republica Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mbrojtjes, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Zaštite Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

EKSTRAKT NGA CERTIFIKATA / IZVOD IZ CERTIFIKATA / EXTRACT OF CERTIFICATE

PERSONI / OSOBA / PERSON : BAJRAMI XHAVIT

Numri i Rendes / Broj Predmet / Case Reference Number: 1440/2024  
Data dhe koha e kërimit / Datum i vrene lodavanja / Date and time of submission: 11.10.2024 - 13:27  
Komuna / Opština / Municipality: VITI / VITINA / VITI  
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: VITI / VITINA / VITI

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

| Mbiemri/Emri i afarizant (biznesit)<br>Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa)<br>Last Name / Business Name | Emri<br>Ime<br>First Name | Emri i babait<br>Ime oca<br>Father's Name | Gjinia<br>Pol<br>Gender       | Nr. personal/ biznesit<br>Licen broj/ broj<br>poslovanja<br>ID. No. | Shteti i shtetësisë apo<br>regjistrimit/ Drzava<br>državljanstva ili uknjiženja<br>Country of citizenship | Ditëlindja/ Data e<br>themelimit<br>Rođenost/ Dan<br>osnivanja<br>Date of<br>Birth/ Establishment | Krijuar më datën<br>Urdjeno na dan<br>Created On | Azhuroar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---------------------------|---|-------------------------------|---|---|---|--|----------------------------------|
| BAJRAMI   | XHAVIT                    | JANUZ                                     | Mashkull /<br>Musko /<br>Male | KCID0115119   | KOSOVA /<br>KOSOVA /<br>KOSOVO  |   |  |                                  |

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

| Vendbanimi<br>Prehiraqiste<br>Resident | Kodi Postel<br>Postanski Kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojednostni adres<br>Address Details | Adresa tjetër<br>Druga adresa<br>Address | Azhuroar<br>Ažurirano<br>Updated |
|--|---|---|--|----------------------------------|
| VERBAN /<br>VERBAN /<br>VERBAN         |   |   |  |                                  |



M. Xhavit

B. NJESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

| Njesia kadastrale<br>Katastarska jedinica<br>Cadastral unit | Komuna /<br>Opština /<br>Municipality | Zona<br>kadastrale<br>Katastarska<br>zona<br>Cadastral zone | Lloji i shtetë<br>Vrysa jedinite<br>Unit type | Tipi i pronës<br>Tipi imovine<br>Property Type                      | Katë/<br>Katet<br>Br./Sprat<br>n/<br>Spratova<br>Floor<br>number | Vendi i kuajtuar<br>Zemra meste<br>Place name   | Superfaqja<br>Površina<br>Area | Shtufrezimi<br>aktual/Kultur-<br>klasa Aktualna<br>opretnika/<br>Kultura-klasa<br>Aktual<br>use/Culture-class   | Pjesa e pronës<br>Dio imovine<br>Share quota | Lloji i së drejtës<br>Vrysa prava<br>Type of the right                   | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---------------------------------------|---|---|---|--|---|--------------------------------|---|--|--|----------------------------------|
| P-70101007-02635-1  | VITI /<br>VITINA /<br>VITI            | Viti /<br>Vitina /<br>Viti                                  | PARCELE /<br>PARCELA /<br>parcel              | Pronë private<br>Privatna Imovina<br>Privately owned<br>Land<br>/ R |  | SELO STANBENI<br>BLOK III /<br>SELO STANBENI<br>BLOK III /<br>SELO STANBENI<br>BLOK III | 400                            | Tokë Ndërrimore -<br>Shtepi-Ndërrimor - /<br>Tokë Ndërrimore -<br>Obor - / /<br>Gradëvinsko<br>zemljište - Kucha-<br>Zgrada - /<br>Gradëvinsko<br>zemljište - Dvonište<br>- / / /<br>Construction land -<br>House-Building - /<br>Construction land -<br>BackYard - / /   | 1 / 1  | Pesëtim<br>individual<br>/ Individualin<br>Drzavna<br>/ Single possessor | 20.09.2021                       |
| P-70101007-02635-34   | VITI /<br>VITINA /<br>VITI            | Viti /<br>Vitina /<br>Viti                                  | PARCELE /<br>PARCELA /<br>parcel              | Pronë private<br>Privatna Imovina<br>Privately owned<br>Land<br>/ R |  | SELO STANBENI<br>BLOK /<br>SELO STANBENI<br>BLOK /<br>SELO STANBENI<br>BLOK             | 434                            | Bujësi -<br>Kullorai - Kullorë<br>E Klases 3 / Tokë<br>Ndërrimore -<br>Shtepi-Ndërrimor - /<br>Tokë Ndërrimore -<br>Obor - / /<br>Poljovetredim -<br>Pashajci - Pashajci<br>3 Klase /<br>Gradëvinsko<br>zemljište - Kucha-<br>Zgrada - /<br>Gradëvinsko<br>zemljište - Dvonište<br>- / / /<br>Agriculture -<br>pasture - 3rd Class<br>Pasture /<br>Construction land -<br>House-Building - /<br>Construction land -<br>BackYard - / / | 1 / 1  | Pesëtim<br>individual<br>/ Individualin<br>Drzavna<br>/ Single possessor | 20.09.2021                       |







Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit/ Ministrastvo Infrastrukture i Sredine/ Ministry of Infrastructure and Environment  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: VITI

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice : 2635-33

Zona kadastrale / Katastarska zona: VITI

Numri i lëndës / Broj predmeta: \_\_\_\_\_


Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarska jedinice : Parcel

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana : 1: 500

Propozim për ndarje dhe këmbim të pronës private dhe publike

| Nr. | Y           | X           | H       |
|-----|-------------|-------------|---------|
| P1  | 7529809.852 | 4686989.228 | 542.524 |
| P2  | 7529851.103 | 4686993.041 | 542.512 |
| P3  | 7529813.594 | 4686957.889 | 542.576 |
| P4  | 7529827.163 | 4686959.125 | 542.836 |
| P5  | 7529840.764 | 4686960.365 | 542.512 |
| P6  | 7529854.332 | 4686961.601 | 542.610 |

2635-33  
2635-(i ri)  
Sip.=12419 m<sup>2</sup>



Rilevoni / Snimio: Festim Islami  
(nëse dhe mblerat i gjendës/konkuzisë/ ose i pozitës geodet/ kadastrale)

Aprovoni / Usvojio: \_\_\_\_\_  
(nëse dhe mblerat i përbërës zytar/ ose i pozitës shërbëtor/ list)

Nr. i licencës / Br. licencac: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi / Potpis: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi / Potpis: \_\_\_\_\_

Data e aprovimit / Datum usvajanja: \_\_\_\_\_





REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA



|  |                   |                      |                   |
|--|-------------------|----------------------|-------------------|
| Protokoll i Komisionit Nr. Dama 22-10-2024 |                   |                      |                   |
| Nr. i Komisionit<br>Dama                   | Nr. i Protokollit | Udhëzuesi<br>Prijeti | Vlera<br>Vendoset |
| 10-052                                     | 101-              | 1221                 |                   |

Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality Viti

|                               |  |
|-------------------------------|--|
| <b>Datë</b>                   | 21.10.2024   |
| <b>REFERENCË</b>              |  |
| <b>PËR/ZA/TO:</b>             | Kuvendi Komunal të Vitisë  |
| <b>Përmes/OD/FROM:</b>        | Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural                                |
| <b>Nga:</b>                   | Komisioni komunal për vlersimin e dëmeve nga fatkeqësit natyrore dhe dëmet tjera |
| <b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b> | Raport i vlersimit për dëmet e shkaktuara në bujqësi                             |



Në bazë të vendimit me nr. Protokoli 02-035/02-1198 të dates 17.10.2024 nga Kryetari i Komunës për vlersimin e dëmeve nga fatkeqësit natyrore dhe dëmet tjera Komisioni ka hartuar:

## Raport

Pas reshjeve të breshërit të muajit qershor korrik ,gushtë dhe erëra të forta të muajit shtator, në kulturat bujqësore dhe serra janë shkaktuar dëme të konsiderushme. Ne si drejtori kemi pranuar 33 kërkesa nga fermerët, nga të cilat 7(shtatë) kërkesa janë refuzuar,4(katër) kërkesa janë për policinë dhe 1 (një) kërkesë është ceduar. Si komision kemi dalur tek këta fermerë në parcelat e tyre të dëmtuara për të pare gjendjen faktike dhe kemi marrë foto në vendin e ngjarjes, Komisioni ka bërë vlersimin për kulturat e dëmtuara dhe 21 kërkesa janë shqyrtuar pozitivishtë Rendimenti dhe çmimi për secilën kulturë është përcaktuar nga MBPZHR,kurse ne kemi përcaktuar vetë përqindjen (%) e dëmit. Për secilin fermer janë bërë raportet individuale finaciare dhe proqesverbali. Vlera e përgjithshme e demit është **31113.43€** Kerkojm nga Kuvendi Komunal i Vitise qe ne seancen e radhës të miraton raportin me listën e vlersimit te dëmeve

Komisioni Komunal për vlersimin e dëmeve;

- 1.Sami Demelezi- Kryetar i komisionit
- 2.Xhelal Musa - anëtar,
- 3.Avni Misini - anëtar,
- 4.Fitim Selmani - anëtar,
- 5.Arta Muharremi - anëtar.

  
-----  
  
-----  
  
-----  
  
-----  
  
-----



|                     |                 |               |      |            |         |          |         |       |        |          |      |         |      |                 |         |
|---------------------|-----------------|---------------|------|------------|---------|----------|---------|-------|--------|----------|------|---------|------|-----------------|---------|
| 18                  | Xhelal Halabaku | Pozhoran      | Viti | 1012475272 | Korrik  | Breshëri | Miser   | 10    | 4290   | 42900.00 | 20%  | 8580.00 | 0.24 | 2059.20         | 6972.90 |
|                     |                 |               |      |            |         |          | Kungul  | 0.5   | 8550   | 4275.00  | 20%  | 855.00  | 0.16 | 136.80          |         |
|                     |                 |               |      |            |         |          | Mollë   | 3     | 12120  | 36360.00 | 20%  | 7272.00 | 0.44 | 3199.68         |         |
|                     |                 |               |      |            |         |          | Kumbull | 1     | 5090   | 5090.00  | 20%  | 1018.00 | 0.81 | 824.58          |         |
| 19                  | Arbnora Pira    | Pozhoran      | Viti | 2013217427 | Korrik  | Breshëri | Pjeper  | 0.3   | 12800  | 3840.00  | 35%  | 1344.00 | 0.56 | 752.64          | 2285.94 |
|                     |                 |               |      |            |         |          | Fasule  | 2.61  | 1840   | 4802.40  | 20%  | 960.48  | 2.38 | 2285.94         |         |
| 20                  | Nazmi Pira      | Pozhoran      | Viti | 1172639590 | Korrik  | Breshëri | Miser   | 1.78  | 4290   | 7636.20  | 20%  | 1527.24 | 0.24 | 366.54          | 3756.04 |
|                     |                 |               |      |            |         |          | Fasule  | 3.87  | 1840   | 7120.80  | 20%  | 1424.16 | 2.38 | 3389.50         |         |
| 21                  | Alie Qosaj      | Silatine e Ep | Viti | 1006068738 | Shtator | Era      | Foll    | 0.060 | 190.15 |          | 100% | 190.15  | 5.30 | 1007.80         |         |
| <b>Vlera totale</b> |                 |               |      |            |         |          |         |       |        |          |      |         |      | <b>31113.43</b> |         |

Drejtori i Buqësisë  
Naim Pira



Kryetari i Komunës  
Sokol Halli





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranimi - Pranimi (Dated): 15-10-2024

| No. i origjorit<br>(Orig. No.) | Pranimi (No.) | Shtetësi<br>(Citizenship) | Mirësi<br>(Residence) |
|--------------------------------|---------------|---------------------------|-----------------------|
| 02-                            | 035/02-       | 02-                       | 1192                  |



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republik of Kosova

Komuna e Vitisë

Opština Vitina

Municipality of Vitina

**DRAFT**  
**KODI I ETIKËS**  
**PËR**  
**ZYRTARËT E KOMUNËS SË VITISË**

**Shtator, 2024**

Në bazë të nenit 58, shkronja h) e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 50.1, shkronja l) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, si dhe Ligjit për Zyrtarë Publik Nr.08/L-197, Kryetari i Komunës së Vitisë, propozon:

## **DRAFT**

# **KODIN E ETIKËS PËR ZYRTARËT E KOMUNËS SË VITISË**

## **KREU I**

### **DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME**

#### **Neni 1 Qëllimi**

Ky Kod ka për qëllim të përcaktojë rregullat e sjelljes për zyrtarët e komunës sipas rregullave dhe standardeve të vendosura në përputhje me frymën e etikës profesionale dhe morale të komunës. Ky Kod synon zhvillimin e kulturës organizative të punës brenda institucionit për të forcuar dhe promovuar parimet bazë që do të zbatohen nga zyrtarët e komunës.

#### **Nëni 2 Fushëveprimtaria**

Dispozitat e Kodit të Etikës zbatohen për të gjithë zyrtarët e komunës gjatë ushtrimit të funksioneve, detyrave ose kompetencave publike në bazë të legjislacionit në fuqi.

2.1 Kodi zbatohet për zyrtarët e komunës, të cilët përcaktohen për qëllime të këtij Kodi, sin ë vijim:

2.1.1 Nëpunësit e shërbimit civil

2.1.2 Nëpunësit e shërbimit publik

2.1.3 Nëpunësit e kabinetit

2.1.4 Nëpunësit administrativ dhe mbështetës, siç përcaktohet në nenin 2, të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik

Zyrtarët e emëruar nga zyrtarët e zgjedhur, duke përfshirë stafin e emëruar të sekretarisë së Kuvendit të Komunës dhe stafin e emruar nga Kryetari i Komunës, si përcaktohet me Ligjin Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008 dhe me Udhëzimin Administrativ të MAPL Nr. 01/2018 për caktimin e stafit mbështetës në komuna.

### **Neni 3 Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë Kod kanë këto kuptime:
  - 1.1 Zyrtari publik – është çdo zyrtar i zgjedhur për Kryetar të Komunës, anëtarë i Kuvendit të Komunës, drejtor i drejtorive dhe stafi mbështetës i tyre
  - 1.2 Zyrtari publik – përfshinë zyrtarët siç përcaktohet në paragrafin 1 i nenit 5 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik
  - 1.3 Interes publik – interesi material ose jomaterial i ligjshëm dhe i drejtë në dobi të qytetarëve
  - 1.4 Interesi privat i personit zyrtar – nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij/saj, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste
  - 1.5 Person i afërm me zyrtarin – është bashkëshorti/bashkëshortja ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik, i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin.
  - 1.6 Autoritet përgjegjës – për parandalimin e konfliktit të interesit të institucioneve janë: udhëheqësit e drejtëpërdrejtë të zyrtarëve sipas hierarkisë brenda një institucioni, institucionet dhe autoritetet udhëheqëse sipas ligjit, apo personat të cilëve iu është besuar kompetenca për të shqyrtuar rastet e konfliktit të interesit në institucionin përkatës.
  - 1.7 Nepotizëm – përkrahje apo favorizim i faresfisit, i miqëve duke e shpërdorur pushtetin
  - 1.8 Vendimmarrje – çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontrats si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes, të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik
  - 1.9 Aktivitetet e jashtme – kuptojmë çdo lloj angazhimi të rregullt ose të kohë pas kohëshme jashtë institucionit me pagesë që bën zyrtari i komunës.

### **Neni 4 Rëndësia e interesit publik ndaj interesit privat**

Zyrtari i komunës duhet të ushtrojë detyrën në përputhje me ligjin, duke udhëhequr nga interes publik dhe jo interes personale, partiake apo private. Ai duhet të shmangë përdorimin e detyrës, për qëllime të cilat nuk kanë bazë ligjore, nuk janë të ndonjë interesi public ose etike.

### **Neni 5 Respektimi i vullnetit zgjedhor të qytetarëve**

Zyrtari politik, duhet të kryejë detyrat në përputhje me mandatin e dhënë nga elektorati dhe të mbrojë interesin e përgjithshëm.

### **Neni 6**

## **Paanshmëria dhe pavarësia**

1. Zyrtari i komunës gjatë ushtrimit të detyrës duhet të jetë i pavarur dhe i paanshëm
2. Zyrtari i komunës duhet të distancohet nga çdo veprim arbitrar që cenon interesin public si dhe nga çdo trajtim preferencial mbi çfarëdo baze.

## **Neni 7**

### **Veshja dhe paraqitja e zyrtarit të komunës**

1. Veshja dhe paraqitja e zyrtarit të komunës duhet të jetë në mënyrën e duhur dhe të përshtatshme, duhet t'i përgjigjet vendit dhe natyrës së punës si dhe të mos dëmtojë reputacionin e institucionit.
2. Veshja e papërshtatshme konsiderohet, sidomos:
  - 2.1 Veshja transparente
  - 2.2 Për meshkujt: pantollonat e shkurtë ose pantollona të tjera që shtrihen mbi kyçin e këmbës kur qëndrojnë në këmbë, bluza/këmisha pa jakë, pa mëngë dhe me ngjyra të pazakonta
  - 2.3 Për femra: bluza/këmisha shumë të hapur përreth qafës, që ekspozon në masë të madhe lëkurën dhe që është pa mëngë, funde ose pantollona të shkurtëra që shtrihen mbi gjunjë kur qëndrojnë në këmbë
  - 2.4 Veshja sportive, mbishkrimi i përmasave të mëdha në veshje, simboli që mund të jetë ofendues në çdo bazë, si dhe mbajtja e kapelës në ambientet e punës.
3. Zyrtarit/es së komunës nuk i lejohet të ketë tatuazhe në pjesë të dukshme të trupit dhe të ketë pjesë të shpuar të trupit përveç veshëve
4. Çdo zyrtar i komunës është i obliguar të bartë në vendin e punës kartelën identifikuese të institucionit që përfaqëson gjatë orarit të punës.

## **Neni 8**

### **Marrëdhëniet me publikun dhe kolegët e punës**

1. Zyrtari i komunës i përgjigjet çdo kërkesë të publikut në lidhje me kryerjen e detyrave të punës, aarsyet për veprimet, ose funksionimin e shërbimeve dhe drejtorive që i nënshtrohen përgjegjësisë, duke respektuar kufizimet në lidhje me dhënien e informacionit sipas ligjit.
2. Zyrtari i komunës në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësisive duhet të veprojë ndaj qytetarëve me mirësjellje, respect dhe pa diskriminim.
3. Zyrtari i komunës në kryerjen e detyrave, duhet të respektojë të drejtat e të gjithë zyrtarëve të tjerë të komunës. Duhet të trajtojë me mirësjellje, respect dhe pa diskriminim publikun, kolegët dhe mediat. Nuk duhet të inkurajojë dhe të ndihmojë zyrtarët e komunës në mos respektimin e parimeve të parashikuara me këtë Kod gjatë ushtrimit të detyrave.
4. Zyrtari i komunës duhet t'i përgjigjet me transparencë dhe vërtetësi çdo kërkesë nga media për informacion lidhur me kryerjen e detyrave, por nuk duhet të ofrojë informacione konfidenciale dhe informata lidhur me të dhënat personale siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi.

**KREU II**  
**PARIMET E SJELLJES SË ZYRTARIT TË KOMUNËS GJATË USHTRIMIT TË**  
**FUNSKINIT ZYRTAR**

**Neni 9**  
**Parimi i ligjshmërisë në punë**

Gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësisë, të gjithë të punësuarit në komunë janë të detyruar të respektojnë Kushtetutën, ligjet dhe aktet e tjera nënligjore.

**Neni 10**  
**Integriteti**

Zyrtari i komunës duhet të veprojë me profesionalizëm dhe paanshmëri për interesin e përgjithshëm të publikut si dhe të forcojë besimin dhe mbështetjen në institucione.

**Neni 11**  
**Mosdiskriminimi**

1. Zyrtari i komunës duhet të shmangë çdo lloj diskriminimi të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë në bazë të përkatësisë etnike, racës, gjinisë, fesë, mendimeve politike, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
2. Zyrtari i komunës duhet të trajtojë me respect të gjithë individët ose subjektet duke respektuar të drejtat dhe detyrimet e tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi.

**Neni 12**  
**Transparenca**

1. Zyrtari i komunës duhet të promovojë çdo masë që nxit transparencën në lidhje me kompetencat, detyrat dhe funksionimin e shërbimeve dhe njësive nën përgjegjësinë e tyre.
2. Zyrtari i komunës duhet të sigurojë që publikut t'i ofrohet transparencë dhe qasje në informata në përputhje me legjislacionin dhe rregullativen komunale. Zyrtari i komunës duhet të ketë dijeni dhe të veprojë në përputhje me detyrimet e tyre sipas akteve nënligjore në fuqi për transparencë.

### **Neni 13**

#### **Efikasiteti dhe efektiviteti**

Zyrtari i komunës duhet të sigurojë zbatimin e thjeshtë efektiv të rregullave dhe procedurave administrative për përmbushjen e objektivave të administratës komunale për interesin publik dhe në të mirë të administratës komunale

### **Neni 14**

#### **Konflikti i interesit**

1. Konflikti i interesave është situatë në të cilën një zyrtar i komunës ka një interes personal të tillë, që ndikon ose mund të ndikojë në ligjshmërinë, transparencën, paanshmërinë ose objektivitetin e kryerjes së detyrës
2. Interesat personale përfshijnë çdo përfitim për veten, apo familjen nga ushtrimi i funksionit
3. Zyrtari i komunës duhet të mos lejojë që interesat private të bien ndesh me detyrën që ushtron, të sqarojë dhe shmangë çdo lloj forme veprimi apo sjellje, që mund të duket apo të perceptohet si konflikt i interesit me detyrën që ushtron, dhe të mosshfrytëzojë asnjëherë pozitën për interesin privat.
4. Zyrtari i Komunës nuk duhet të përdorë pozitën, kompetencat apo detyrat zyrtare për përfitim financiar ose material për veten, personin e afërm, ose ndonjë organizatë private apo publike në të cilën kanë interes të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë.
5. Kryetari dhe nënkryetari i komunës, kryesuesi i kuvendit dhe anëtarët e kuvendit të komunës, drejtorët e drejtorive të komunës dhe zyrtarët e tjerë të administratës të komunës, të cilët janë subjekte të këtij kodi, duhet të deklarojë konfliktin e interesit dhe në ato raste të tërhiqen nga vendimmarrja.

### **Neni 15**

#### **Nepotizmi**

1. Zyrtari i komunës duhet, në çdo rast dhe me çdo kusht, të shmangë, të kundërshtojë ndërhyrje, veprime, apo të favorizojë nepotizmin
2. Zyrtari i komunës nuk duhet të marrë pjesë, qoftë individualisht ose si anëtarë grupi, në vendimmarrje veçanërisht për të emëruar, punësuar, ngritur në detyrë, disiplinuar ose shkarkuar personin e afërm në çfarëdo pozicioni brenda komunës
3. Zyrtari i komunës nuk duhet të mbikqyrë personin e afërm në ushtrimin e kompetencave ose funksioneve zyrtare

### **Neni 16**

#### **Fushata zgjedhore**

1. Zyrtari i komunës gjatë fushatës zgjedhore që kandidon për kryetar komunë apo anëtarë të kuvendit të komunës, duhet të sillet me ndershmëri. Kandidati nuk duhet të sigurojë

